

Pruga e muslimanit

طريق المسلم (باللغة الألبانية)

*Kjo libër është formuluar si një material njohurish fillestare
për çdo musliman.*

Ai është një bashkim i përpunuar i dy librave të mirënjohur

“Rruga e muslimanit” dhe “Akidja islame”.

Kjo libër është i dobishëm për ata që janë në hapat e para të Islamit.



Conveying Islamic Message Society

P.O.Box 834 - Alex - Egypt

E-Mail: info_en@islamic-message.net

E-Mail: cims_eg@yahoo.com

Site: www.islamic-message.net


Not for sale نه ببيع ولا يباع





Akɨdja Islame

Botim i ripunuar, pajisur me mësimet
e germave të gjuhës arabe



Parathënie

Falënderimi i veçantë i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë e falje kërkojmë. I lutemi Allahut të na falë gjynahet tona dhe të na ruajë prej dënimit të Tij. Atë që e udhëzon Allahu s'ka kush e humbë e atë që e humbë Allahu s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, i Cili është Një e i vetëm, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Tema e trajtuar në këtë libër është Akidja (besimi) Islame e cila është baza mbi të cilën ngrihet Islami dhe elementi më i rëndësishëm që ka të bëjë direkt me jetën e njeriut në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Për të qenë sa më popullor dhe i kuptueshëm, libri është ndërtuar kryesisht me pyetje-përgjigje, e meqënëse në Islam argumenti është baza mbi të cilën ngrihet vepra, përgjigjet janë argumentur me ajete Kur'anore dhe hadithe të sakta. Në këtë botim janë shtuar edhe disa çështje të reja që janë marrë nga libri i Ed-Deuserit "El-Exhuibe Mufide" që mendoj se janë të dobishme për kohën që jetojmë.

Lus Allahun që ky libër të jetë singërisht për hatër të Tij dhe të jetë i dobishëm për muslimanët.

Muhamed Xhemil Zejno

Shënim: Ky material është përpiluar duke u bazuar në librin "Akidja Islame" i autorit Muhamed Xhemil Zejno i botuar më parë në gjuhën shqipe. Gjatë ripërgatitjes së librit u pa e arsyeshme të mënjanohej disa çështje dhe të shtohen disa të tjera në mënyrë që ky material të jetë sa më i dobishëm dhe i vlefshëm për lexuesin tonë (sh.r.).

Bazat e Islamit

Xhibraili alejhi salam iu drejtua Muhamedit alejhi salam me pyetjen: “Ç’është Islami?” Pejgamberi alejhi salam iu përgjigj: “Islam është, ‘Të dëshmosh se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut (la ilahe il Allah) dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut (Muhamedun resullullah); të falësh namazin (duke e kryer atë në mënyrë të plotë); të japësh zekatin (që është dhënia e një pjese të caktuar të pasurisë); të agjërosh muajin e Ramazanit (që është lënia e të ngrënit, të pirit, marrëdhënive seksuale dhe e të gjitha veprimeve që e prishin agjërimin, nga agimi deri në perëndim e diellit); të kryesh haxhin nëse ke mundësi’.” (Transmeton Muslimi)

Bazat i Imanit

Xhibrili alejhi salam iu drejtua për së dyti Muhamedit alejhi salam duke e pyetur: “Ç’është Imani?” Pejgamberi alejhi salam iu përgjigj: “Iman është, ‘Të besosh Allahun (të besosh se Allahu ekziston, se Ai është Krijuesi dhe Zoti i çdo krijese, të besosh në të gjitha Cilësitë dhe Emrat e Tij të cilat Ai i ka shpallur për Vetën e Tij dhe në ato që Muhamedi alejhi salam ia ka përshkruar Atij, të besosh se vetëm Ai meriton të adhurohet dhe se vetëm prej Tij vjen ndihma dhe shpëtimi); të besosh melekët e Tij (melekët janë krijesa prej drite që janë nënshtuar urdhërave të Allahut); të besosh Librat e Tij (Teuratin, Inxhilin, Zeburin dhe Kur’anin); të besosh Pejgamberët e Tij (i pari prej

tyre ka qenë Nuhu dhe i fundit Muhamedi alejhi selam); të besosh Ditën e Gjykimit (të besosh në Ditën e dhënies së llogarisë, Ditën në të cilën do të llogariten veprat e njerëzve); të besosh në Kaderin e Allahut, të mirën dhe të keqen (d.m.th. të jesh i kënaqur me atë që ka caktuar Allahu).” (Transmeton Muslimi)



Domethënia e Islamit dhe Imanit

1) Ç'do të thotë Islam?

- Islam do të thotë dorëzim ndaj Allahut me teuhid (veçimin e Tij në adhurim), nënshtrim ndaj Tij me bindje dhe largim nga shirku (politeizmi) dhe ithtarët e tij. Allahu i lartësuar thotë: **“Ai që i është dorëzuar Allahut dhe është mirëbërës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i Tij, për atë nuk ka frikë, as nuk ka pse të mërzhitet.”** (Bekare: 112)

2) Ç'do të thotë Iman?

- Iman do të thotë të besosh me zemër, ta shprehësh atë besim me gjuhë dhe ta pasqyrosh me vepra.

Allahu thotë: **“Beduinët thanë: ‘Ne kemi besuar’. Thuaj: ‘Ju nuk keni besuar ende, por thoni, ‘ne jemi dorëzuar’, se ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja’.”** (Huxhurat: 14)

Hasan El-Basri thotë: “Imani nuk është me të dëshiruar e as me të përshkruar (zbukuruar), por është çështje që lë gjurmë në zemër (në të cilën është bindur zemra) dhe të cilin e vërtetojnë veprat.”

3) Kush është Zoti yt?

- Zoti yt është Ai që të ka krijuar, Ai që të ka në dorë ty dhe të gjitha krijesat, është Ai të Cilin ne e adhurojmë.

Allahu thotë: **“Vetëm Allahu, Zoti i botëve, meriton që të falenderohet.”** (Fatiha: 1)

4) Cila është feja jote?

- Feja jote është Islami. Islam është e gjitha ajo që është shpallur në Kur’ani dhe në Sunet (rruga profetike).

Allahu thotë: **“Feja e pranueshme tek Allahu është Islami.”** (Ali Imran: 19)

5) Kush është Pejgamberi yt?

- Pejgamberi yt është Muhamedi alejhi selam. Quhet Muhamed i biri i Abdullahit i biri i Abdulmutalibit i biri i Hashimit. Është lindur në Mekë. Nëna e tij quhet Amine bija e Uehbit. Është Nebij dhe Resul për të gjithë njerëzit.¹

Allahu thotë: **“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i Dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë Pejgamberëve ...”** (Ahzab: 40)

Ai është bërë Nebij me zbritjen e ajetit **‘Lexo me Emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi çdo gjë’** (Alak: 1) dhe është bërë Resul me zbritjen e ajetit **‘O ti i mbuluar: Ngrihu dhe tërhiqju vërejtjen** (duke thirrur)’ (Medethir: 1-2).

Të Dërguarit të Allahut shpallja i ka ardhur për herë të parë në moshën 40 vjeçare. Trembëdhjetë vjet pas shpalljes së tij i Dërguar, ai urdhërohet nga Allahu të shpërngulet në Medine, në të cilën qëndroi dhjetë vjetë. Në moshën 63 vjeçare ndërroi jetë.

Gjëja e parë në të cilën thirri i Dërguari i Allahut alejhi selam ishte teuhidi, të cilin e përmbledhë fjala ‘la ilahe il Allah’ që do të thotë ‘s’ka adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut’. Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij t’i lutet vetëm Atij, që është Një, dhe mos t’i bëjë Atij shok në lutje, siç kanë bërë idhujtarët në kohën e Tij, duke i thënë: **“Thuaj: “Unë adhuroj vetëm Zotin tim dhe Atij nuk i bëj asnjë shok.”** (Xhin: 20)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Lutja është adhurim.” (Transmeton Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është i mirë, i vërtetë.)

1- Resul (i Dërguar) është ai të cilit i shpallet Sheriat i ri, kurse Nebij (Pejgamber - Lajmëtar) është ai i cili është dërguar për të aprovuar Sheriatin e të Dërguarit që ka qenë para tij. Shiko librin “Er-Resul uer-Risalat” f. 15, borimi i tretë, viti 1405, autor i të cilit është dr. Umer Sulejman Eshkar. (sh.p.)

Kështu detyrë e muslimanëve është t'i luten vetëm Allahut, e askujt tjetër veç Tij, qoftë ky Pejgamber apo eulija, ngase vetëm Allahu është i mundshëm për t'ia përgjigjur lutjeve tona e të tjerët veç Tij nuk kanë mundësi ta largojnë të keqen nga njerëzit.

Allahu i lartësuar thotë: **“Ata (idhujt) që i adhurojnë (idhujtarët) veç Allahut, nuk krijojnë asgjë, por se vetë ata janë të krijuar. Janë të vdekur e jo të gjallë dhe ata nuk e dinë se kur do të ringjallen (adhuruesit e tyre).”** (Nahl: 20-21)

6) Cili është besimi yt për Ringjalljen dhe cila është dispozita e Sheriatit për atë që e mohon një gjë të tillë?

- Akidja (besimi) ime për Ringjalljen është siç vijon: Besimi në të është obligim (uaxhib) dhe pjesë e pandarë nga Imani. Ai që ka krijuar krijesat nga hiçi ka mundësi t'i ringjallë ato përsëdyti. Ai që e mohon këtë, është kafir (mosbesimtar, mohues) dhe do të dënohet me Xhehenem përgjithmonë. Argument për këtë është Fjala e Allahut: **“Ai na solli neve shembull dhe e harroi krijimin e vet e tha: ‘Kush i ngjall eshtrat duke qenë ato të kalbura?’ Thuaj: ‘I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim’.”** (Jasin: 78-79)

7) Cilat janë shenjat e përfundimit të mirë tek i vdekuri?

- Shenjat e përfundimit të mirë janë të shumta e vdekja me një apo disa prej tyre është përgëzim për muslimanin. Këto shenja janë:

a) Të shprehurit e dëshmisë (shehadetit) gjatë vdekjes.

b) Të vdekurit natën ose ditën e Premte (xhuma).

c) Të vdekurit me djersitje të shumtë në ballë.

d) Rënia shehid në luftë.

e) Të vdekurit si luftëtar në Xhihad. Në këtë grup hyn edhe ai që vritet ose që vdes në Rugë të Allahut, ai që vdes nga murtaja, të vjellurit, nga fryrjet e barkut, nga diareja etj., me një fjalë nga çdo sëmundje barku.

f) Ai që fundoset ose digjet.

g) Vdekja e gruas lehonë.

h) Vdekja nga pleuritisi (inflamacion-pezme e pleures).

i) Të vdekurit nga turbekulozi.

k) Të vdekurit duke mbrojtur fenë, vetveten dhe pasurinë.

l) Vdekja gjatë rojës.

m) Të vdekurit duke bërë ndonjë vepër të mirë, siç është të thënit e shehadetit, agjërimi, sadakaja (lëmosha) etj.²

Argument për sa thamë më sipër janë hadithet e të Dërguarit të Allahut. Këtu po përmendim dy prej tyre.

I Dërguari i Allahut thotë: “Shehidë (dëshmorë) përveç atij që vritet në Rugë të Allahut, janë shtatë persona: ai që vdes nga murtaja, i fundosuri, ai që vdes nga pleuritisi (inflamacioni i pleures), ai që vdes nga sëmundjet e barkut, i djeguri, ai që vdes nën gërmadha dhe gruaja që vdes gjatë nifasit (lehonisë).” (Transmeton Hakimi dhe thotë se hadithi është i vërtetë. I këtij mendimi është edhe Dhehebiu.)

Gjithashtu i Dërguari i Allahut thotë: “Kush thotë ‘la ilahe il Allah’ duke shpresuar Fytyrën e Allahut dhe me të përfundon jetën hyn në Xhenet; kush agjëron ndonjë ditë duke shpresuar Fytyrën e Allahut dhe me këtë vepër

2- Shiko librin “Ehkamul-xhanaiz” të dijetarit të hadithit Muhamed Nasirud-Din Albani, f. 34.

përfundon jetën e tij, hyn në Xhenet dhe kush jep sadaka duke shpresuar Fytyrën e Allahut (d.m.th. e bën këtë vepër vetëm për hir të Tij) dhe me këtë vepër përfundon jetën e tij, hyn në Xhenet.” (Albani thotë se senedi, zinxhiri i transmetimit, i këtij hadithi është i vërtetë.)



Detyrat e robërve ndaj Allahut

1) Pse na ka krijuar Allahu?

- Allahu na ka krijuar që ta adhurojmë dhe të mos i bëjmë Atij shok në adhurim. Dëshmi për këtë është fjala e Allahut:

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.” (Dharijat: 56)

dhe hadithi i Pejgamberit alejhi selam: “Detyra e robërve ndaj Allahut është ta adhurojnë Atë dhe të mos i bëjnë Atij shok në adhurim”. (Mutefikun Alejhi. Transmeton Buhari dhe Muslimi)

2) Ç’do të thotë fjala ibadet (adhurim)?

- Termi el-ibade është term që përfshin çdo vepër që kryhet e që e do Allahu si p.sh. dua, namazi, frika etj. Allahu thotë:

“Thuaj: ‘Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.’ (En’am: 162)

Muhamedi alejhi selam duke transmetuar fjalët e Allahut në hadith kudsij thotë: “Vepra më e mirë dhe më e dashur me të cilën robi Im mund të më afrohet Mua është ajo të cilën ia kam bërë farz (obligim i domosdoshëm)”. (Transmeton Buhari)

3) Cilat janë llojet e ibadetit (adhurimit)?

- Llojet e adhurimit janë të shumta, këtu po përmend vetëm disa, p.sh. adhurim është lutja, frika, shpresa, mbështetja, frikërespekti, kurhani, rukuja (përlujja), sex-

hdja, tauafi (tauaf d.m.th. të rrotulluarit rreth Ka'bes), betimi, të gjykuarit etj.

4) Si ta adhurojmë Allahun?

- Allahun duhet ta adhurojmë ashtu siç na ka urdhëruar Ai dhe i Dërguari i Tij alejhi selam Allahu thotë:

“O ju besimtarë, respektojeni Allahun dhe të Dërguarin, e mos i çoni kot veprat tuaja.” (Muhamed: 33)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Kushdo që në fenë tonë shpik diçka të re, ajo është e refuzuar (d.m.th. është e pranueshme).” (Transmeton Muslimi)

5) A e adhurojmë Allahun duke pasë frikë nga dënimi i Tij dhe duke shpresuar mëshirën e Tij?

- Po, pikërisht kështu e adhurojmë, ngase Allahu i urdhëron robërit e Tij duke thënë:

“Dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën) ...” (Araf: 56)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Lus Allahun që të më dhurojë Xhenetin dhe kërkoj mbrojtje tek Ai nga Zjarri i Xhehenemit.” (Transmeton Ebu Daudi me sened të vërtetë.)

6) Ç’është ihsani në adhurim?

- Ihsan do të thotë të kesh në mend mbikëqyrjen e Allahut gjatë adhurimit. Allahu thotë:

“I Cili të sheh kur ti ngrihesh në këmbë, (e sheh) edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen.” (Shuara: 218-219)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ihsan është ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh edhe pse nuk e sheh Atë, Ai ty të sheh.” (Transmeton Muslimi)

Llojet dhe dobia e teuhidit

1) Përse i ka dërguar Allahu të Dërguarit?

- Allahu ata i ka dërguar që ta ftojnë njerëzimin për ta adhuruar Atë (Allahun) dhe ta mohojnë shirkun. Allahu thotë:

“Ne dërguam në çdo popull të Dërguar me qëllim që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largohuni nga djajtë (adhurimit të tyre).” (Nuh: 36)

(Tagut është ai të cilin e adhurojnë njerëzit dhe i luten veç Allahut, e ai është i kënaqur me këtë).

Muhamedi alejhi selam thotë: “Të Dërguarit janë vëllezër ... feja e tyre është një (d.m.th. të gjithë të Dërguarit kanë ftuar në teuhid).” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

2) Ç’është njësimi i Zotit?

- Njësimi i Zotit është të veçuarit e Tij me veprat e Tij siç është krijimi, rregullimi etj. Allahu thotë:

“Vetëm Allahu, Zoti i botëve, meriton që të falenderohet.” (Fatiha: 1)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ti je Zot i qiejve dhe i tokës ...” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

3) Ç’është njësimi i Allahut në adhurim?

- Njësimi i Allahut në adhurim është veçimi i Tij në lutje, kurban, premtim, namaz, shpresim, frikë, në të kërkuarit ndihmë, në të mbështeturit në Të e në të gjitha veprat e adhurimit. Allahu thotë:

“Zoti juaj (që meriton adhurim) është Një, Allahu. Nuk ka Zot veç Tij, Ai është Mëshirëplotë dhe gjithnjë mëshiron.” (Bekare: 163)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Le të jetë gjëja e parë me të cilën do të ftosh (në besim) dëshmia se s’ka tjetër që meriton të adhurohet veç Allahut.” (Në transmetimin e Buharit është përmendur “të njësojnë Allahun”).

4) Ç’është njësimi i Allahut në Emrat dhe Cilësitë e Tij?

- Ta njësosh Allahun në Emrat dhe Cilësitë e Tij do të thotë ta përshkruash Allahun me ato Emra dhe Cilësi me të cilat Ai e ka përshkruar veten dhe me ato Emra dhe Cilësi me të cilat i Dërguari i Allahut alejhi selam e ka përshkruar Atë, pa ia dhënë ato krijesave, pa i bërë atyre koment si dhe pa i krahasuar ato me emrat dhe cilësitë e krijesave. Allahu thotë:

“Asnjë send nuk është si Ai; Dëgjuesi dhe Shikuesi.”
(Shura: 11)

6) Ku është Allahu?

- Allahu është mbi Arsh, mbi qiej. Allahu thotë:

“(Ai është) Mëshiruesi që qëndron mbi Arsh.” (Taha: 5)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Allahu ka shkruar në libër para se të krijojë krijesat: “Mëshira Ime e mbulon zemërimin Tim”. Kjo është shkruar tek Ai mbi Arsh (Fron).” (Transmeton Buhari)

Ai që mohon qënien e Allahut mbi Arsh kundërshton Kur’anin dhe Sunetin.

7) A është Allahu me ne?

- Allahu është me ne me diturinë e Tij, na dëgjon dhe na sheh. Allahu thotë:

“Mos u frikësoni, sepse Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh.” (Taha: 46)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Ju i luteni Atij që dëgjon dhe që është afër. Ai është me ju (është me ju me diturinë e Tij).” (Transmeton Muslimi)

8) Ç’dobi kemi nga teuhidi?

- Teuhidi është shkak i shlyerjes nga Allahu i gjynaheve tona, na mbron nga dënimi i përhershëm në Ahiret si dhe na mundëson udhëzimin e Allahut në këtë botë. Allahu thotë:

“Ata që besojnë dhe besimin e tyre nuk e përziejnë me shirk (idhujtari), atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.” (En’am: 82)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Detyrë e Allahut është që të mos e dënojë atë që nuk i bën shok Atij në adhurim.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)



Domethënia e shprehjes ‘la ilahe il Allah’ dhe kushtet e saj

1) Cilat janë kushtet e shprehjes ‘la ilahe il Allah’ dhe ç’do të thotë kjo shprehje?

- Dije, vëlla i dashur musliman, Allahu na udhëzoftë, se fjala ‘la ilahe il Allah’ është çelësi i Xhenetit, mirëpo çdo çelës ka dhëmbë, kështu që nëse posedon çelës me dhëmbë mund të hapësh derën, përndryshe nuk do të mundesh. Dhëmbët e këtij çelësi janë kushtet e shprehjes ‘la ilahe il Allah’. Këto janë:

a) Posedimi i diturisë mbi kuptimin e kësaj shprehjeje, që do të thotë të mohosh adhurimin e tjetërkujt veç Allahut dhe t’ia kushtosh këtë adhurim vetëm Allahut, Një. Allahu thotë:

“Dije se nuk ka Zot tjetër veç Allahut.” (Muhamed : 19)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush vdes duke ditur se s’ka tjetër që meriton adhurim veç Allahut, hyn në Xhenet.” (Transmeton Muslimi.)

b) Posedimi i bindjes së plotë që do të thotë të jesh i bindur në këtë gjë me gjithë zemër duke mos dyshuar aspak. Allahu thotë:

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të Dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan ...” (Huxhurat: 15)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij si dhe e takon Allahun duke mos dyshuar aspak në Të, ai hyn në Xhenet.” (Transmeton Muslimi)

c) Pranimi i asaj që kërkon kjo shprehje me zemër dhe gjuhë. Allahu thotë:

“Për arsye se kur u thuhej atyre: Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, ata e mbanin veten lartë. Dhe thoshin: “A do t’i braktisim ne zotat tanë për një poet të çmendur.”
(Saffat: 35, 36)

d) Pranimi i plotë dhe nënshtrimi në atë që e shpreh kjo shprehje. Allahu thotë:

“Dhe kthehuni te Zoti i juaj e përlunij Atij ...” (Zumer: 54)

e) Thënia e kësaj shprehjeje me sinqeritet nga zemra. Allahu thotë:

“Elif, Lamë, Mimë. A menduan njerëzit të thonë ‘ne kemi besuar’ e të mos vihen në sprovë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithqysh do t’i dallojë ata që thanë të vërtetën, do t’i dallojë dhe gënjeshtarët.”
(Ankebut: 1-3)

“Ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër veç që ta adhuronin Allahun me dashuri të sinqertë ndaj Tij.” (Bejjine: 5)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “S’ka njeri që dëshmon sinqerisht nga zemra se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij, e Allahu të mos e bëjë haram për të hyrjen në Xhehenem.”
(Mutefikun alejhi, transmeton Buhari dhe Muslimi.)

Në një hadith tjetër ai thotë: “Njeriu më i gëzuar me shefatin tim është ai që thotë ‘la ilahe il Allah’ nga zemra e sinqertë ose shpirti i sinqertë.” (Transmeton Buhari.)

f) Ta duam këtë shprehje të mirë dhe ata që e thonë sinqerisht atë e t’i urreshë ata që i kundërvihen asaj. Allahu thotë:

“E nga njerëzit ka të atillë që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan ata si Allahun, por dashuria e atyre që besuan Allahun është më e fortë.” (Bekare: 165)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Një person tek i cili gjenden tri gjëra ka gjetur ëmbëlsinë e Imanit; të jenë Allahu dhe Pejgamberi më të dashur për të se çdo gjë tjetër, ta dojë dikë vetëm për hirë të Allahut dhe të urrejë të kthehet në kufër pasi Allahu e ka shpëtuar nga ai ashtu siç urren të hidhet në Zjarr.” (Mutefikun alejhi, transmeton Buhari dhe Muslimi.)³



3- Marrë nga libri El-Velau Vel-Berau fil-Islam, autor Muhammed Seid Kahtani.

Rëndësia e akides dhe teuhidit

1) Pse i kushtojmë rëndësi teuhidit më tepër se çështjeve të tjera?

- Teuhidit i japim rëndësi për disa arsye:

a) Teuhidi është arsyeja për të cilën Allahu ka krijuar botën. Allahu thotë:

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër veç që të Më adhurojnë.” (Dharijat: 56)

b) Teuhidi është e kundërta e shirkut dhe baza kryesore mbi të cilën mbështetet Islami.

c) Teuhidi është thirrja e të gjithë Pejgamberëve. Allahu thotë:

“Ne dërguam në çdo popull të Dërguarit t’u thonë: “Adhurojeni vetëm Allahun, e largojuni tagutëve (idhujve)”.” (Nahl: 36)

2) Sa ka nevojë njeriu për fe dhe besim?

- Njeriu është i kufizuar e si i tillë ai nuk mund të gjykojë vetë për të përcaktuar të mirën dhe të keqen, për të kuptuar qartë botën dhe arsyen e ekzistencës së tij. Kështu ai ka nevojë për udhëzimin Hyjnor të shpallur nga Allahu me anë të të Dërguarve të Tij. Ky udhëzim është feja e shpallur prej Allahut me rregullat dhe ligjet e saj, e cila e bën njeriun të dallojë të mirën nga e keqja, e udhëheq atë në sukses, rehati, lumturi e shpëtim. Allahu thotë:

“Ngjyrosje e Allahut, e kush ngjyros më mirë se Allahu. Ne vetëm atë e adhurojmë.” (Bekare: 138)⁴

4- Marrë nga libri “El-Exhvbhel-mufide”.

3) Cila është detyra e thirrësave dhe (bashkësive) Islame?

- Thirrësit dhe bashkësitë (xhematet) Islame kanë për detyrë të ecin në rrugën e Kur'anit dhe Sunetit. Ta fillojnë thirrjen e tyre ashtu siç e kanë filluar thirrjes e tyre për në shpëtim të gjithë Pejgamberët, e në krye të tyre Muhamedi alejhi selam.

I Dërguari i Allahut alejhi selam e ka filluar thirrjen e tij nga teuhidi. Ai ka qëndruar në Mekë 13 vjet duke thirrë njerëzit në teuhid, duke ua bërë atyre të qartë se adhurimi, në të cilin hyn edhe lutja (dua), nuk duhet t'i drejtohet askujt tjetër veç Allahut, sepse vetëm Ai ka mundësi t'i përgjigjet kësaj lutjeje, si dhe duke ua bërë atyre të qartë se vendosja e ligjeve dhe të gjykuarit nuk i takojnë askujt tjetër veç Allahut, sepse vetëm Ai është Krijuesi dhe Ai e di më mirë çfarë është më e mirë për krijesat e Tij. Pasi u largua nga Meka Muhamedi alejhi selam ndërtoi në Medinë shtetin Islam dhe thirri e luftoi për të ngritur lart Fjalën e Allahut.



Kushtet e pranimit të pendimit

1) Cilat janë kushtet për t'u pranuar pendimi?

- Kushtet e pranimit të pendimit janë:

a) Pendimi i sinqertë për hirë të Allahut për gjynahun e vepruar.

b) Kërkimi i faljes së Allahut për gjynahun e bërë.

c) Braktisja (lënia, mospërsëritja) e gjynahut.

e) Në qoftë se me gjynahun e kryer i ka hyrë në hak njerëzve të kërkojë prej tyre t'ia falin atë ose t'i kompesojë nëse i ka shkatuar dëm material.

f) Pendimi duhet bërë përderisa personi është gjallë dhe para se të lindë dielli nga perëndimi.

I Dërguri i Allahut alejhi selam thotë: “Allahu pranon pendimin (teuben) e robit të Tij përderisa nuk gargarisë (nuk i vjen shpirti në fyt).” (Transmeton Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është i mirë.)

Kushtet e pranimit të një vepre

1) Cilat janë kushtet që një vepër e mirë të pranohet nga Allahu?

- Që një vepër e mirë të pranohet nga Allahu duhet të plotësohen katër kushte:

a) Personi duhet të adhurojë vetëm Allahun në të gjitha aspektet e adhurimit. Allahu thotë:

“S’ka dyshim se për ata që besuan dhe bënë vepra të mira vendprirje për ta do të jenë Xhenetet e Firdeusit.”
(Kehf: 107)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Thuaj, ‘Besoj në Allahun, pastaj përqëndrohu (qëndro fort në këtë)’.” (Transmeton Muslimi.)

b) Vepra duhet të kryhet vetëm për hatër të Allahut. Allahu thotë në Kur’an:

“Adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij.” (Zumer: 2)

I Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush thotë ‘la ilahe il Allah’ me sinqeritet do të hyjë në Xhenet.” (Hadithi është i vërtetë. Transmeton Bezari dhe të tjerët.)

c) Vepra e kryer të jetë në përputhje me Sunetin e të Dërguarit të Allahut. Allahu thotë:

“Ç’ka ju jep Pejgamberi atë merreni e ç’ka ju ndalon përmbahuni (prej saj).” (Hasher: 7)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush kryen një vepër që nuk është prej fesë sonë, ajo i refuzohet.” (Transmeton Muslimi)

d) Personi nuk duhet të kthehet në kufër (mosbesim) e shirk (politeizëm), sepse kjo shkakton fshirjen e veprave të mira. Allahu thotë:

“Nëse i bën shok Allahut veprat tuaja janë të asgjësuar dhe ti do të jesh prej të humburve.” (Zumer: 65)

2) Nijeti (qëllimi)

- Nijeti (qëllim) është një nga elementet kryesorë që një vepër e mirë të pranohet prej Allahut. Ai duhet të jetë vetëm për të arritur Kënaqësinë e Allahut me anë të asaj vepre. Vendi i nijetit është zemra. Nuk lejohet që nijeti të shqiptohet (me përjashtim të nijetit të haxhit dhe umres) sepse i Dërguari i Allahut alejhi selam dhe shokët e tij nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Dhe nëse ju e mbani të fshehtë fjalën tuaj, apo e nxirrni hapur atë, padyshim që Ai është i gjithëditur për gjithçka në gjokse (të njerëzve).” (Mulk: 13)

I Dërguari i Allahut, Muhamedi alejhi selam, për këtë ka thënë: “Veprat vlerësohen sipas nijetit (qëllimit). Çdo personi i takon ajo që ka pasë për qëllim ...”⁵ (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)



5- Shiko komentin e këtij hadithi në librin “Komentimi i 40 haditheve”.

A është e drejtë shprehja 'feja është në zemër'?

- Kjo shprehje përdoret nga ata që duan të justifikohen për moskryerjen e detyrimeve të tyre Islame. Islami është fe që përmban në vetvete udhëzime dhe urdhëra për të gjitha aspektet e jetës. Kështu ai i jep personit një bashkësi udhëzimesh e urdhërash për të dy elementet bazë, për doktrinën (Imanin) dhe për veprimet praktike të individit që kanë të bëjnë me Allahun, veten e tij dhe shoqërinë. Moskryerja e veprimeve do të thotë moskryerje e urdhëresave të Islamit për to e kjo sipas gradës dhe rastit përkatës e bën personit gjynahqar ose e nxjerr atë nga Islami.

Hasan El-Basri ka thënë: "Imani nuk është me të dëshiruar e as me të zbukuruar, por është bindje në zemër të cilën e vërteton vepra."

Imam Shafiu thënë: "Imani është fjalë dhe vepër"

Të parët tanë të mirë kanë qënë të një mendimi se, 'Imani është të besosh, ta deklarosh besimin tënd dhe të veprosh sipas tij'.⁶



⁶- Shiko "Fet'hul Bari sherh Sahihul-Buhari", 1/46.

Së pari akidja apo pushteti?

Kësaj pyetje i është përgjigjur thirrësi i madh Muhamed Kutbi në një ligjëratë të tij në “Darul-hadith” në Meketul-Mukerreme. Më poshtë po përmend pyetjen dhe përgjigjen.

Pyetje: Disa mendojnë se Islami do të kthehet nëpërmjet pushtetit, kurse të tjerët thonë se Islami do të kthehet duke pastruar akiden dhe duke e edukuar shoqërinë. Cila rrugë është e saktë?

Përgjigje: Nuk mund të vijë pushteti në duar të kësaj feje nëse nuk pastrohet akidja, nëse nuk ka besim të sinqertë, nëse nuk sprovoen besimtarët në fenë e tyre dhe nëse ata nuk durojnë, nëse nuk luftojnë në Rrugë të Allahut derisa të vijë pushteti në duart e kësaj feje. Kjo është mjaft e qartë.

Pra, me doemos duhet të fillojmë të pastrojmë akiden, të edukojmë besimtarët me besim të sinqertë, me durim dhe këmbëngulje në përpjekjen e tyre në Rrugën e Allahut ashtu siç kanë bërë gjeneratat e para të muslimanëve.



Miqësia dhe armiqësia në Islam

1) Ç'kuptim kanë fjalët el-uela (miqësia) dhe el-bera (armiqësia) në Islam?

- El-uela (miqësia) në Islam do të thotë të duash Allahun, Pejgamberin alejhi selam, shokët e tij, besimtarët muuehidë (që adhurojnë vetëm Allahun) si dhe t'i ndihmosh këta të fundit.

- El-bera (urrejtja) në Islam do të thotë të urresh atë që kundërshton Allahun, Pejgamberin alejhi selam, shokët e tij dhe besimtarët muuehidë cilido qoftë ky.

Çdo besimtar muuehid (që adhuron vetëm Allahun) duhet dashur e ndihmuar dhe e kundërta duhet të jetë me çdokënd që adhuron dikë tjetër veç ose bashkë me Allahun dhe që lufton Islamin. Allahu thotë në Kur'an:

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri tjetrin.” (Teube: 71)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë:

“Lidhja më e fortë e Imanit është të duash për hirë të Allahut dhe të urresh për hirë të Tij.” (Albani thotë se hadithi është i mirë.)

“Kush e do ndokënd për hirë të Allahut dhe e urren ndokënd për hirë të Allahut, kush jep (sadaka) për hirë të Allahut dhe kush nuk jep për hirë të Allahut, e ka plotësuar Imanin.” (Transmeton Ebu Daud, hadithi është i vërtetë.)

“Ka njerëz prej robërve të Allahut që nuk janë Pejgamberë as shehidë, por të cilëve do t'ua kenë lakmi Pejgamberët dhe shehidët në Ditën e Kijametit për shkak të pozitës së tyre tek Allahu.” Thanë, “O i Dërguari i Allahut na trego kush janë ata.” I Dërguari i Allahut alejhi selam tha: “Ata janë njerëz që kanë dashur njëri tjetrin

për hirë të Allahut duke mos pasur lidhje familjare ndërjmet tyre, e as për shkak të pasurisë që i japin njëri tjetrit. Pasha Allahun fytyra e tyre është dritë, ata janë në dritë, nuk frikësohen kur të tjerët frikësohen as dëshpërohen kur të tjerët dëshpërohen.” Pastaj ai lexoi këtë ajet: “Tani e keni të ditur se të dashurit e Allahut (eulijatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje.” (Junus: 62) (Abdul-Kadr Arnauti thotë se hadithi është i mirë.)

Ibni Abbasi r.a. thotë: “Kush e do ndokënd për hirë të Allahut dhe e urren ndokënd për hirë të Allahut, e miqëson ndokënd për hirë të Allahut dhe e armiqëson ndokënd për hirë të Allahut, ky me këtë arrinë dashurinë e Allahut ndaj tij. Një person nuk mund të shijojë shijen e Imanit, edhe në qoftë se falet dhe agjëron shumë, përderisa nuk bëhet i dashuri i Allahut. Ngase sot vëllazërimi i njerëzve në përgjithësi bëhet në bazë të dynjasë (interesave të kësaj bote), e kjo nuk u bën dobi atyre.”



Miqtë e Rrahmanit (Mëshiruesit) dhe miqtë e shejtanit

1) Kush janë miqtë e Rrahmanit?

- Miqtë e Rrahmanit (Mëshiruesit) janë besimtarët që janë të devotshëm dhe ata që veprojnë sipas Kur'anit dhe Sunetit. Allahu thotë:

“Ta dini se të dashurit e Allahut (eulijatë) nuk do të kenë frikë (në botën tjetër) e as nuk do të brengosen. Ata të cilët besuan dhe ishin të ruajtur.” (Junus: 62-63)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Me të vërtetë mik i imi dhe i besimtarëve të mirë është Allahu.” (Transmeton Muslimi dhe Buhari në librin e tij “Edebul-mufred”).

2) Kush janë miqtë e shejtanit?

- Miqtë e shejtanit janë ata që kundërshtojnë Allahun, ata që nuk veprojnë sipas Kur'anit dhe Sunetit, pasuesit e bidateve dhe epsheve. Allahu thotë:

“Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë.” (Zuhruf: 36)

3) A gjendet rrugë ndërmjetëse ndërmjet hakut (të vërtetës) dhe batilit (të kotës)?

- Nuk ka rrugë ndërmjetëse ndërmjet hakut (të vërtetës) dhe batilit (të kotës), sepse Allahu e ka sqaruar dhe dalluar të vërtetën nga e kota. Allahu thotë në Kur'an:

“Pas të vërtetës nuk ka tjetër veç humbjes.” (Junus: 32)

Shirku i madh dhe llojet e tij

1) Ç'është shirku i madh?

- Shirk i madh do të thotë të adhurosh (në ndonjë ose në të gjitha format e adhurimit) dikë tjetër veç ose bashkë me Allahun. Allahu i Lartësuar thotë:

“Dhe mos lut tjetërkë veç Allahut, sepse idhujt nuk të sjellin as dëm as dobi, e nëse e bën atë, dije se i ke bërë dëm vetes.” (Junus: 106)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Mëkati më i madh prej mëkateve të mëdha është shirku (idhujtaria) ...” (Transmeton Buhari.)

2) Cili mëkat është më i madh tek Allahu?

- Mëkati më i madh tek Allahu është shirku i madh. Argument për këtë është fjala e Llukmanit, të cilën Allahu na e tregon në Kur'an:

“O djali im, mos i bëjë Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.” (Llukman: 13)

Të Dërguarin e Allahut alejhi selam e pyetën: “Cili është mëkati më i madh?” Ai iu përgjigj: “T'i bësh Allahut shok e është Ai që të ka krijuar.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

3) A është shirku i pranishëm në këtë umet?

- Po, shirku është i pranishëm në këtë umet. Argument për këtë është Fjala e Allahut:

“Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe Allahun vetëm se duke i shoqëruar zotër të tjerë.” (Jusuf: 106)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Nuk do të bëhet Kijameti derisa të takohen fise nga umeti im me

mushrikët dhe derisa të adhurohen idhujt.” (Hadithi është i vërtetë, transmeton Tirmidhiu.)

4) Cila është dispozita e Sheriatit për lutjet që u drejtohen të vdekurve dhe atyre që nuk janë të pranishëm?

- Drejtimi i lutjeve atyre që kanë vdekur ose atyre që nuk janë të pranishëm është shirk i madh. Allahu thotë:

“Pra, përveç Allahut mos lut Zot tjetër e të bëhesh prej të dënuarve.” (Shuara: 213)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Kush vdes duke lutur dikë tjetër veç Allahut hyn në Zjarr.” (Transmeton Buhari.)

5) A është lutja (dua) adhurim?

- Po, dua është adhurim. Allahu thotë:

“Zoti juaj ka thënë: “Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem.” (Gafir: 60)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Lutja është adhurim.” (Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është i mirë, i vërtetë.)

6) A e dëgjojnë të vdekurit lutjen?

- Jo, nuk e dëgjojnë. Allahu thotë:

“E ti nuk mund ta bësh të dëgjojë ai që është në varr.” (Fatir: 22)

“Vetëm ata që dëgjojnë (mesazhin e Pejgamberit Muhamed alejhi selam) do të pranojnë (e do të përfitojnë), por sa për të vdekurit (kafirët), Allahu do t'i ngrejë ata dhe tek Ai do të kthehen (për të marrë shpërblimin e tyre).” (En'am: 36)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Allahu ka melekë vëzhgues në tokë që i kumtojnë përshëndetjet e umetit tim.” (Hadithi është i vërtetë.)

Meqënë se i Dërguari i Allahut alejhi selam nuk i dëgjon përshëndetjet e umetit të tij pa ndërhyrjen e melekëve si mund të dëgjojnë të tjerët?!

Transmetohet nga Ibn Umer r.a. i cili ka thënë: “Muhamedi alejhi selam u ndal në vendin e betejës në Bedër atje ku kishin vdekur mushrikët dhe tha: ‘A e gjetët të vërtetën, atë që ua premtoi Zoti juaj?’ Pastaj tha: ‘Këta tash dëgjojnë ç’them Unë’.”

Kjo ngjarje u përmend në prani të Aishes r.a. e ajo tha: “Muhamedi alejhi selam ka thënë: “Ata tash e dinë që ajo të cilën ua kam thënë unë është e vërtetë.” Pastaj lexoi ajetin 80 nga sureja Neml. **“Ti nuk mund t’i bësh të dëgjojnë të vdekurit.”**”

Katadja, që transmeton hadithin e Ebi Talhës, thotë: “I ka ngjallë Allahu (ata) për të dëgjuar fjalët e Pejgamberit për t’i nënçmuar ata dhe duke ua treguar atyre dënimin që kanë gjetur dhe pendimin e tyre të vonuar e të padobishëm.” (Transmeton Buhari.)

Duke u mbështetur në argumentet e mësipërme nxjerrim përfundimin se të vdekurit në përgjithësi nuk dëgjojnë ndërsa për sa i përket shprehjes së të Dërguarit të Allahut ‘ata tash dëgjojnë’ kjo ka të bëjë me një rast të veçantë. Allahu në këtë rast i ka bërë atyre të mundur që të dëgjojnë e kjo është mrekulli që Allahu ia ka dhënë të Dërguarit të Tij. Allahu e di më mirë.

Llojet e shirkut të madh

1) A duhet të kërkojmë ndihmë nga ata që janë të vdekur dhe nga ata të cilët nuk janë të pranishëm?

- Jo, nuk duhet të kërkojmë ndihmë prej tyre por duhet të kërkojmë ndihmë vetëm prej Allahut. Allahu thotë:

“Ata (idhujt) që i adhurojnë idhujtarët veç Allahut, ata nuk krijojnë asnjë gjë, por ata vetë janë të krijuar.” (Nahl: 20)

“Kujtojeni (momentin) kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai u është përgjigjur.” (Enfal: 9)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Ja Hajjun, ja Kajjum (O Ti që je i gjallë dhe mbikqyrës), me mëshirën tënde kërkoj ndihmë.” (Transmeton Tirmidhiu)

2) A mund të kërkojmë ndihmë prej të gjallëve?

- Po, ne mund të kërkojmë ndihmë prej të gjallëve në ato raste kur ka mundësi. Allahu thotë:

“E ai i anës së tij kërkoj ndihmë kundër armikut dhe Musai i ra me grusht e ai vdiq.” (Kasas: 15)

“Ndihmohuni në të mira dhe të mbara.” (Maide: 2)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Allahu është në ndihmë të robrit, derisa robi është në ndihmë të vëllait të vet.” (Transmeton Muslimi)

Të kërkuarit shërim, rizk (furnizim), udhëzim dhe sende të ngjashme, këto gjëra nuk kërkojnë nga askush tjetër përveç Allahut. Allahu thotë:

“Zoti që më krijoi, Ai më udhëzon mua dhe është Ai që më ushqen dhe më jep të pijë dhe kur të sëmurem Ai më shëron.” (Shuara: 78-80)

3) A lejohet të kërkohet ndihmë nga ndokush tjetër veç Allahut?

- Jo, nuk lejohet të kërkohet ndihmë nga tjetërkush veç Allahut në çështje që s'mund të të ndihmojë askush veç Tij. Allahu thotë:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti ndihmë kërkojmë.” (Fatiha: 4)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Kur të kërkosh, kërko prej Allahut ...” (Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është i mirë, i vërtetë.)

4) A lejohet therrja e kurbanit për dikë tjetër veç Allahut?

- Nuk lejohet. Argument për këtë është fjala e Allahut: **“Andaj, ti falu dhe prej kurban për hirë të Zotit tënd.”** (Keuther: 2)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “E mallkoftë Allahu atë që therrë kurban për tjetërkë veç Allahut.” (Transmeton Muslimi)

Gjithashtu nuk lejohet të therret kurban te varret dhe përmendoret, edhe po qe se kjo është në emër të Allahut.

5) A lejohet të bëhet tauaf (rrotullim) rreth varreve me qëllim që t'i afrohemi Allahut?

- Jo, kjo nuk është e lejuar. Muslimanët nuk rrotullohen askund tjetër veç rreth Kabes. Allahu thotë:

“Dhe le të sillen (bëjnë tauaf) rreth Shtëpisë së Lashtë.” (Haxh: 29)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Kush bën tauaf (sillet) rreth Kabes shtatë herë dhe falë dy rekatë, ka shpërblim sikur të lirojë një rob.” (Hadithi është i vërtetë, transmeton Ibn Maxhe.)

6) Cila është dispozita e Sheriatit mbi magjinë?

- Magjia është një prej mëkateve të mëdha, në disa raste mund të jetë kufër. Allahu thotë:

“Por djajtë ishin të pafe, sepse ua mësonin njerëzve magjinë.” (Bekare: 102)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Largohuni nga shtatë vepra shkatërruese: të bërit shirk Allahut, magjia (sihri), ...” (Transmeton Muslimi.)

Magjistarët mund të jenë mushrikë, kafrirë ose çoroditës ndaj të cilëve duhet zbatuar ligji Islam në vartësi të asaj që ata kanë bërë.

7) A duhet besuar fallxhiu dhe astrologu në thëniet e tyre për çështjet që janë gajb (fshehtësi)?

- Jo, nuk duhet besuar në atë që thonë. Allahu thotë:

“Thuaj: “Askush veç Allahut as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtën.” (Neml: 65)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Kush shkon te fallxhiu dhe astrologu dhe i beson asaj çka thonë, ai e ka mohuar atë që i ka zbritur Muhamedit.” (Hadithi është i vërtetë, transmeton Ahmedi.)

8) A e di ndokush gajbin (të fshehtën)?

- Jo, gajben (të fshehtën) nuk e di askush veç Allahut. Allahu thotë:

“Çelësat e fshehtësisë janë vetëm tek Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush veç Tij.” (En’am: 59)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Nuk e di gajbin askush veç Allahut.” (Hadithi është i mirë, transe-ton Taberani.)

10) Cila është dispozita e Sheriatit për atë që vepron me ligje që nuk janë të Islamit?

- Të vepruarit me ligje jo Islame është kufër nëse personi vepron me to duke mos qenë i detyruar ose nëse beson se këto ligje janë më të përshtatshme se ligji Islam. Allahu thotë:

“E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë kafira (mohues).” (Maide: 44)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Nëse kryetarët e tyre (mulimanëve) nuk gjykojnë me Librin e Allahut dhe zgjedhin (bëjnë dallim) nga ajo që është shpallë, Allahu do të lëshoj mes jush fatkeqësi.” (Hadithi është i mirë, i saktë, transmeton Ibn Maxhe.)

11) Ç’është herezia (ilhadi) dhe cila është dispozita e Sheriatit për heretikun?

- Ilhad do të thotë të shmangurit nga Islami dhe devijimi nga ai në çarëdo lloj formë. Pra ai që ka devijuar nga rruga e Allahut ose që kundërshton fenë e Tij me komente jo të vërteta është mulhid (heretik). Nën këtë term hyn ai që mohon ekzistencën e Zotit, ai që e zëvendëson Allahun me ndonjë zot tjetër dhe e adhuron atë, i lutet atij, e do dhe e madhëron atë, ai që pranon ide dhe ligje që kundërshtojnë ligjin e Allahut. Gjithashtu në këtë grup futet edhe ai që tekstet e Shpalljes, ajete ose hadithe, ia përshtat mendimit dhe dëshirave të tij duke ua shtrembëruar atyre kuptimin. Allahu thotë:

“Allahu ka Emra të mirë, andaj Atë thirrëni me ato e largohuni nga ata që bëjnë shtrembërime me Emrat e Tij. Ata kanë për t’u shpërblyer për veprimet e tyre.” (Araf: 180)

Katade r.a. thotë, “Julhidune do të thotë ata që bëjnë shirk në Emrat e Tij”. Ndërsa nga Ibn Abbasi r.a. transmetohet se, “Ilhad – do të thotë përgënjeshttrim”.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata që shtrembërojnë argumentet Tona nuk mund të na fshihen.” (Fusilet: 40)

Gjykimi për heretikun ndryshon në vartësi të herezisë, po përmendim disa: a) Ai që mohon ekzistencën e Zotit ose mohon diç nga Emrat dhe Cilësitë e Allahut është kafir, b) ai që i lutet tjetërkujt veç Allahut ose kërkon ndihmë prej të vdekurve ka bërë shirk, c) ai që shtrembëron kup-timin e Emrave dhe Cilësive të Allahu që përmenden në Kur'an dhe Sunet është në humbje të qartë.

O Zot kërkojmë mbrojtje të Ti nga të gjitha llojet e herezisë.⁷

12) Kush e ka krijuar Allahun?

- Nëse shejtani ia cytë ndokujt këtë pyetje, le të kërkojë mbrojtje tek Allahu. Allahu thotë:

“E nëse ty të ngacmon (ndonjë ngacmim prej) shejtani, ti kërko mbrojtje nga Allahu, se me të vërtetë Ai është Dëgjuesi, i Dijshmi.” (Fussilet: 36)

I Dërguari i Allahut alejhi selam na ka mësuar që në këtë rast të themi, ‘Amentu bil-lahi ue rusulihi, Allahu ehad, Allahus-samed, lem jelid ue lem juled ue lem jekun lehu kufuuen ehad’ pastaj le të pështyjë tri herë në të majtë dhe le të kërkojë mbrojtje tek Allahu nga shejtani.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “O Zot, Ti je i Pari, s’ka gjë para Teje.” (Transmeton Muslimi.)

13) Si ka qenë akidja e mushrikëve (idhujtarëve) para Islamit?

- Mushrikët para Islamit u janë lutur eulijave (njerëzve të mirë) për t’iu afruar Allahut e për të kërkuar ndërmjetësim mes tyre dhe Allahut. Allahu thotë:

⁷- Marrë nga libri “El-Exhvibel-mufide” të Deuserit.

“Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut.” (Zumer: 3)

Ata adhuronin i dhujt duke thënë: **“Këta janë ndërmjetësit tanë tek Allahu.”** (Junus: 18)

14) Cilat janë llojet e frikës?

- Frika ndahet në dy lloje, frikë natyrore dhe frikë në për shkak të besimit.

a) Frika për shkak të besimit është frika nga diçka për të cilën personi mendon se mund ta dëmtojë ose ndëshkojë duke pasur mundësi përtej caqeve të njeriut. Kjo frikë në qoftë se ekziston ndaj dikujt apo diçkaje tjetër veç Allahut është shirk i madh. Allahu thotë:

“... ju mos u frikësoni prej tyre, frikësomuni Mua, nëse jeni besimtarë.” (Ali Imran: 175)

“A nuk është Allahu që i mjafton robit të Vet (Muhamedit). E ata të frikësojnë ty me të tjerë veç Tij.” (Zumer: 36)

b) Frika natyrore është frika që ndjen njeriu nga krijesat e gjalla të cilat mund t'i bëjnë atij keq, p.sh. frika ndaj kafshëve të egra, frika ndaj një njeriu më të fuqishëm që kërkon të të dëmtojë. Kjo vepër nuk përbën shirk. Allahu thotë në Kur'an:

“E Musai ndjeu në vetvete njëfarë frike.” (Taha: 67)

“Madje unë kam një faj ndaj tyre, e kam frikë se do të më mbysin.” (Shuara: 14)

Llojet e shirkut

1) Cilat janë llojet e shirkut?

- Shirku ndahet në disa lloje:

a) Shirku në veprat e Allahut. Këtu futet besimi i egzistencës së zotave të tjerë veç Allahut, besimi që krijesa të caktuara kanë në kontroll pjesërisht apo potësisht kontrollin ndaj krijesave duke i mbajtur ato në egzistencë, duke i furnizuar etj., besimi se krijesa të caktuara gjykojnë apo vendosin për të ardhmen në ahiret si dhe çdo shoqërim që i bëhet Allahut në veprat e Tij.

Allahu thotë në Kur'an:

“Kush rregullon çdo çështje? Ata do të thonë: “Allahu”. ”

(Junus: 31)

b) Shirku në adhurim. Në këtë lloj shirku futet çdo adhurim që i bëhet dikujt tjetër veç Allahut ose bashkë me Të. Allahu thotë:

“Thuaj: “Unë adhuroj vetëm Zotin tim dhe Atij nuk i bëj asnjë shok.” (Xhin: 20)

c) Shirku në Cilësitë dhe Emrat e Allahut. Këtu futet çdo veprim që i jep apo i atribon ndonjë krijese Emra dhe Cilësi të Allahut, p.sh. mendimi se të fshehtën (gajbin) e di ndonjë krijesë. Allahu thotë:

“Asgjë nuk është si Ai.” (Shura: 11)

“Thuaj: “Askush veç Allahut as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtën”. ” (Neml: 65)

I Dërguari i Allahut thotë: “Nuk e di gajbin (të fshehtën) askush veç Allahut.” (Transmeton Taberani. Hadithi është i mirë.)

2) A shfaqet akoma shirku?

- Shirku shfaqet akoma edhe sot. Mushrikët e hershëm besonin se Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi, por u luteshin eulijave të personifikuar në idhuj, për të ndërmjetësuar për ta tek Allahu. Allahu thotë:

“Ndërsa ata që në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë duke thënë: “Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na ofrojnë sa më afër Allahut; s’ka dyshim se Allahu do t’i gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E është e vërtetë se Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është rrenës, jobesimtar.” (Zumer: 3)

Allahu dëgjon, është afër, nuk ka nevojë për ndërmjetësues. Ai thotë qartë në Kur’an:

“E kur robët e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet.” (Bekare: 186)

Ashtu siç kanë bërë mushrikët e hershëm po ashtu janë duke bërë edhe shumë njerëz që u luten eulijave të vdekur duke u munduar që me këtë t’i afrohen Allahut.



Dëmet e shirkut të madh

1) Cilat janë dëmet e shirkut të madh?

- Shirku i madh është shkak që një personi të mbetet në Zjarr përgjithmonë. Allahu thotë:

“Atij që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) Xhenetin dhe vendi i tij është Zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.” (Maide: 72)

I Dërguari i Allahut alejhi selam ka thënë: “Secili që e takon Allahu duke i bërë shirk Atij, hyn në Xhehenem.”

2) A është e dobishme vepra e mirë nëse i bëhet shirk Allahut?

- Nëse i bëhet shirk Allahut nuk ka dobi nga vepra e mirë, sepse Allahu thotë:

“E sikur t’i përshkruajnë shok Zotit, do t’u shkojë huq ajo që kanë vepruar.” (En’am: 88)

Muhamedi alejhi selam thotë se Allahu thotë: “Unë jam aq i pasur sa që nuk kam nevojë për ortak. Kush bën ndonjë vepër duke më bërë në të shirk, do ta le atë dhe shirkun e tij.” Transmeton Muslimi.



Shirku i vogël dhe llojet e tij

1) Ç'është shirku i vogël?

- Shirku i vogël është kryrja e diçkaje prej Islamit jo për hatër të Allahut. Allahu thotë:

“E kush e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin e Zotit të tij mos të përzejë askënd.” (Kehf: 110)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Ajo që më frikëson më shumë për ju është shirku i vogël, që është hipokrizia (syfaqësia).” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është sahih.)

Në shirkun e vogël hyjnë edhe shprehjet “po të mos ishte Allahu dhe filani do të vdisja”, “ç’do Allahu dhe ti”, “po mos të jetë qeni vijnë vjedhësit”, etj. sepse Muhamedi alejhi selam thotë: “Mos thoni, ‘ç’do Allahu dhe filani’, por thoni, ‘ç’do Allahu pastaj filani’.” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është sahih.)

2) A lejohet betimi në emër të krijesave?

- Jo, nuk lejohet betimi në emër të dikujt tjetër veç Allahut. Allahu thotë:

“Thuaj: “Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjalleni.” (Tegabun: 7)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush betohet në dikë tjetër veç Allahut ka bërë shirk.” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është i vërtetë.)

“Kush don të betohet, le të betohet në emër të Allahut ose le të hesht.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

Betimi në emër të Pejgamberëve apo eulijave është shirk i madh në rast se ai që betohet beson se nëse betohet rrejshëm në Pejgamberë apo eulijatë këta të fundit do të hakmerren.

3) A lejohet vendosja e diçkaje në trup apo diku tjetër me qëllim shërimit apo mbrojtje nga të këqijat?

- Jo, kjo gjë nuk lejohet. Allahu thotë:

“Nëse Allahu të godet me ndonjë të keqe, s’ka kush që ta largojë atë veç Tij.” (En’am: 17)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush vë hajmali (nuska) ka bërë shirk.” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është sahih.)



Të afruarit tek Allahu dhe të kërkuarit ndërmjetësim

1) Përpjekja për t'ia afruar Allahut.

- Njerëzit përpiqen t'i afrohen Allahut në forma të ndryshme. Këto forma ndahen në dy lloje a) forma të lejuara dhe b) forma të ndaluara.

a) Format e lejuara të afrimit tek Allahu janë vetëm ato forma që janë në përputhje me Islamin. Këtu futen të gjitha veprat e mira të cilat janë argumentuar si të tilla nga Islami. Veprat e mira me të cilat personi i afrohet më shumë Allahut janë kryerja e farzeve (veprave të detyrueshme si namazi, zekati, agjërimi, haxhi etj.), pastaj vjen kryerja e veprave fakultative (suneteve). Allahu thotë:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe kërkonin afrim tek Ai.” (Maide: 35)

b) Format e ndaluara janë ato forma që bien ndesh me Islamin. Ato jo vetëm që nuk e afrojnë personin tek Allahu, por bëhen shkak për ndëshkimin e personit. P.sh. përpjekja për t'iu afruar Allahut duke iu lutur një ose disa ndërmjetësuesve etj.. Allahu thotë:

“Dhe mos lut tjetërkë veç Allahut, sepse ai nuk mund të të sjell as dobi as dëm. Nëse e bën atë, dije se i ke bërë padrejtësi vetes.” (Junus: 106)

2) A ka nevojë duaaja (lutja) për ndërmjetësim?

- Duaaja nuk ka nevojë për ndërmjetës. Allahu thotë:

“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet.” (Bekare: 186)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ju i luteni Atij që dëgjon dhe është afër, është me ju (me diturinë e Tij).” (Transmeton Muslimi.)

3) A lejohet të kërkohet dua prej të gjallëve?

- Po, lejohet të kërkohet dua prej të gjallëve. Allahu duke iu drejtuar Muhamedit alejhi selam thotë:

“Kërko falje për gjynahin tënd dhe për gjynahin e besimtarëve e të besimtareve.” (Muhamed: 19)

Tirmidhiu transmeton në hadith të vërtetë: “Një person i verbër erdhi te Muhamedi alejhi selam dhe i tha: “Lutju Allahu të më shëroj.” Muhamedi alejhi selam i tha: “Nëse dëshiron i lutem Allahut, por durimi është më i mirë për ty ...”

4) Ç’është ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut alejhi selam?

- Ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut alejhi selam është kumtimi i thirrjes së Allahut. Allahu thotë:

“O ti i Dërguar, komunikoje atë që t’u zbrit prej Zotit tënd.” (Maide: 67)

Muhamedi alejhi selam thotë, ‘O Zot dëshmo’, duke iu përgjigjur fjalës së shokëve të tij, ‘dëshmojmë se e ke kumtuar këtë thirrje’. (Transmeton Muslimi)

5) Prej kujt duhet ta kërkojmë ndërmjetësimin e Pejgamberit alejhi selam?

- Ndërmjetësimin e Pejgamberit alejhi selam e kërkojmë prej Allahut. Allahut thotë:

“Thuaj: “Tërë shefaati (ndërmjetësimi) i takon vetëm Allahut.” (Zumer: 44)

Muhamedi alejhi selam i ka mësuar shokët e tij të thonë: “O Zot pranoje shefaatin e tij (Muhamedit alejhi

selam) për mua.” (Transmeton Tirmidhiu dhe thotë se hadithi është i mirë, i vërtetë.)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ruaj lutjen time që të jetë ndërmjetës në Ditën e Kijametit për atë që vdes nga umeti im duke mos i bërë shirk Allahut.” (Transmeton Muslimi.)

6) A kërkojmë shefaat prej të gjallëve?

- Në çështje të kësaj bote është e lejuar kërkesa e shefaatit prej të gjallëve. Allahu thotë:

“Kush ofron ndihmë të mirë, do të ketë pjesë nga ajo dhe kush ofron ndihmë të ndonjë të keqe, do të ngarkohet me të.” (Nisa: 85)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ofroni ndihmë, të shpërbleheni.” (Hadithi është sahih, transmeton Ebu Daudi.)

7) Sa duhet lavdëruar i Dërguari i Allahut alejhi selam?

- I Dërguari i Allahut alejhi selam duhet lavdëruar aq sa i takon atij sipas Islamit. Allahu thotë:

“Thuaj (o Muhamed alejhi selam): “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj.” (Kehf: 110)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Mos më lavdëroni tepër, ashtu siç e kanë lavdëruar të krishterët Isain, birin e Merjemes. Unë jam rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij. ...” (Transmeton Buhari)

Të vepruarit me Kur'an dhe Sunet

1) Pse e ka zbritur Allahu Kur'anin?

- Allahu e zbriti Kur'anin për të na udhëzuar me të.

Allahu thotë: **“Pasoni atë që u është zbritur nga Zoti juaj.”** (Araf: 3)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Lexoni Kur'anin dhe veproni sipas tij ...” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është i vërtetë.)

2) Çfarë i sqaron Kur'ani njeriut?

- Kur'ani i sqaron njeriut njohjen e Krijuesit, i Vetmi i Cili meriton të adhurohet dhe urdhëron largimin nga idhujtaria.

Allahu urdhëron Pejgamberin alejhi selam e Tij të thotë:

“Unë adhuroj vetëm Zotin tim dhe Atij nuk i bëj asnjë shok.” (Xhin: 20)

3) Pse e lexojmë Kur'anin e madhëruar?

- Kur'ani lexohet për t'u kuptuar dhe për t'u udhëhequr me të. Allahu thotë:

“(Kur'ani) Libër i begatshëm, ne ta shpallëm ty këtë, që njerëzit t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad: 29)

Kur'ani është litar i fortë i Allahut, është përkujtues i urtë, është rrugë e drejtë, është libër prej të cilit nuk mund të të largojnë epshet nga rruga e drejtë nëse udhëzohesh nga ai, nuk është i rëndë për ta lexuar, nuk harxhohen mrekullitë e tij, nuk ngopen nga ky libër dijetarët, kush flet me të thotë të vërtetën, kush vepron me të shpërble-

het, kush gjykon me të gjykon drejt, kush thërret në të udhëzohet në rrugë të drejtë, është libër që kur e kanë dëgjuar xhinët kanë thënë, ‘**kemi dëgjuar një Kur’an që mahnit**’ (Xhinn: 1).

4) A është Kur’ani për të gjallë apo për të vdekur?

- Allahu e ka zbritur Kur’anin për të gjallët, që të veprojnë me të sa janë gjallë, e nuk është zbritur për të vdekurit, ngase puna e tyre është ndërprerë dhe ata nuk mund të lexojnë e as të veprojnë me të. Allahu thotë:

“Për t’ia tërhequr vërejtjen atij që është i gjallë dhe dënimi të bëhet meritë për jobesimtarët.” (Jasin: 70)

“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër përveç asaj që ka punuar.” (Nexhm: 39)

I Dërguari i Allahut alejhi selam thotë: “Kur të vdesë njeriu i ndërpriten veprat e tij veç tri rasteve: sadakasë rrjedhëse, diturisë nga e cila kanë dobi njerëzit dhe fëmija i mirë që bën dua për të.” (Transmeton Muslimi)

5) Cili është gjykimi i të vepruarit me hadith të vërtetë?

- Veprimi me hadith të vërtetë është uaxhib (i detyrueshëm). Allahu thotë:

“Çka t’ju jap Pejgamberi atë merrni e çka t’ju ndalojë, përmbahuni.” (Hashër: 7)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Është detyra juaj të kapeni pas Sunetit tim dhe pas sunetit të halifëve të drejtë. kapuni për të me dhëmballë (fortë) ...” (Transmeton Ahmedi. Hadithi është i vërtetë.)

6) A na mjafton vetëm Kur’ani?

- Jo nuk na mjafton vetëm Kur’ani, por duhet patjetër edhe Suneti. Allahu thotë:

“Ty ta zbritëm Kur’anin që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë.”
(Nahl: 44)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Më është dhënë Kur’ani dhe një gjë e tillë me të.” (Hadithi është sahih, transmeton Ahmed.)

7) A i duhet dhënë përparësi fjalës së ndokujt para Fjalës së Allahut dhe Pejgamberit të Tij alejhi selam?

- Jo, nuk mund të ketë asgjë para Fjalës së Allahut dhe asaj të të Dërguarit të Tij. Allahu thotë:

“O besimtarë, mos bëni asgjë para Zotit dhe të Dërguarit të Tij.” (Huxhurat: 1)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Nuk respektohet krijesa duke mëkatuar para Krijuesit.” (Hadithi është sahih, transmeton Ahmed.)

Ibn Abbasi thotë: “Kam frikë se mund të bien gurë nga qielli. Unë u them ka thënë Pejgamberi alejhi selam e ju më thoni ka thënë Ebu Bekri, ka thënë Umeri.”

8) Cili është vendimi i Islamit për të gjykuarit me Kur’an dhe Sunet në jetën tonë të përditshme?

- Është obligim të gjykohet me Kur’an dhe Sunet në jetën tonë të përditshme. Allahu thotë:

“Për Zotin tënd, jo ata nuk janë besimtarë përderisa të mos të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt që ka ndodhur mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe të mos binden sinqerisht.”
(Nisa: 65)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Nëse kryetarët e tyre nuk gjykojnë me Librin e Allahut dhe zgjedhin (marrin diçka dhe lënë diçka tjetër) nga ajo që ka zbritë Allahu,

Allahu do të lëshojë fatkeqësi mes tyre.” (Hadithi është hasen, transmeton Ibn Maxhe.)

9) Ç’duhet bërë nëse nuk pajtohemi në ndonjë çështje?

- Nëse nuk pajtohemi në ndonjë çështje, i kthehemi Kur’anit dhe Sunetit. Allahu thotë:

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek Allahu (te Libri i Tij) dhe tek i Dërguari i Tij, nëse i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” (Nisa: 59)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ju kam lënë dy gjëra; Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij. Nuk do të humbisni nëse kapeni pas tyre.” (Hadithi është sahih, transmeton Maliku.)

10) Cili është gjykimi për personin që mendon se urdhërat dhe ndalesat e Sheriatit nuk vlejnë për të?

- Ky person është kafir (mosbesimtar). Adhurimi i takon vetëm Allahut e në adhurim futet edhe të gjykuarit me Sheriat. Të bërit hallall ose haram i diçkaje është shirk i madh.

11) Si e shfaqim dashurinë ndaj Allahut dhe Përgamberit të Tij alejhi selam?

- Dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij shfaqet duke respektuar dhe duke shkuar pas urdhëresave të tyre. Allahu thotë:

“Thuaj (Muhamed): “Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë e t’ua falë mëkatet, se Allahu është që falë shumë, mëshiron shumë.” (Ali Imran: 31)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Nuk beson askush prej juve derisa unë të jem tek ai më i dashur se prindërit e tij, fëmijët e tij dhe mbarë njerëzit.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)



Të besuarit në kaderin (përcaktimin) e Allahut, qoftë për të mirë apo për të keq

1) A lejohet të argumentojmë me kader për atë që na ndodh?

- Po, lejohet të argumentojmë me kader për fatkeqësitë që na ndodhin, ngase ato ndodhin me kadanë dhe kaderin e Allahut. Allahu thotë:

“Çfarëdo e keqe që ndodhë, nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të Allahut.” (Tagabun: 11)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ki kujdes atë që të bën dobi dhe kërko ndihmë prej Allahut, e mos u bëjë i pamundshëm. Nëse të godet ndonjë e keqe mos thuaj: sikur të veproja kështu e ashtu do të ishte kështu e ashtu, por thuaj: “Kaderallahu ue huue ma shae fe’ale (kader i Allahut e Ai vepron ç’të dojë), ngase fjala ‘sikur’ ia hapë derën shejtanit.” (Transmeton Muslimi.)

Përsa i përket argumentimit me kader për mëkatet që bëhen, kjo vepër është specifike për mushrikët. Allahu thotë:

“E ata që i shoqëruan Zotit, do të thoshin: “Sikur të donte Allahu nuk do t’i bënim shok, as ne as prindërit tanë, e as nuk do të ndalonim asnjë send.” (En’am: 148)

Ai që argumenton me kader në këtë çështje është injorant, pasues symbyllur ose është jobesimtar, kokëfortë dhe në të njëjtën kohë është kontradiktor në atë që thotë, ngase nëse ndokush e sulmon nuk thotë se kjo ndodhi sipas kaderit të Allahut, por do mundohet të hakmerret. E si mundet pas kësaj të thotë, ‘është paracaktimi i Allahut’?!

Allahu ka dërguar Pejgamberë dhe ka zbritur Libra që t'ua sqarojë njerëzve rrugën e lumturisë dhe fatkeqësisë, gjithashtu i dha mendjen që të dallojë rrugën e drejtë dhe rrugën e shtrembër. Allahu thotë:

“Ne e udhëzuar atë në rrugë të drejtë, e ai do të jetë mirënjohës ose përbuzës.” (Insan: 13)

“Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi veten e ka dështuar ai që e poshtëroi veten.” (Shems: 8-10)

Nëse një person lë namazin ose pi alkoolool meriton dënimin e Allahut, ngase kundërshton urdhërin e Allahut dhe Pejgamberit alejhi selam Në këtë rast ky person duhet të pendohet e jo të argumentohet me kader, sepse kjo nuk i bën dobi.

2) A duhet lënë puna e të mbështetemi në kader?

- Jo nuk duhet të lëmë punën, ngase Allahu thotë:

“E sa i përket atij që jep dhe ruhet dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatisim atë për më të lehtë.” (Lejl: 5-7)

Muhamedi alejhi selam thotë:

“Punoni, ngase çdokujt i lehtësohet rruga për atë që është krijuar.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi)

“Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu nga besimtari i dobët, e në të dy ka dobi. Ki kujdes atë që të bën dobi dhe kërko ndihmë prej Allahut, e mos u bëjë i pamundshëm. Nëse të godet ndonjë e keqe mos thuaj, ‘sikur të veproja kështu e ashtu do të ishte kështu e ashtu’, por thuaj, ‘kaderallahe ue ma shae fe’ale’ (kader i Allahut, Ai ç’do vepron), ngase fjala ‘sikur’ i hapë derën shejtanit.” (Transmeton Muslimi.)

3) Urtësia në fatkeqësi.

- Njeriu, si krijesë, kur ndien se është i fuqishëm bëhet kryelartë e mizor dhe fillon të besojë se nuk mund ta mposhtë askush, mirëpo kur sheh se fuqia i është dobësuar dhe kupton se është i pafuqishëm, sheh të vërtetën dhe bindet se ai nuk ka fuqi absolute. Në këtë mënyrë njeriu i kthehet Allahut, i bindur se vetëm Ai mund ta ndihmojë dhe ta shpëtojë dhe se vetëm Ai ka fuqi absolute. Allahu thotë:

“Ne kur e begatojmë njeriun, ai nuk falenderon dhe largohet, e kur e godet e keqja, ai përulet dhe lutet shumë.”
(Fussilet: 51)



Suneti dhe bidati

1) A ka nevojë Islami për gjëra të reja?

- Jo, Islami është feja e përsosur e Allahut e si e tillë nuk ka nevojë për futjen e gjërave të reja. Allahu thotë:

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe.” (Maide: 3)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kijini frikë risitë, se çdo risi është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje dërgon në Zjarr.” (Hadithi është sahih, transmeton Nesaiu dhe të tjerët.)

2) Ç’është bidati në fe?

- Çdo vepër që s’ka argument në Sheriat është bidat.⁸

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush shpikë në fenë tonë gjë që nuk është prej saj, (kjo vepër) është e refuzuar.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

3) Llojet e bidatit

- Bidati është shumëllojësh, por më të rëndësishmet janë:

a) Bidat që shpie në kufër, siç është lutja që u bëhet të vdekurve dhe kërkimi ndihmë prej tyre.

b) Bidat i ndaluar (që është harram) siç është të falurit drejt varreve etj.

8- Ky përkufizim i bidatit është pak i shkurtër, për këtë shkak e shoh të arsyeshme të jap përkufizimin që ka dhënë Shatibiu në librin e tij “Eli’tisam” f. 1/37 ku thotë: “Bidat është çdo rrugë e shpikur në fe që rivalizon Sheriatin, duke pasë për qëllim me këtë vepër të afruarit Allahut, për të cilën vepër nuk ka argument të Sheriatit as në bazë e as në cilësi”. Sh.p.

c) Bidat i urryer, siç është të falurit e drekës pas xhumasë, etj.

4) A ka Islami sunete të mira?

- Po, në Islam ka sunete të mira, të cilat janë vepra që kanë argument në Islam, siç është p.sh. sadakaja.

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush kryen në Islam një sunet të mirë, do të shpërblehet për të. Gjithashtu do të ketë shpërblim se ka bërë që të tjerët ta kryejnë atë sunet të mirë, pa e pakësuar shpërblimin e tyre.” (Transmeton Muslimi)

5) Ç’është asketizmi (zuhdi)?

- Asketizmi i vërtetë është atëherë kur një musliman nuk e bën botën qëllim e as që i jep përparësi para ahiretit. Qëllimi i tij është arritja e Mëshirës së Allahut ndaj tij duke vepruar vepra të mira.

Nuk është zuhd në përputhje me Islamin largimi nga puna dhe çështjeve të kësaj bote, duke bërë jetë të varfër. Kjo gjë nuk lejohet. Kjo është vetëm frikë dhe dobësi shpirtërore që çon në mosaktivizimin e fuqive dhe mundësive njerëzore. Ky lloj zuhdi është bidat sufist që duhet luftuar dhe zhdukur.

6) Cili është gjykim për taklidin?⁹

- Muslimanit nuk i lejohet të bëjë taklid në bazat e Islamit dhe në teuhid, por e ka obligim ta kuptojë këtë fe ashtu siç e ka shpallur i Dërguari i Allahut duke u bazuar në Kur’an dhe hadith të vërtetë e duke i kuptuar këto ashtu siç i kanë kuptuar të parët tanë të mirë.

Përsa i përket degëve të fesë, lejohet taklidi i cilitdo medhheb prej medhhebeve të Ehli Sunnetit edhe pse nuk

9- Taklid është të pasuarit e një dijetari, symbyllur, duke mos pyetur për argumentin. Sh.p.

i përmbahet rreptësisht ndonjërit medhheb prej medhhebeve, me kusht që të mos kërkojë më të lehtin.¹⁰

Kurse përsa i takon dijetarit, ai duhet të kërkojë argumentin e vërtetë dhe të ketë kujdes e të bazohet në atë që është më afër Sunetit të të Dërguarit të Allahut alejhi selam.¹¹



10- Kjo i lejohet atij që nuk ka mundësi të hulumtojë argumentin, kurse, ai që ka mundësi të hulumtojë argumentin duhet të kapet pas argumentit. Sh.p.

11- Duke vepruar me fjalën e të gjithë imamëve, 'nëse hadithi është i vërtetë, ky është medhhebi im'.

Grupi i shpëtuar dhe pala e ndihmuar

1) Cili është grupi i shpëtuar?

- Grupi i shpëtuar është ai grup që pason menhexhin (metodën) e Pejgamberit alejhi selam dhe të shokëve të tij, pra që i përmbahet Kur'anit dhe Sunetit. Allahu thotë:

“Dhe kapuni që të gjithë për litarin (fenë, Kur'anin dhe Sunetin) e Allahut, e mos u përçani.” (Ali Imran: 103)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Jehuditë janë ndarë në 72 grupe. Umeti im do të ndahet im 73 grupe, të gjithë do të jenë në Zjarr veç njërit. Në atë grup janë ata që do të jenë në atë që jam unë dhe shokët e mi.” (Transmeton Tirmidhiu. Albani thotë se ky hadith është hasen.)

2) Cila është pala e ndihmuar?

- Muhamedi alejhi selam thotë:

“Do të vazhdojë (të mbetet) një palë nga umeti im që do të përqëndrohet në të vërtetën dhe do të luftojë për të. Ata janë dijetarët.” (Transmeton Buhari)

“Do të vazhdojë (të mbetet) një palë nga umeti im që do të përqëndrohet në të vërtetën. Atyre nuk do të mund t'u bëjnë dëm ata që do të mundohen t'i frikësojnë e t'i kthejnë nga kjo rrugë derisa të vijë urdhëri i Allahut (Kijameti).” (Transmeton Buhari)

Duke përshkruar këtë palë Ibn Haxher thotë: “Këta do të jenë në Bejtul-Makdis (Kuds – Jeruzalem), do të jenë nga Shami do të posedojnë fuqi në Xhihadin e tyre kundër armikut dhe do të kenë ashpërsi dhe durim në të.” (Fet'hul- Bari 13/295)

Neueuiu thotë: “Kjo palë mund të jetë grup i llojllojshëm, prej të gjithë llojeve të besimtarëve; ndërmjet tyre është trimi, njohësi ushtarak, fakihi (dijetari i fikhut), muhadithi (dijetari i hadithit), mufesiri (komentuesi i Kur’anit), ai që urdhëron në të mirë dhe që ndalon nga e keqja, asketi, adhuresi etj. Kjo nuk do të thotë se ata duhet të jenë në një vend, por mund që të jenë të shpërndarë në shumë vende. Si është e mundur të jenë në një vend?”

Ibn Mubareku thotë: “Në këtë palë, sipas mendimit tim, janë dijetarët e hadithit.”

Si konkluzion mund të themi: Në këtë palë janë ata që kapen pas hadithit të të Dërguarit të Allahut alejhi selam dhe nuk i japin përparësi asnjë fjale para fjalës së Allahut dhe fjalës së të Dërguarit të Tij, duke praktikuar kështu Fjalën e Allahut:

“O besimtarë, mos u jepni përparësi askujt para Allahut dhe të Dërguarit të Tij.” (Huxhurat: 1)

3) Kur do të fitojnë muslimanët?

- Muslimanët do të korrin fitore nëse i rikthehen zbatimit të Kur’anit të Madhëruar dhe Sunetit të Pejgamberit alejhi selam, nëse përhapin teuhidin, i tërheqin vërejtje njerëzve nga shirku. Allahu thotë:

“O besimtarë, nëse ju ndihmoni (fenë) Allahun, Ai u ndihmon juve dhe i forcon këmbët tuaja.” (Muhamed: 7)

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu siç i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ata do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë.” (Nure: 55)

“E ju përgatituni sa të keni mundësi e forcë (mjete luftarake).” (Enfal: 60)

Vizita e varreve

1) Si dhe pse t'i vizitojmë varret?

- Vizita e varreve është e pëlqyer në çdo rast. Kjo vizitë ka dobi dhe bëhet sipas rregullave:

a) Në vizitën e varreve ka përkujtim dhe këshillim. Me këtë rast të gjallët kujtojnë se do të vdesin dhe do të japin llogari për veprat e tyre.

Muhamedi alejhi selam thotë: “Ua pata ndaluar t'i vizitoni varrezat, tani vizitohuni ato, që kjo vizitë t'u përkujtojë të mirën.” (Transmeton Muslimi)

b) Ti lutemi Allahut për të vdekurit.

Muhamedi alejhi selam i ka mësuar shokët e Tij që gjatë vizitës së varreve të thonë: “Es-selamu alejkum ehleddij-jari minel-mu'minine uel-muslimin, ue inna insha Allahu bikum lahikun, es'elullahe lena ue lekumul-afije (paqja e Allahut qoftë mbi ju, banorë të këtij vendi, besimtarë e muslimanë, ne, nëse do Allahu, pas jush do të vijmë këtu. I lutemi Allahut për ne dhe për ju të na shpëtojë).” (Transmeton Muslimi)

c) Ndalohet të ulurit mbi varre dhe të falurit drejt tyre.

Muhamedi alejhi selam thotë: “Mos u falni në drejtim të varreve e as mos u ulni mbi to.” (Transmeton Muslimi.)

d) Ndalohet leximi i pjesëve nga Kur'ani.

Muhamedi alejhi selam thotë: “Mos i bëni shtëpitë tuaja varre, ngase shejtani largohet nga shtëpia në të cilën lexohet sureja Bekare.” (Transmeton Muslimi.)

Muhamedi alejhi selam pasi është varrosur dikush ka thënë: “Lutjuni Allahut t'ia falë mëkatet vëllait tuaj dhe kërkonin prej Allahut që ta përforcojë, sepse ai tash pyetet.” (Transmeton Hakimi, hadithi është sahih.)

e) Ndalohet vënija e kurorës me lule, sepse këtë ve për nuk e ka bërë Muhamedi alejhi selam e as shokët e tij. Gjithashtu ky veprim është edhe përngjasim me të krishterët, përngjasim i cili është ndaluar në i Dërguari i Allahut alejhi selam.

f) Ndalohet ndërtimi mbi varre dhe zbukurimi i tyre.

Transmetohet në hadith të vërtetë se Muhamedi alejhi selam ka ndaluar ngjyrosjen e varreve dhe ndërtimin mbi to. (Transmeton Muslimi.)

2) Dënimi dhe përgëzimi në varr.

- Allahu thotë: **“Ithtarët e faraonit i përfshiu dënimi më i keq. Ata i nënshtrohen Zjarrit mëngjes e mbrëmje (në varr) e Ditën e Kijametit (u thuhet engjëjve): “Ithtarët e faraonit futini në dënim më të rëndë.””** (Gafir: 45, 46)

“Allahu forcon ata që besuan me fjalë të fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër.” (Ibrahim: 27)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kur të vdes ndonjëri prej jush i paraqitet atij në mëngjes e në mbrëmje vendi i tij. Nëse është prej banorëve të Xhenetit i paraqitet atij vendi i tij në Xhenet, e nëse është prej banorëve të Xhehenemit i tregohet atij vendi i tij në Xhehenem dhe i thuhet, ‘Ky është vendi yt pas ringjalljes tënde në Ditën e Kijametit’.” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

3) Çfarë pyetjesh do t’i bëhen njeriut në varr?

- Transmetohet në hadith të vërtetë se besimtarit i vijnë dy melekë, e ulin atë dhe e pyesin:

a) Kush është Zoti yt? Thotë (besimtari): Zoti im është Allahu.

b) Cila është feja jote? Thotë: Feja ime është Islami.

c) Kush është ai person që është dërguar te ju? Thotë: Ai person është i Dërguari i Allahut.

d) Kush ta ka mësuar këtë? Thotë: Kam lexuar Librin e Allahut dhe kam besuar në të.

Pas kësaj një thirrës thërret nga qielli, “Të vërtetën ka thënë robi im, pra shtrojini atij shtroje nga Xheneti, visheni me rroba të Xhenetit dhe hapjani dyert për në Xhenet. Nga Xheneti vjen freski dhe erë e mirë e varri i zgjerohet atij aq sa sheh syri.

Kurse mosbesimtarit i vijnë dy melekë e ulin dhe i thonë:

a) Kush është Zoti yt? Thotë (mosbesimtari): A, a, a, nuk e di.

b) Cila është feja jote? Thotë: A, a, a, nuk e di.

c) Kush është ai person që është dërguar te ju? Thotë: A, a, a, nuk e di.

Pas kësaj thërret një thirrës nga qielli: “Gënjeu robi im, pra shtrojini atij shtroje nga Zjarri dhe hapjani dyert për në Zjarr, e nga Xhehenemi vjen nxehësia dhe helmi i Xhehenemit. Atij i ngushtohet varri aq sa brinjët i hyjnë njëra nën tjetrën.” (Transmeton Ahmedi, Ebu Daudi. Albani thotë se hadithi është sahih.)

4) A lejohet që ndokush të përgatitet për të vizituar ndonjë varr të veçantë?

- Jo, nuk lejohet që ndokush të përgatitet për të vizituar ndonjë varr të veçantë, sidomos nuk është e lejuar nëse kjo vizitë bëhet me qëllim që të merret bereqet nga ai varr ose për të kërkuar dua prej tij, edhe nëse ky varr është varri i Pejgamberit alejhi selam Allahu thotë:

“Ç’ka t’ju japë Pejgamberi atë merreni e çka t’ju ndolojë, përmbajuni.” (Hashr: 7)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Mos u përgatitni për vizitë veç për këto tri xhami: Mesxhidi Haram (Ka’ben), këtë mesxhid (xhaminë e Muhamedit alejhi selam) dhe

mesxhidi Aksanë (që gjendet në Kuds, Palestinë).” (Transmeton Buhari dhe Muslimi.)

Kështu që nëse dëshirojmë praktimin e këtij hadithi, qëllimi i shkuarjes sonë në Medine duhet të jetë vizita e xhamisë së Muhamedit alejhi selam, e jo vizita e varrit të tij. Kur të hysh në xhami vetëm i jep selam Muhamedit alejhi selam.

5) Cili është qëllimi i besimtarit dhe i mosbesimtarit?

- Qëllimi i besimtarit në këtë jetë është të kënaqë Krijuesin me adhurimin e tij dhe t'i afrohet Atij me vepra të mira, duke respektuar urdhërat e Tij. Allahu thotë:

“O ju që besuat: “Kini frikë Allahun dhe kërkonj afrim tek Ai, luftoni në rrugën e Tij që të gjeni shpëtimin”.”
(Maide: 35)

Ndërsa mosbesimtari jeton për të kënaqur epshet e tij momentale, duke harruar fundin që e pret. Ky person është si kafshë. Allahu thotë:

“Ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë) dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është Zjarri.”
(Muhamed: 12)



Thirrja e njerëzve për tek Allahu

1) Gjykimi për thirrjen e njerëzve për tek Allahu.

- Thirrja në rrugë të Allahut është detyrë e çdo muslimani që ka trashëguar Kur'anin dhe Sunetin e Muhamedit alejhi selam Çdo musliman e përfshinë urdhëri i Allahut kur thotë:

“Ti thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.” (Nahl: 125)

2) A mjafton që një person të përmirësojë vetëm vetveten?

- Medoemos muslimani duhet së pari të përmirësojë vetveten e pastaj të fillojë përmirësimin e të tjerëve, duke praktikuar Fjalën e Allahut:

“Nga ju të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillë janë ata të shpëtuarit.” (Ali Imran: 104)

Muhamedi alejhi selam thotë: “Kush prej juve shih ndonjë të keqe, le ta ndryshojë atë me dorë, nëse nuk mundet le ta ndryshojë me gjuhë, nëse nuk mundet le ta ndryshojë me zemër, por ky është Imani më i dobët.” (Transmeton Muslimi.)

3) Cila është rruga më e lavdishme në këtë jetë?

- Rruga më e lavdishme në këtë jetë është ecja në rrugë të drejtë, rrugë të cilën Allahu e ka bërë obligim ta pasojmë. Kjo është rruga në të cilën ka ecur Muhamedi alejhi selam dhe shokët e Tij. Nuk duhet ta miqësojmë atë që e armiqëson këtë fe. Duhet të miqësojmë dhe armiqë-

sojmë vetëm për hir të Allahut. Duhet të veprojmë me sinqeritet dhe bindje për të pastruar këtë fe nga njollat e bidateve dhe rrugëve që janë krijuar për qëllime politike. Allahu thotë:

“(Kjo fe është) Ngjyrosje e Allahut, e kush ngjyros më mirë se Allahu. Ne vetëm Atë e adhurojmë.” (Bekare: 138)

Ajo që ndodhë me një pjesë muslimanësh të cilët veprojnë me ide dhe mentalitete perendimore nuk përkon me thirrjen Islame, që e kanë për detyrë ta mbartin muslimanët. Duke pasur ide dhe veprime që nuk burojnë prej Islamit muslimanët ranë nga pozita e tyre drejtuese në botë në pozitën e të shtypurit.



Detyra jonë ndaj Allahut

Detyra jonë ndaj Allahut:

a) Të besojmë Allahun dhe ta veçojmë Atë në adhurim, në Emrat, në Cilësitë e Tij dhe në legjislacion.

b) Të veprojme me Fjalën e Tij, Kur'anin fisnik. Të bëjmë hallall (të lejojmë) atë që ai e ka bërë hallall (ka lejuar) dhe të ndalojmë atë që Ai e ka ndaluar.

c) Të gjykojmë me Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut alejhi selam, sepse në të gjitha ligjet e tjera nuk ka dobi.

d) Të duam teuhidin dhe vepruesit e tij dhe të urrejmë shirkun dhe praktikuesit e tij.

e) Të respektojmë të parët e muslimanëve në hallall.

f) Të duam Allahun dhe Pejgamberin alejhi selam më tepër se veten, familjen, pasurinë dhe mbarë njerëzimin.

g) Të besojmë se Muhamedi alejhi selam është dërguar nga Allahu, të besojmë në atë që ai njofton, ta respektojmë atë që ai urdhëron, t'i shmangemi asaj nga e cila ai na ndalon dhe ta adhurojmë Allahun me Sheriatin e Tij.

h) Të kemi kujdes të veprojme me hadithe të vërteta nga Muhamedi alejhi selam dhe të largohemi nga hadithet e dobëta dhe të trilluara.

j) Ta mbrojmë fenë dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut me pasuri, me gjymtyrë dhe gjuhë, duke ditur se hadithet e tij komentojnë Kur'anin e madhëruar, e për këtë shkak nuk mund t'i lëmë pas shpine. Allahu thotë: **“Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë.”** (Nehl: 44)

k) Të vishemi me moralin e të Dërguarit të Allahut alejhi selam dhe të fillojmë në thirrje nga ka filuar ai, nga teuhidi.

O Zot, na udhëzo me dashurinë dhe pasimin e të Dërguarit Tënd dhe na ringjall në Ditën e Kijametit me palën e tij.



Dallimi mes shiitëve dhe sunive

- Shiitët kundërshtojnë muslimanët në çështje të rëndësishme:

a) Në Kur'an: Besojnë se ky Kur'an që kemi në duart tona është i mangët duke besuar se disa ajete janë devijuar.

b) Në hadithet e të Dërguarit të Allahut alejhi selam: Nuk i pranojnë hadithet që gjenden në Sahihun e Buharit dhe Sahihun e Muslimit.

c) Në Teuhid: Ata u lutën të tjerëve veç Allahut, premtojnë dhe therrin kurban për hir të të tjerëve veç Allahut, besojnë se eulijatë e tyre kanë fuqi të jashtëzakonshme, me të cilën kontrollojnë gjithësinë. (Sufizmi këto besime i ka marrë prej shiizmit.)

d) Në gajb (në të fshehtën): Besojnë se imamët e tyre janë të pagabueshëm dhe e dinë të fshehtën. Besojnë se imami i tyre do të dalë nga një bodrum dhe do t'i therrë të gjithë armiqtë e tij politik e do t'ua kthejë shiitëve të drejtat e tyre.

e) Në Sheriat: Ata thonë se Sheriati është ajo me të cilën ka ardhur Muhamedi alejhi selam e me këtë merret populli i thjeshtë, ndërsa hakikati (realiteti) është dituri e posaçme e marrë drejtëpërsëdrejti nga Allahu e këtë nuk e di askush veç imamëve të tyre nga pasardhësit e familjes së Muhamedit alejhi selam. Ata besojnë se nuk mund të lidhemi me Allahun veçse nëpërmjet ndërmjetësimit të imamëve të tyre. (Këto besime ekzistojnë edhe te sufitet.)

f) Në fyerjen e shokëve të të Dërguarit të Allahut alejhi selam: Ata mallkojnë Ebu Bekrin, Umerin dhe të tjerët

(Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë sahabët), ndërsa i Dërguari i Allahut alejhi selam këta i ka përgëzuar me Xhenet.

g) Në shpifje: Shpifin për Aishen (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe thonë se ajo ka bërë imoralitet, kurse Allahu në Kur'an e ka pastruar atë nga kjo shpifje.

h) Në ibadet: Nuk përkojnë me muslimanët në ezan, formën e namazit dhe kohën e tij.

i) Në tukija: Shiitët fshehin akiden e tyre në raste të vështira që njerëzit mos t'i kuptojnë duke u shtirur dhe shpifur si munafikët (dyfytirëshit).



Shtojcë

Teuhidi i dijes dhe i bindjes

I. Bazat e besimit në emrat dhe cilësitë e Allahut:

a) Pohimi i gjithçkaje që Allahu ia ka vërtetuar vetvetes dhe i gjithçkaje që resuli (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) ia ka vërtetuar Atij. Pa shëmbëllim e pa përshkrim;

b) Mohimi i gjithçkaje që Allahu ia ka mohuar Vetvetes dhe i gjithçkaje që resuli (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) ia ka mohuar Atij pa ndryshimin e kuptimit real në atë metaforik, dhe pa ua zhvlerësuar kuptimin; Siç thotë Allahu i Madhëruar. **“Asgjë nuk është i ngjashëm me Të dhe ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”** (Shura: 11)

Duke ua besuar domethënien origjinale termave bashkë me kuptimin e tyre.

* Ky ajet është i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, e mohon ngjashmërinë dhe i pohon cilësitë.

Allahu i Madhëruar ka shumë emra dhe cilësi, disa janë të njohura për ne e disa jo . E kemi detyrë t'i besojmë këto emra dhe cilësi të argumentuara me argumente të sakta, pa shtuar e as pakësuar nga llogjika jonë.

Pohimi i emrave dhe i cilësive Allahut, të bëhet me dy kushte:

a) Pa **temthiil** (*shëmbëllim*), pra pa thënë se cilësitë e Allahut janë si ato të krijesave, p.sh. pa thënë se shikimi i Allahut është si shikimi ynë etj.

b) Pa **tekjiif** (*përshkrim*) pa thënë, është kështu apo ashtu, në këtë mënyrë apo atë mënyrë, duke e futur llogjikën tonë. Allahun nuk e ka parë askush nga njerëzit dhe

xhindët, prandaj çdo përshkrim i Tij është i kotë. Allahu na thotë: **“Atë nuk e përfshijnë shikimet, ai i përfshin ato.”** (El-En’am: 103)

Mohimi i emrave dhe i cilësive Allahut, të bëhet me dy kushte:

a) Pa **tahriif** (*devijimin e kuptimit real*), p.sh. pa thënë se, dora e Allahut nënkupton fuqi.

b) Pa **ta’ëtiil** (*të besosh termin, por t’i mohosh, zhvlerëso domethënien*), p.sh. pa thënë Shikues pa shikim, Dëgjues pa dëgjim.

II. Shëmbëllimi dhe zhvlerësimi i domethënies së emrave të Allahut dhe cilësive të Tij, është kufër, ndërsa devijimi nga kuptimi real, të cilin bidatçinjtë e quajnë **teuili (*shpjegim*), mund të jetë:**

a) kufër, si shpjegimi i (*batinijëve të cilët thonë se e dukshmjia ka dhe të padukshmen, e këtë të fundit e shpjegojnë si të duan*).

b) bidat, humbje si shpjegimi i mu’tezilëve (*të cilët thonë se me fjalën dorë nënkuptohet fuqia*).

c) gabim, (*si shpjegimi i disa muslimanëve që i bëjnë hadithit për kohën, duke e marrë atë si emër të Allahut kur dihet se qëllimi është, se Allahu është Ai që e kontrollon kohën*).

III. Besimi: në Uihdetil Uxhud (se: çdo gjë është Zot, Allah); në **Hulul**, se Allahu i Madhëruar është i shkrirë në ndonjë prej krijesave të Tij, apo se Ai është njësh me to (*krijesat*), të gjitha këto besime janë kufër që të nxjerrin nga feja.

* Ky është besimi panteist të cilët thonë se Allahu, qënien e Tij e ka shpërndarë nëpër krijesat e Tij, duke thënë se në çdo send është një pjesë e Allahut i Madhëruar, ose, se një send i caktuar është vetë Allahu.

IV. Besimi në melaiket e nderuar përgjithësisht, ndërsa detajet i besojmë vetëm në rastet kur ka argument të saktë, si për emrat, cilësitë, punët e tyre, në varësi të dijes që ka çdokush.

* Themi përgjithësisht si, p.sh që melaiket janë krijesa prej drite, e madhërojnë Allahun mëngjes e mbrëmje dhe kurrë nuk e kundërshtojnë Atë. Cdo melek ka punën e tij, që Allahu ia ka caktuar.

Ndësa për sa i përket detajeve, besojmë se një melek që quhet Xhebrail, ka gjashtëqind palë krahë dhe se është i ngarkuar me përcjelljen e shpalljeve. I besojmë këto që thamë se kemi argumente të sakta. Po kështu mund të themi dhe për ndonjë melek tjetër duke u bazuar në argumente të sakta.

V. Besimi tek të gjithë librat e zbritur dhe se me të vërtetë Kur’ani i nderuar është më i miri dhe shfuqizuesi i tyre. Të gjithë ç’ka ishin para Kur’anit, u ndryshuan; për këtë arsye është detyrë të ndjekim vetëm Kur’anin e jo ata që kanë kaluar.

* Ne besojmë se Allahu i Madhëruar u ka zbritur disa të Dërguarve të mëparshëm libra si, Zeburin, Teuratin dhe Inxhilin, po kështu dhe fletushka disa të tjerëve. Allahu i Madhëruar i pati urdhëruar dijetarët dhe adhuruesit e mëparshëm, që t’i ruajnë këto libra, por ata e ndryshuan fjalën e Allahut. Ndërsa Kur’anin, Allahu i Madhëruar e mori vetë përsipër ruajtjen e tij, siç thotë në suren Hixhër, 9: **“ Ne me madhërinë tonë e zbritëm Kur’anin dhe Ne gjithësesi jemi mbrojtës të tij.”**

Qëndrimi ynë ndaj lajmeve nga librat e mëparshëm është:

1. Nëse është i njëjtë me Kur'anin e pranojmë, sepse e ka dhe Kur'ani.
2. Nëse e kundërshton Kur'anin e refuzojmë.
3. Nëse nuk përmendet në Kur'an, por përmendet në to, as nuk e pranojmë, as nuk e refozojmë.

VI. Besimi tek nebijët e Allahut dhe resulët e Tij alejhimu selam, se ata me të vërtetë janë më të mirët e njerëzve, e kush pretendon se ka diçka tjetër me këtë, bën kufër.

Nëse ndonjëri prej tyre, përcaktohet me argument të saktë është detyrë ta besojmë në veçanti.

Gjithashtu, e kemi për detyrë t'i besojmë të tjerët, në përgjithësi. Është detyrë besimi se Muhamedi alejhi selam, është më i miri dhe i fundit i tyre dhe se Allahu e dërgoi atë për të gjithë njerëzit.

* Resuli vjen me shariat të ri, ndërsa nebiji e vërteton shariatën e mëparshëm dhe zbaton shariatën e resultat (të dërguarit) të mëparshëm. **Embija** (ferrefyes) janë afro 124, 000, ndërsa resula janë afërsisht 313. Cdo resul është dhe nebij por jo çdo nebij është resul.

Muhamedi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) është i dërguar për çdo kohë dhe për gjithë botën: **“Është i Madhëruar Ai, që ia shpalli Furkanin (kriter për të dalluar të vërtetën nga e kota) robit të Tij, për të qenë Nedhira (këshillues) për të gjithë botën.”** (Furkan: 11)

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar, që t'u thonë: “Adburoni vetëm Allahun, e largojuni tagutëve...” (En-Nahl: 36)

“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte resul (i dërguari) i Allahut dhe vula e gjithë nebijëve (ferrefyesve), e Allahu është i dijsbëm për çdo send.” (El-Ahzabë: 40)

VII. Besimi në ndërprerjen e shpalljes pas vdekjes se Muhamedit (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*), dhe se ai është vula e nebijëve dhe e resulëve. Kush beson diçka që është në kundërshtim me këtë, bën kufër.

* Kjo pikë i kundërshton të gjithë ata profetë të rremë, apo ata sufistë, që pretendojnë se dijetarëve të tyre u vjen shpallje. I dërguari (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) na ka lajmëruar se deri në ditën e gjykimit do të dalin shumë mashtrues nën pretendimin se janë profetë, gjithashtu ka dhe të atillë që thonë se këtij apo atij personi i vjen shpallje nga Allahu. Të gjitha këto nuk janë të vërteta sepse Allahu na thotë : “... . **Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin fe (të pranuar). ...**” (Maide: 3)

VIII. Besimi në ditën e fundit dhe në të gjithë ato lajmërimet të sakta, që na tregojnë për të, si dhe besimi në ato shenja dhe dukuri që i paraprijnë asaj dite.

* Besimi në ditën e fundit është njëri nga kushtet e Imanit prandaj themi se një person nuk quhet besimtar deri sa ta besojë këtë ditë. Mirëpo dhe besimi në këtë ditë, për ata persona që i kanë mundësitë të informohen me detajet e kësaj dite, nuk konsiderohet i plotë deri sa t'i besojë këto detaje. Për muslimanin çështja është e thjeshtë, mjafton që ai të bindet se Allahu dhe i Dërguari ka thënë diçka rreth kësaj dhe ai e beson. Të tilla janë detajet si: ardhja e melekut të vdekjes, ç'dodh në varr, pyetjet e Munkerit dhe Nekirit, shpërblimi dhe dënimi në të (*varr*), ringjallja pas vdekjes, mahsheri, llogaria, prezantimi i librave, peshorja, sirati, haudi i resultit s.a, kantari, xhenneti dhe zjarri. Gjithashtu e kemi për detyrë t'u besojmë disa shenjave të cilat do t'i paraprijnë kësaj dite. Ato ndahen në të vogla dhe të mëdha konkretisht:

Të voglat e realizuara: Dërgimi i Muhamedit (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) si profet, vdekja e tij, çlirimi i Persisë, imoraliteti sheshit, shtimi i injorancës, bashkimi kundër muslimanëve ashtu siç bashkohen egërsirat rreth ushqimit etj.

Të voglat e realizuara: Emërtimi i alkoolit jo me emrat e tij si dhe një pjesë e mirë e llojit të lartëpërmendur.

Të voglat e paralizuara: Të foluri e egërsirave, ardhja e Mehdiut etj.

Të mëdhatë: Dalja e Dexhalit, zbritja e Isës alejhi selam, dalja e Je'xhuxh Ma'xhuxhëve, dalja e kafshës, lindja e diellit nga perëndimi, etj.

IX. Kaderi: Besimi në kader: E mira dhe e keqja është nga Allahu i Madhëruar e kjo nënkupton:

a) Besimi se me të vërtetë Allahu i Madhëruar e ka ditur se ç'farë do të jetë, para se të jetë dhe këtë e ka shkruar në Leuhi Mahfudh;

b) Besimi se me të vërtetë ajo që dëshiroi Allahu i Madhëruar u realizua, e ajo që nuk dëshiroi Ai, nuk u realizua;

c) Nuk ekziston asgjë përveç asaj që Allahu dëshiron.

d) Allahu i Madhëruar është i plotëfuqishëm për ç'do gjë;

e) Ai është Krijuesi i ç'do gjëje dhe është Bërës i asaj që do.

* Allahu i Madhëruar kur e krijoi lapsin e urdhëroi të shkruajë çdo gjë që do të ndodhë. Nga madhështia e Allahut dhe plotësimi i sundimit të Tij, është që të mos jetë (ndodhë, ekzistojë) në pronën e Tij, asgjë që Ai të mos e dëshirojë. Ka disa gjëra që ne na duken të këqija, por ato mund të jenë të mira me urtësinë e Allahut i Madhëruar e ne nuk e dimë.

X. Besimi në gjërat e padukshme (*gajb*) të vërtetuara me argumente të sakta, siç është: arshi, kursija, xheneti, zjarri, varri, begatia (*për besimtarët*) në varr dhe dënimi në të (*për pabesimtarët*), peshorja, sirati, etj, pa ua devijuar kuptimin real askujt prej tyre.

XI. Besimi në **Shefatin** (*ndërmjetësimin*) e nebijit (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*), dhe në shefatin e nebijëve, të melaikëve, të salihinëve (*vepërmirëve*), e të tjerëve veç tyre në ditën e gjykimit, siç ka ardhur shpjegimi i çdonjëres prej tyre në argumente të sakta.

* Që të realizohet shefati duhen plotësuar dy kushte :

- 1- Leja e Allahut për personin që ndërmjetëson
2. Allahu të jetë i kënaqur me të ndërmjetësuarin.

Llojet e Shefatit:

I. Resuli (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) ka shefat të veçantë :

a) **Mekamu Mahmud** (*vend i nderuar*), që do të thotë se i dërguari (*paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*) do të ndërmjetësojë për fillimin e llogarisë pasi të kenë hequr dorë të gjithë të Dërguarit e tjerë.

b) Ndërmjetësimi për të futur njerzit në xhenet.

c) Ndërmjetësimi për Ebu Talibin për zvoglimin e dënimit.

II. Shefati i përgjithshëm, ku ndërmjetësojnë nebijët, melaiket, shehidët, salihinët; a)- shefati për të dalë nga zjarri ata që nuk kanë qenë mushrikë. b)- shefati për atë që e meriton zjarrin nga njësuesit për të mos u futur në të. c)- për ngritjen e shkallëve në xhenet muslimanëve, p.sh. anëtarët e familjes i marrin ata që janë më poshtë,

në shkallë tek ata më lart. “E ata që vetë besuan, e edhe pasardhësit e tyre ishin në besim, Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve). Secili njeri është peng i asaj që ka punuar.” (Tur: 21)

XII. Besimtarët do ta shohin Zotin e tyre ditën e gjykimit, në xhenet dhe në Mahsher, me shikim të vërtetë. Kush e mohon këtë gjë apo ia devijon kuptimin, ai është **zaig**. (*i devijuar, i humbur*). Ky shikim nuk i ndodh askujt në dunja.

* Argumentet që e vërtetojnë se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre janë të shumtë:

1- “**Atë ditë, do të ketë fytyra të ndriçuara, që Zotin e tyre shikojnë.**” (EL Kijame: 22-23)

2- “*Ju do ta shikoni Zotin tuaj në xhenet, ashtu siç shikoni bënë kur është e plotë, a ngushtoheni ju për të parë bënë e plotë? -thanë- jo, tha i Dërguari (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të)- ashtu do ta shihni dhe Zotin tuaj*”

Besimtarët do ta shohin në Mahsher dy herë, një herë në pamjen jo origjinale e një herë në atë origjinale, ndërsa munafikët vetëm një herë, e kjo në pamjen jo origjinale siç tregohet në hadithin e gjatë që flet për ditën e gjykimit.

XIII. Keramatet e eulijave (*miqve të Allahut*) dhe të veprimirëve janë të vërteta por jo ç’do gjë jashtë normales (*të zakonshmes*) është kerame (*nderim*). Ajo mund të jetë **is-tidraaxh** (*mashttrim, sprovë*), mund të jetë ndikim nga shejtanët ose të humburit. Dallimi mes tyre është përputhja ose jo me Kur’anin dhe Sunnetin .

* Keramatet janë ndodhi jonormale që i bën Allahu në duar ose në prezence të njerzëve të mirë. Kemi tri lloje gjërash jashtë normales:

a) Mu’xhize: I vijnë resulëve dhe nebijëve.

b) Keramet i vijnë: 1. njerëzve të mirë me besim të fortë kur ai ka nevojë për të; 2. nëse e ka besimin e dobët, që të forcohet; 3. fakt (*argument*) për të tjerët; 4. si provë munafikëve dhe mosbesimtarëve.

c) Sihri (*magjia*) i vjen magjistarëve dhe fallxhorëve. Nuk është e thënë që çdo besimtar i t'i vijnë kerame, por siç thamë, mund t'i vijnë edhe dikujt që nuk është ve-përmirë. Keramet besohen nëse përputhen me kur'anin dhe sunnetin.


XIV. Të gjithë besimtarët janë eulija (*miqtë*) e Rrahmanit. Ç'do besimtar ka miqësi (*afërsi*) me Allahun në raport të drejtë me besimin (*devotshmërinë*) e tij.

*** “Allahu është Ueliju (Mbrojtësi, Ruajtësi) i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë, ndërsa për ata që nuk besojnë Eulija (mbështetës, ndihmues) të tyre janë djajtë që i nxjerrin ata nga drita e i hedhin në errësirë. Ata janë banues të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”** (Bekare: 257)





Rruga e mushimanit



Parathënie

Në këtë libër janë shtruar probleme që lidhen me parimet e përgjithshme të fesë Islame, duke u përqëndruar në ato që e ndihmojnë muslimanin në kryerjen e faljes me lehtësi.

Në të lexuesi do të gjejë gjithashtu disa kapituj të Kur'anit të madhërueshëm, të shkruara me alfabetin shqip, me qëllim që të lehtësohet shqiptimi i tyre për fillestarët.

Gjithashtu në të gjeni dhe gjerat e gjuhës arabe për t'u ardhur në ndihmë të gjithë atyre që kanë dëshirë t'i mësojnë suret nga gjuha origjinale sepse kjo mundëson dhe një shqiptim të drejtë të tyre.

I lutemi Allahut që ta bëjë këtë libër të dobishëm për atë që e lexon si dhe i lutemi Atij të mëshirojë e të falë të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen dhe botimin e tij.

“Ai është Dëgjuesi dhe Plotësuesi i lutjeve tona”.

Parimet e përgjithshme të fesë Islame

Shtyllat e Islamit janë pesë

I Dërguari Allahut, Muhamedi alejhi selam (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), ka thënë: “Feja islame ndërtohet mbi pesë shtylla:

1. Dëshmia (të besuarit me zemër dhe dëshmia me gojë) se s’ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi, alejhi selam, është i Dërguari i Allahut. (Vërtet, askush dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut, kurse Muhamedit alejhi selam, duhet t’i bindemi në atë që iu shpall prej Zotit).

2. Kryerja me kujdes e të falurit; (kryerja me përlulësi e namazit sipas kushteve, shtyllave dhe detyrave që kërkojnë gjatë faljeve të cilat kryhen pesë herë në një ditë-natë).

3. Dhënia e zekatit; (ndihmës financiare) që është detyrë për çdo musliman që zotëron mbi 85 gram flori, ose sa vlera e tij në monedha të tjera. Ai duhet të paguajë 2.5 % të vlerës së asaj pasurie që ka, pasi të kalojë një vit nga zotërimi i saj dhe përveç parave, për çdo lloj tjetër pasurie duhet të japë një sasi të caktuar.

4. Të vizituarit e Qabes; (në Mekë), për atë që ka mundësi ta kryejë atë vizitë.

5. Agjërimi i Ramazanit; (të ndalosh ngrënien, pirjen, marrëdhëniet intime dhe të gjitha veprimet që prishin agjërimin, nga agimi deri në përfundim të diellit, duke e kryer këtë me vendosmëri në zemër.)

Shtyllat e Imanit (besimit) janë gjashtë.

1. Besimi në Allahun, në ekzistencën e Tij, në cilësitë, i vetmi që meriton adhurimin dhe bindja që Allahu është Një.

2. Besimi në Ëngjëjt e Allahut, që janë krijesa prej drite dhe që janë krijuar vetëm për të zbatuar urdhërat e Tij.

3. Besimi në Librat e shpallur prej Allahut (Teurati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani që është libri i fundit).

4. Besimi në të Dërguarit e Tij. I pari prej tyre është Nuhu dhe i fundit është Muhamedi, alejhi selam, i cili është vulë (i fundit) i gjithë të Dërguarve nga Allahu.

5. Besimi në Ditën e Fundit, Ditën e Ringjalljes, dhënies së llogarisë për punët e njerëzve, ditën e shpërblimit ose ndëshkimit në Botën Tjetër.

6. Besimi në paracaktimin, kaderin e Allahut dhe të jesh i kënaqur me atë përcaktim, sepse e mira dhe e keqja, e ëmbla dhe e hidhura janë në paracaktimin e Allahut të Madhëruar.

Pjesë përbërëse e fesë është dhe Ihsani (bamireshia). Baza e vetme e saj është *të adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, sepse edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.*

Fjala e singëritetit: La ilahe il Allah Muhamedu rresulullah.

Shpesh dëgjojmë njerëz të shqiptojnë një fjalë që sapo e dëgjon e kupton se shqiptuesi është duke thënë një fjalë që të imponon respekt. Është një fjalë që del nga thellësia e zemrës dhe të ngjall ndjenjën e përkushtimit për atë që po thuhet. Me të drejtë Allahu i Madhëruar e ka quajtur “Fjalë të mirë” dhe e krahason me pemën që i ka rrënjët

thellë në tokë, si për të na treguar se edhe kjo fjalë nuk është thjesht shqiptim i disa tingujve në gjuhën arabe, por një fjalë që përmban në vetvete kuptime të thella. Kjo fjalë është shkaku i ekzistencës së gjithçkaje në gjithësi. Pa dashur ta shtojmë kureshtjen se cila na qenka kjo fjalë, do ta paraqesim në rreshtat e mëposhtëm dhe do të tregojmë kuptimin e vërtetë të saj.

La ilabe il Allah (S'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut)

Kjo frazë mohon ekzistencën e ndonjë të adhuruari tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe vërteton se i adhuruar (Zot) me të drejtë është vetëm Allahu dhe se adhurimi i kujt do tjetër me përjashtim të Allahut është adhurim i pavlevshëm dhe nuk pranohet.

1- Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Atëberë, dije se nuk ka Zot (të adhuruar me të drejtë) tjetër përveç Allahut.”*** (Muhamed: 19)

2- Profeti, alejhi selam, ka thënë: *“Kush thotë singërisht: La ilabe il Allah, hyn në Xhenet.”* Hadith sahih në librin “El-Xhamiu”.

I singërtë (në thënien e kësaj fjale) është ai që e kup-ton dhe vepron sipas saj, duke i ftuar njerëzit te kjo frazë para çdo gjëje tjetër, sepse në këtë frazë shprehet teuhidi (besimi në Zotin Një), e për këtë dhe i krijoi Allahu xhinët dhe njerëzit.

3- I Dërguari i Allahut, pasi u bë Profet, qëndroi në Mekke 13 vjet duke i thirrur idhujtarët në Islam e duke u thënë: *“Thoni: La i labe il Allah.”* Por përgjigja e tyre ishte ashtu siç e tregon Kur’ani: ***“Ata (idhujtarët) habiten, ngase u erdhi Profeti nga mesi i tyre, e mosbesimtarët thanë: “Ky është magjistar gënjeshtar. A mendon ai t’i bëjë zotat Një Zot? Vërtet, kjo është gjë shumë e çuditshme!” Paria nga mesi i tyre shkoi duke i thënë njëri - tjetrit: Vazhdoni të jeni të qëndrueshëm në adburimin e***

zotave tuaj, se kjo është një gjë e kurdisur. Ne nuk kemi dëgjuar diçka të tillë në popullin (në fenë) e fundit, kjo nuk është tjetër, veçse një trillim!” (Sad: 4-7)

Arabët e kuptuan kuptimin e kësaj fraze dhe e dinin se ai që e thotë këtë nuk lut askënd përveç Allahut, ndaj dhe nuk i besuan, e për ta Allahu i Madhëruar thotë: **“Për arsye se kur u thubej atyre: Nuk ka Zot tjetër përveç Allabut, ata e mbanin veten lart. Dhe thoshin: “A do t'i braktisim ne zotat tanë për një poet të çmendur?” Jo, (nuk është siç thonë ata) por ai u solli të vërtetën dhe vërtetoi të Dërguarit e parë.”** (Es-Safatë: 35 - 37)

Është për t'u habitur se disa muslimanë e thonë me gjuhët e tyre frazën **“La ilabe il Allah”**, por e kundërshtojnë kuptimin e saj me veprat dhe lutjet e tyre që nuk ia bëjnë Allahut.

4- Ibn Rexhebi ka thënë: **“El-ilab”** është Ai të Cilit i kushtohet bindja dhe nuk kundërshtohet për arsye të autoritetit dhe madhërisë që ka, gjithashtu nga dashuria, frika e shpresa ndaj Tij, duke u mbështetur tek Ai, duke iu lutur dhe duke kërkuar ndihmë prej Tij. Mirëpo tërë këto aftësi mirëbërëse e mbrojtëse nuk i ka askush tjetër përveç Allahut. Prandaj, kush shoqëron ndonjë krijesë në ndonjë gjë prej këtyre çështjeve, që janë attribute të Allahut, ka shkelur sinqeritetin e vet në frazën ‘la ilahe ilallah’ (s’ka të adhuruar më të drejtë përveç Allahut), dhe i është robëruar krijesave sipas shkallës së zhytjes së tij në atë robëri.

5- Fjala: **“La ilabe il Allah”** i bën dobi atij që e thotë kur ai ta zbatojë kuptimin e saj në jetën e vet dhe të mos e rrëzojë atë kuptim me idhujtari, si duke lutur të vdekurit, ose duke kërkuar ndihmë prej të gjallëve që nuk janë të pranishëm dhe për gjëra që ata nuk kanë mundësi të t'i plotësojnë.

Profeti, alejhi selam ka thënë: *“Kush thotë: ‘La ilahe il Allah’, gjen shpëtim një ditë prej ditës, edhe pse i takon ç’ti takojë (ndonjë ndëshkim në Zjarr) para se të gjejë shpëtimin.”* Ky hadith është sahih.

Fjala me të cilën njeriu futet në fenë Islame përbëhet nga dy koncepte bazë. Koncepte të cilat duken qartë qysh në pamjen e parë të këtyre tingujve në gjuhën arabe. Fjala “La ilahe” paraqet mohimin e çdo gjëje tjetër që mund t’i shkojë në mendje njeriut se e meriton adhurimin, duke e pastruar zemrën nga çdo adhurim i gabuar. E pasi zemra të jetë bërë e gatshme për të futur në të adhurimin e saktë, ndjenjë kjo (të adhurosh) pa të cilën zemra nuk mund të konceptohet, atëherë vjen pjesa e dytë e kësaj shprehjeje “ilallah”, ku tregohet pohimi se vetëm Allahu e meriton adhurimin. Pa këto dy kushte bazë nuk mund të realizohet edhe qëllimi madhështor i kësaj fjale kaq të thjeshtë në lexim e shqiptim. Nuk është i drejtë arsyetimi që mund të bëjë dikush duke u justifikuar se ai nuk adhuron askënd, përfshirë dhe Allahun, duke e marrë si të vërtetë sepse është e pamundur të mos adhurojë askë, për të na u arsyetuar se ai e ka zemrën e pastër nga adhurimi i idhujve, e automatikisht është në rregull, sepse ky nuk e ka zemrën vetëm të pastër nga adhurimi i kotë, por e ka edhe bosh nga adhurimi i Allahut, e automatikisht ky person nuk ia ka dhënë hakun kësaj fjale.

Pasi u njohëm me këtë fjalë, me të drejtë themi se ajo është çelës për në Xhenet, për në vendin e përgatitur për ata që e njohin dhe i binden Zotit të tyre. Nuk duhet të harrojmë se çdo çelës ka disa dhëmbëza për të hapur derën e përcaktuar për të, e dhëmbëzat e këtij çelësi që e hap derën e Xhenetit shkurtimisht mund të përmbledhen në:

1. Dituria mbi kuptimin e kësaj fjale, siç u tregua më sipër.
2. Bindja e plotë për një pohim të tillë pa lënë vend për dyshim në zemrën tënde se Allahu ekziston dhe është

i Vetmi që i meriton të gjitha llojet e adhurimit.

3. Pranimi i asaj që kërkon kjo fjalë.

4. Nënshtrimi ndaj domethënies së kësaj fjale.

5. Vërtetësia në pranimin e saj.

6. Besimi me sinqeritet duke shmangur çdo lloj dyfytërsie nga zemra jote.

7. Të duhet kjo fjalë me kuptimin e saj si dhe të duhen të gjithë ata që e duan këtë frazë që, siç e përmendëm, është çelësi i derës së Xhenetit nëse u përmbahemi këtyre kushteve koncize.

Ibadeti (adhurimi)

Ky term i përmbledh të gjitha veprimet dhe fjalët që Allahu i Do dhe është i kënaqur prej tyre, qofshin këto të dukshme apo të fshehta.

Adhurimet janë të shumta. Namazi, agjërimi, zekati, lutja e drejtuar Allahut, frika dhe përrulja ndaj Tij, betimi me emrin e Allahut, mbështetja tek Ai, kërkimi ndihmë dhe mbrojtje prej Tij etj. të gjitha këto janë adhurime. Është detyrë e muslimanit që këto adhurime t'ia dedikojë vetëm Atij që me të drejtë i meriton e Ai është Allahu i Lavdishëm, Ai është Krijuesi, Furnizuesi, Ai që na pajisi me shumë të mira.

Në Kur'anin e Madhërishëm Allahu thotë:

“O ju njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush ashtu që të jeni të devotshëm (të shpëtuar). Ai, i Cili ua bëri tokën shtrat (venbanim) e qiellin kullm, e prej qiellit lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani Allahut shok, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka ortak).”

(El-Bekare: 21-22)

Mësimi i parë

Tabela përmbledhëse e shkronjave të gjuhës arabe

Shembull	Fund	Mes	Fillim	Vetëm	Emërtimi		Nr
أَب	ا	ا	أ	أ	Elifun	أَلِفٌ	۱
بَيْتٌ	ب	ب	ب	ب	Bā:un	بَاءٌ	۲
تُفَاحٌ	ت	ت	ت	ت	Tā:un	تَاءٌ	۳
ثَعْلَبٌ	ث	ث	ث	ث	Thā:un	ثَاءٌ	۴
جَوْزٌ	ج	ج	ج	ج	Xhijmun	جِيمٌ	۵
حَدِيقَةٌ	ح	ح	ح	ح	H'a:un	حَاءٌ	۶
خَالٌ	خ	خ	خ	خ	Kh'a:un	خَاءٌ	۷
دَجَاجٌ	د	د	د	د	Dā:lun	دَالٌ	۸
ذَهَبٌ	ذ	ذ	ذ	ذ	Dhā:lun	ذَالٌ	۹
رَسُولٌ	ر	ر	ر	ر	Ra:un	رَاءٌ	۱۰
زَهْرَةٌ	ز	ز	ز	ز	Zā:jun	زَايٌ	۱۱
سَوِيرٌ	س	س	س	س	Sijnun	سِينٌ	۱۲
شَمْسٌ	ش	ش	ش	ش	Shijnun	شِينٌ	۱۳
صَدِيقٌ	ص	ص	ص	ص	S'a:dun	صَادٌ	۱۴
ضَيْفٌ	ض	ض	ض	ض	D'a:dun	ضَادٌ	۱۵

طَائِبٌ	ط	ط	ط	ط	T'a:un	١٦	طَاءٌ
ظَهَرَ	ظ	ظ	ظ	ظ	Dh'a:un	١٧	ظَاءٌ
عَيْنٌ	ع	ع	ع	ع	A'jnun	١٨	عَيْنٌ
غَرَفَةٌ	غ	غ	غ	غ	G'ajnun	١٩	غَيْنٌ
فُسْتَانٌ	ف	ف	ف	ف	Fā:un	٢٠	فَاءٌ
قُرْآنٌ	ق	ق	ق	ق	K'a:fun	٢١	قَافٌ
كِتَابٌ	ك	ك	ك	ك	Kā:fun	٢٢	كَافٌ
لَبِنٌ	ل	ل	ل	ل	Lā:mun	٢٣	لَامٌ
مِمْزٌ	م	م	م	م	Mijmun	٢٤	مِيمٌ
نُورٌ	ن	ن	ن	ن	Nu:nun	٢٥	نُونٌ
هَرَمٌ	ه	ه	ه	ه	Hā:un	٢٦	هَاءٌ
وَلَدٌ	و	و	و	و	Ua:un	٢٧	وَاوٌ
يَاسَمِينٌ	ي	ي	ي	ي	Jā:un	٢٨	يَاءٌ

Mësimi i dytë

الدَّرْسُ الثَّانِي

الْحَرَكَاتُ الْقَصِيرَةُ

Zanoret e shkurtëra

Në gjuhën arabe zanoret e shkurtëra paraqiten me anë të simboleve. Këto zanore i japin shkronjës një tingull të shkurtër një kohor. Këto simbole janë:

1- El-Fet'ha – simbolizon zanoren (e) për shkronjat e lehta dhe zanoren (a) për shkronjat e rënda. Ajo paraqitet me një vizë afërsisht paralele (—) p.sh: fe – ف ; k'a – ق.

2- El-kesra - simbolizon zanoren (i). Ajo mbetet e njëjtë si për shkronjat e lehta ashtu edhe për shkronjat e rënda. Ajo paraqitet me një vizë afërsisht paralele e cila shkruhet nën shkronjë (—) p.sh: fi – ف ; k'i – ق.

3 - Ed-dammeh - simbolizon zanoren (u). Ajo është e njëjtë në lexim si për shkronjat e lehta ashtu edhe për shkronjat e rënda. Ajo paraqitet me një presje të vogël e cila shkruhet mbi shkronjë (--) p.sh: fu – ف ; k'u – ق.

El- fet'h'ah

--- --

١ - الفَتْحَةُ

أ - ب - ت - ث - ج - ح - خ - د - ذ - ر - ز -
 س - ش - ص - ض - ط - ظ - ع - غ - ف - ق -
 ك - ل - م - ن - ه - و - ي .

El - kesreh

--- --

٢ - الكَسْرَةُ

إ - ب - ت - ث - ج - ح - خ - د - ذ - ر - ز - س -
 ش - ص - ض - ط - ظ - ع - غ - ف - ق - ك -
 ل - م - ن - ه - و - ي .

ء

Ed-dameh

--- --

٣ - الضَّمَّةُ

أ - ب - ت - ث - ج - ح - خ - د - ذ - ر - ز - س - ش - ص - ض -
 ط - ظ - ع - غ - ف - ق - ك - ل - م - ن - ه - و - ي

4- Es-sukunu

— — —

السُّكُونُ

Pavokalizimi i bashkëtingëllores

- Në gjuhën arabe për të paraqitur një shkronjë të pavokalizuar përdorim një rreth të vogël të cilin e vendosim mbi shkronjë (- -).
- Në këtë rast shkronja lexohet si një bashkëtingëllore e pazëshme p.sh: ف (f) : ق (k').

Es-sukunu

— — —

٤ - السُّكُونُ

أ - ب - ت - ث - ج - ح - خ - د - ذ - ر - ز - س - ش - ص - ض
ط - ظ - ع - غ - ف - ق - ك - ل - م - ن - ه - و - ي

* Shënim :

Fjala në gjuhën arabe nuk mund të fillojë me një shkronjë të pazëshme. Është specifike e kësaj gjuhe që fjalën ta fillojë gjithmonë me një shkronjë të shoqëruar nga një zanore. Në rastet kur fjala në origjinën e saj fillon me sukun, vokalizohet në mënyrë të detyruar p.sh (الْحَمْدُ لِلَّهِ) edhe pse në këtë rast elifi fillon me sukun, kur ndodhet në fillim të fjalisë, në lexim (por jo në shkrim) ai vokalizohet me fet'ha.

Et-tenuijnu

التَّنْوِينُ

Et-tenuijnu paraqitet me dyfishimin e zanores fundore në fund të fjalës së pashquar. Në fakt ai tregon shoqërimin e fjalës së pashquar nga një nun i pavokalizuar (نْ). Tenuini bën që fjala e pashquar të lexohet në fundin e saj me (en-an), (un) (in).

* Et-tenuijnu ndahet në disa lloje:

TENUINI ME FET'HA -- -- -- : أَوَّلًا: التَّنْوِينُ بِالْفَتْحَةِ

Në qoftë se fjala mbaron me tenuijn me fet'ha -- -- shkronja e fundit shoqërohet me Elif (ا) dhe me shenjën e tenuinit dhe lexohet (en) për shkronjat e lehta, p.sh. بَ + نْ = بَأ sh dhe shqiptohet (Ben) dhe (an) për shkronjat e rënda, p.sh. = قَنْ قَ dhe shqiptohet (K'an).

ءَ -- ثَأ -- بَأ -- تَأ -- ثَأ -- جَأ -- حَأ -- خَأ -- دَأ -- ذَأ -- رَأ -- زَأ -- سَأ -- شَأ
صَأ -- ضَأ -- طَأ -- ظَأ -- عَأ -- غَأ -- فَأ -- قَأ -- كَأ -- لَأ -- مَأ -- نَأ -- هَأ
وَأ -- يَأ.

ثَانِيًا : التَّنْوِينُ بِالْكَسْرَةِ : --- TENUINI ME KESRA

Në qoftë se fjala mbaron me tenuijn me kesra, tenuijni shkruhet --- p.sh. (ب) ب = ن + ب = بُن dhe shqiptohet (Bin). Në këtë lloj tenuini nuk ka dallim ndërmjet shkronjave të lehta dhe shkronjave të rënda p.sh (ق) ق = ن + ق = قُن dhe shqiptohet (K'in).

ثَالِثًا : التَّنْوِينُ بِالضَّمَّةِ : --- TENUINI ME DAMMEH

Në qoftë se shkronja ka tenuijn me dammeh, tenuijni shkruhet me --- p.sh. (ب) ب = ن + ب = بُن dhe shqiptohet (Bun). Edhe ky lloj tenuini nuk ka dallim ndërmjet shkronjave të lehta dhe shkronjave të rënda p.sh. (ق) ق = ن + ق = قُن dhe shqiptohet (K'un) .

الشَّدَّةُ

Esh-shed-deh (Përforcimi, dyfishimi)

Esh-shed-deh do të thotë: Prezenca e së njëjtës shkronjë (në mënyrë të njëpasnjëshme) në të njëjtën fjalë, ku shkronja e parë është e pavokalizuar, ndërsa e dyta e vokalizuar. Meqenëse sipas rregllave gramatikore të gjuhës arabe, nuk mund të shkruhen dy shkronja të njëjta (në mënyrë të njëpasnjëshme) në të njëjtën fjalë, këto dy shkronja bashkohen në një shkronjë të vetme mbi të cilën vendoset Esh-shed-deh që paraqitet me anë të shenjës (— —),

shenjë kjo që vendoset mbi shkronjë dhe shoqërohet me zanoren e shkronjës së dytë. Në lexim këto dy shkronja theksohen të dyja në formën e një shkronje të përfocuar duke u shqiptuar; e para e pavokalizuar ndërsa e dyta e vokalizuar.

Esh-shed-detu me fet'ha. **أَوَّلًا : الشَّدَّةُ بِالْفَتْحَةِ :**

أَبْ - حَتْ - حَجَّ - بَحَّ - مَخَّ - مَدَّ - حَذَّ - ضَرَّ
حَزَّ - مَسَّ - حَشَّ - مَصَّ - غَضَّ - مَطَّ - حَظَّ - دَعَّ
وَفَّ - حَقَّ - دَكَّ - دَلَّ - ذَمَّ - زَنَّ - مَهَّ - مَوَّ - أَيَّ

Esh-shed-detu me kesra. **ثَانِيًا : الشَّدَّةُ بِالْكَسْرِ :**

أَبْ - حَتْ - حَجَّ - بَحَّ - مَخَّ - مَدَّ - حَذَّ - ضَرَّ
حَزَّ - مَسَّ - حَشَّ - مَصَّ - غَضَّ - مَطَّ - حَظَّ - دَعَّ
وَفَّ - حَقَّ - دَكَّ - دَلَّ - ذَمَّ - زَنَّ - مَهَّ - مَوَّ - أَيَّ

Esh-shed-detu me dammeh. **ثَالِثًا : الشَّدَّةُ بِالضَّمِّ :**

أَبْ - حَتْ - حَجَّ - بَحَّ - مَخَّ - مَدَّ - حَذَّ - ضَرَّ
حَزَّ - مَسَّ - حَشَّ - مَصَّ - غَضَّ - مَطَّ - حَظَّ - دَعَّ
وَفَّ - حَقَّ - دَكَّ - دَلَّ - ذَمَّ - زَنَّ - مَهَّ - مَوَّ - أَيَّ

رَابِعًا: الشَّدَّةُ مَعَ التَّنْوِينِ Esh-shed-detu me tenuijn me fet'ha

أَبًا - حَتًّا - حَجًّا - بَحًّا - مَحًّا - مَدًّا - حَذًّا - ضَرًّا - حَرًّا
 مَسًّا - حَشًّا - مَصًّا - غَضًّا - مَطًّا - حَظًّا - دَعًّا - وَغًّا
 وَفًّا - حَقًّا - دَكًّا - دَلًّا - ذَمًّا - زَنًّا - مَهًّا - مَوًّا - أَيًّا

خَامِسًا : الشَّدَّةُ مَعَ التَّنْوِينِ بِالْكَسْرِ

Esh-shed-detu me tenuijn me kesra.

أَبٌ - حَتٌّ - حَجٌّ - بَحٌّ - مَحٌّ - مَدٌّ - حَذٌّ - ضَرٌّ - حَرٌّ
 مَسٌّ - حَشٌّ - مَصٌّ - غَضٌّ - مَطٌّ - حَظٌّ - دَعٌّ - وَغٌّ
 وَفٌّ - حَقٌّ - دَكٌّ - دَلٌّ - ذَمٌّ - زَنٌّ - مَهٌّ - مَوٌّ - أَيٌّ

Esh-shed-detu me tenuijn me الشَّدَّةُ مَعَ التَّنْوِينِ بِالضَّمِّ dammeh.

أَبٌ - حَتٌّ - حَجٌّ - بَحٌّ - مَحٌّ - مَدٌّ - حَذٌّ - ضَرٌّ - حَرٌّ
 مَسٌّ - حَشٌّ - مَصٌّ - غَضٌّ - مَطٌّ - حَظٌّ - دَعٌّ - وَغٌّ
 وَفٌّ - حَقٌّ - دَكٌّ - دَلٌّ - ذَمٌّ - زَنٌّ - مَهٌّ - مَوٌّ - أَيٌّ

Disa nga suret e fundit të Kur'anit

Mësimi i Kur'anit është gjëja më e rëndësishme për muslimanin. Disa kapituj të tij si: “El-Fatiha”, “En-Nas”, “El-Felek”, “El-Ihlas”, “El-Mesed”, “En-Nasr”, “El-Maun”, “El-Fil”, “El-Humeze”, “El-Asr”, “Et-Tekathur”, “El-Karia”, “El-Adijat”, “Ez-Zelzele”, “El-Bejine”, “El-Kadr”, “El-Alak”, “Et-Tinë”, “El-Inshirah”, “Ed-Duha” dhe ajetin “El-Kursij” mund t'i gjeni në këtë libër.

Këto sure janë të shkruara me gërma shqipe, por duke u nisur nga fakti se gjuha arabe ka disa gërma që shqipja nuk i ka atëherë del si detyrë mësimi i këtyre sureve me ndokënd që e njeh shqiptimin e tyre në gjuhën arabe.

Suretu El-Fatiha

Eudhu bil-lahi mineshejtanirr-rraxhim

1. BISMIL-LAHIRR-RRAHMANIRR-RRAHIM.
2. ELHAMDU LIL-LAHI RAB-BIL ALEMIN.
3. ERR-RRAHMANIRR-RRAHIM.
4. MALIKIJEUMID-DIN.
5. IJAKE NA'BUDU UE IJAKE NESTE'IN.
6. IHADINAS-SIRATAL MUSTEKIM.
7. SIRATAL-LEDHINE EN'AMTE 'ALEJHIM GARIL MAGDUBI 'ALEJHIM UE LAD-DAL-LIN.

1. Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
2. Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave
3. Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
4. Sunduesit të ditës së Gjykimit
5. Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë
6. Udhëzona në rrugën e drejtë,

7. në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur!

Suretu En-Nas

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

- 1. KUL E'UDHU BIRABBIN-NAS.**
- 2. MELIKIN-NAS.**
- 3. ILAHIN-NAS.**
- 4. MIN SHERR-RRIL UES-UASIL HAN-NAS.**
- 5. EL-LEDHI JU-UES-UISU FI SUDURIN-NAS.**
- 6. MINEL-XHINNETI UEN-NAS.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Thuaj: “Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve!
2. Sunduesin e njerëzve,
3. Të adhuruarín e njerëzve,
4. Prej të keqes së cytësit që fshihet.
5. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve,
6. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit”.

Suretu El-Felek

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

- 1. KUL EUDHU BIRABBIL-FELEK.**
- 2. MIN SHERR-RRI MA HALEK.**
- 3. UE MIN SHERRI GASIKIN IDHA UEKAB.**
- 4. UE MIN SHERR-RRIN-NEF-FATHATI FIL 'UKAD.**
- 5. UE MIN SHERR-RRI HASIDIN IDHA HASED.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit,
2. Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi.
3. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.
4. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryejnë nyja.
5. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.

Suretu El-Ihlas**Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim**

- 1. KUL HUALL-LLAHU EHAD.**
- 2. ALL-LLAHUS-SAMED.**
- 3. LEM JELID UE LEM JULED.**
- 4. UE LEM JEKUL-LEHU KUFUEN EHAD.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Thuaj: Ai, All-llahu është Një!
2. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.
3. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.
4. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.

Suretu El-Mesed**Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim**

- 1. TEBBET JEDA EBI LEHEBIN-UE TEBB.**
- 2. MA AGNA 'ANHU MALUHU UE MA KESEB.**
- 3. SE JASLA NAREN DHATE LEHEB.**
- 4. UEMRE-ETUHU HAMMALETTEL-HATAB.**
- 5. FI XHIDI HA HABLUN MIN MESED.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar!
2. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi!
3. Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë.
4. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra),
5. E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.

Suretu En-Nasr

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. IDHA XHAE NASRULL-LLAHI UEL FET-H.

2. UERAJTEN-NASE JED-HULUNE FI DINIL-LAHI EFUAXHA.

3. FE SEBBIH BIHAMDI RABBIKE UESTAGFIRHU, INNEHU KANE TEUABA.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Kur erdhi ndihma e All-llahut dhe çlirimi (ngadhënjimi),

2. Dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë e All-llahut.

3. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është mëshirues i madh.

Suretu El-Kafirun

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. KUL JA EJJUHEL-KAFIRUN.

2. LA A'BUDU MA TA'BUDUN.

3. UE LA ENTUM 'ABIDUNE MA A'BUD.

4. UE LA ENE ABIDUN MA 'ABEDTUM.

5. UE LA ENTUM 'ABIDUNE MA A'BUD.

6. LEKUM DINUKUM UE LIJE DIN.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Thuaj: “O ju jobesimtarë!

2. Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuron!

3. As ju nuk jeni adhures të Atij që unë e adhuroj!

4. Dhe unë kurr nuk do të jem adhures i asaj që ju adhuron!

5. Por edhe ju nuk do të jeni adhures të Atij që unë adhuroj!

6. Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!

Suretu El-Keuther

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. INNA A'TAJNA KEL KEUTHER.

2. FESAL-LI LIRABBIKE UENHAR.

3. INNE SHANIEKE HU UEL EBTER.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Ne, vërtet, të dhamë ty shumë mira.

2. Andaj, ti falu dhe prej kurban për hirë të Zotit tënd!

3. E s'ka dyshim se urrejtësi yt është farësosur.

Suretu El-Maun

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. A RAEJTEL-LIDHI JUKEDH-DHIBU BID-DIN.

2. FE DHALIKEL-LEDHI JEDU'UL JETIM.

3. UE LA JEHUD-DU'ALA TA'AMIL-MISKIN.

4. FEUEJLUL-LIL MUSAL-LIN.

5. EL-LEDHINE HUM 'AN SALATIHIM SAHUN.

6. EL-LEDHINE HUM JURA'UN.

7. UE JEMNE'UNEL-MAUN.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. A e ke parë ti (a e sheh) atë, që përgënjeshtron përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?
2. Po ai është që e përzë në mënyrë të vrazhdë bonjakun.
3. Dhe që nuk nxit për të ushqyer të varfërin.
4. Pra shkatërrim është për ata që falen,
5. të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.
6. Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe).
7. Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua).

Suretu Kurejsh

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. LI ILAFI KUREJSH.
2. I LA FIHIM RIHLETESH-SHITAI UES-SAJF.
3. FEL-JA'BUDU RABBE HADHEL-BEJT.
4. EL-LEDHI AT'AMEHUM MIN XHU'IN UE AME-NEHUM MIN HAUF.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Për hirë të garantimit që e gëzojnë kurejshitët!
2. Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimërit dhe verës!
3. Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie,
4. I cili i ushqe pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!

Suretu El-Fil

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. ELEM TERE KEJFE FE'ALE RABBUKE BI ASHABIL FIL.
2. ELEM JEXH'AL KEJDEHUM FI TADLIL.
3. UE ERSELE 'ALEJHIM TAJRAN EBABIL.

4. TERMIHIM BIHIXHARETIN MIN SIXH-XHIL. 5. FE XHE'ALEHUM KE'ASFIN ME'KUL.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit?
2. A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar?
3. Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë-tufë!
4. Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar!
5. Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!

Suretu El-Humeze

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. UEJLUL-LIKUL-LI HUMEZETIL-LUMEZEH.
2. EL-LEDHI XHEME'AL MALEU UE 'ADDEDEH.
3. JAHSEBU ENNE MALEHU AHLEDEH.
4. KEL-LA LEJUMBEDHENNE FIL HUTAME.
5. UE MA EDRAKE MEL HATAMEH.
6. NARULL-LLAHIL MU KADEH.
7. EL-LETI TET-TALP'U-'ALEL EF'IDEH.
8. INNEHA ALEJHIM MU'SADEH.
9. FI 'AMEDIN-MUMEDDEDEH.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit),
2. Që ka tubuar pasuri dhe që atë e ruan të mos i pakësohet.
3. E mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.
4. Jo, të mos medojë ashtu! Se ai pa tjetër do të hidhet në Hutame.
5. E çka din ti se ç'është Hutame?
6. Është zjarri i All-llahut i ndezur fort.

7. Që depërton deri në loçkë të zemrës.
8. Ai i mbyll ata, ua zë frymën.
9. Ata janë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme.

Suretu El-Asr

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. UEL ‘ASR.
2. INNEL-INSANE LEFI HUSR.
3. IL-LEL-LEDHINE AMENU UE ‘AMILUS-SALIHA-TI UE TEUASAU BIL-HAKKI UE TEUASAU BIS-SABR.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Pasha kohën!
2. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.
3. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshem.

Suretu Et-Tekathur

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. EL HAKUMUT-TEKATHUR.
2. HATTA ZURTUMUL-MEKABIR.
3. KEL-LA SEUFE TA'LEMUN.
4. THUMME KEL-LA SEUFE TA'LEMUN.
5. KEL-LA LEUTA'LEMUNE'ILMEL JEKIN.
6. LETEREUUNNEL-XHEHIM.
7. THUMME LETEREUUNNEHA 'AJNEL JEKIN.
8. THUMME LETUS'ELUNNE JEUME IDHIN 'ANIN-NE'IM.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Juve u preokupoi përpjekja për shumimin (e pasurirë, të fëmijëve, të pozitës)!

2. Derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banues të tyre - të vdisni).

3. Jo, nuk është ashtu! Gjithsesi këtë do ta kuptoni më vonë!

4. Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni!

5. Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurt (nuk do të bënit ashtu).

6. Ju pa tjetër do ta shihni Xhehennemin.

7. Madje atë do ta shihni të bindur plotësisht.

8. Pastaj në atë ditë do të pyeteni për të mirat (e dynjas).

Suretu El-Karia

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. EL-KARIAH.

2. MEL KARIAH.

3. UE MA EDRAKE MEL KARIAH.

**4. JEUME JUKUNUN-NASU KEL-FERASHIL
MEBTHUTH.**

5. UE TEKUNUL-XHIBALLU KEL'IHNIL MEN FUSH.

6. FE EMMA MEN THEKULET MEUAZINUH.

7. FE HUUE FI'ISHETIN RADIJEH.

8. UE EMMA MEN HAFFET MEUAZINUH.

9. FE UMMUHU HAUJEH.

10. UE MA EDRAKE MA HIJEH.

11. NARUN HAMIJEH.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Krisma e kijametit.

2. Çka është krisma?
3. Dhe ç'të mësoi ty se ç'është krisma?
4. Ajo është ditë kur njerëzit bëhen si insekte të shpërndara.
5. Dhe kodrat bëhen si leshi i shprishur.
6. E sa i përket atij që i rëndohet peshoja e veprave të tij,
7. Ai është në një jetë të këndshme.
8. Ndërsa, atij që ka peshojën e lehtë të veprave të tij,
9. Vendi i tij do të jetë në Havije.
10. E ç'është ajo që të njohtoi se ç'është ai (Havije)?
11. Është zjarri me nxehtësi shumë të lartë.

Suretu El-Adijat

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

- 1. UEL 'ADIJATI DABHA.**
- 2. FEL MURIJATI KAD-HA.**
- 3. FEL MUGIRATI SUB-HA.**
- 4. FE ETHERNE BIHI NAK'A.**
- 5. FE UESATNE BIHI XHEM'A.**
- 6. INNEL INSANE LIRABBIHI LEKENUD.**
- 7. UE INNEHU 'ALA DHALIKE LESHEHID.**
- 8. UE INNEHU LIHUBBIL-HAJRI LESHEDID.**
- 9. E FELAJA'LEMU IDHA BU'THIRE MA FIL-KUBUR.**
- 10. UE HUS-SILE MA FIS-SUDUR.**
- 11. INNE RABBEHUM BIHIM JEUME IDHIN LEHABIR.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Pasha vrapuesit e shpejtë (kuajt) që hingëllojnë!
2. E që me thundrat e tyre nxjerrin xixëllima zjarri nga gurët,
3. Dhe të cilët vërsulen herët në agim.
4. E me të (vërsulje) atëherë çojnë pluhur.
5. Dhe ashtu hidhen në mesin e grumbullit (të armikut).
6. Vërtet, njeriu është përbuzës ndaj Zotit të vet.

7. Edhe vetë është dëshmues i asaj (përbuzjeje).
8. Dhe ai është që shumë e do pasurinë.
9. A nuk e di ai se kur të nxirret çka është në varreza?
10. Dhe të tubohet (të dalë në shesh) ajo që ishte në gjoks.
11. E atë ditë, pa dyshim Zoti i tyre është i njohur për punën e tyre.

Suretu Ez-Zelzele**Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim**

1. IDHA ZULZILETIL ERDU ZILZALEHA.
2. UE AHREXHETIL ERDU ETHKALEHA.
3. UE KALEL-INSANU MA LEHA.
4. JEUME IDHIN TUHADDITHU AHBAREHA.
5. BI ENNE RABBEKE EUHA LEHA.
6. JEUME IDHIJ-JASDURUNNASU ESHTATEL-LIJUREU A'MALEHUM.
7. FE MEJ-JA'MEL MITHKALE DHERR-RRETIN HAJREJ-JERAH.
8. UE MEJ-JA'MEL MITHKALE DHERR-RRETIN SHERR-RREJ-JERAH.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme,
2. Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj (barrën nga brenda),
3. Dhe njeriu të thotë: “Ç’ka kjo (që bën këtë dridhje)?”
4. Atë ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta,
5. Ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë.
6. Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre.
7. E kush punoi ndonjë të mirë, që pëshon sa grimca, atë do ta gjejë.

8. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.

Suretu El-Bejjineh

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. LEM JEKUNIL-LEDHINE KEFERU MIN EHLIL-KITABI UEL MUSHRIKINE MUNFEKKINE HAT-TA TE'TIJEHUMUL-BEJJINEH.

2. RESULUN-MINALL-LLAHI JETLU SUHUFEN-MUTAHHAREH.

3. FIHA KUTUBUN KAJ-JIMEH.

4. UEMA TEFERR-RREKAL-LEDHINE UTUL KITABE IL-LA MIM BA'DI MA XHA ET-HUMUL BEJJINEH.

5. UEMAUMIRUIL-LALIJA'BUDULL-LLAHEMUHLISINE LEHUD-DINEHUNEFAEUEJUKIMUS-SALATEUEJU'TUZ-ZEKATE UE DHALIKE DINUL-KAJJIMEH.

6. INNEL-LEDHINE KEFERU MIN EHLIL KITABI UEL MUSHRIKINE FI NARI XHEHENNEME HALI-DINE FIHA ULAIKE HUM SHERR-RRUL-BERIJJEH.

7. INNEL-LEDHINE AMENU UE 'AMILUS-SALIHATI ULAIKE HUM HAJRUL-BERIJJEH.

8. XHEZAUHUM 'INDE RABBIHIM XHENNATU 'ADNIN TEXHRI MIN TAHTIHEL ENHARU HALI-DINE FIHA EBEDA, RADIJALL-LLAHU 'ANHUM UE RADU'ANH DHALIKE LIMEN HASHIJE RABBEH.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Ata nga ithtarët e librit dhe idhujtarët, të cilët nuk besuan, nuk iu ndanë (besimit të tyre) derisa atyre u erdhi argumenti i qartë,

2. I dërguari prej All-llahut, që lexon fletë të pastra,

3. Në të cilat ka vetëm dispozita të drejta.

4. Dhe ata të cilëve u është dhënë libri, nuk u ndanë vetëm pasi që u erdhi argumenti.

5. E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.

6. S'ka dyshim se ata, të cilët nuk besuan nga ithtarët e librit dhe nga idhujtarët, do të jenë në zjarrin e Xhehen-nemit, aty do të jenë përgjithmonë. Të tillët janë krijesa më e dëmshme.

7. Ndërsa, ata që besuan dhe bënë vepra të mira, të tillët janë krijesa më e dobishme.

8. Shpërblimi për ta te Zoti i tyre janë: vendet ne Xhen-nete nëpër të cilët burojnë lumenj, e aty janë përgjithmonë, pakëputur. All-llahu është i kënaqur ndaj tyre, e edhe ata të kënaqur prej Tij. E ky është për atë, që i ka pasur dronë Zotit të vet.

Suretu El-Kadr.

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. INNA ENZEL NAHU FI LEJLETIL-KADR.

2. UE MA EDRAKE MA LEJLETUL-KADR.

3. LEJLETUL-KADRI HAJRUN-MIN ELFI SHEHR.

4. TENEZ-ZELUL-MELAIKETU UERR-RRUHU FIHA BI IDHNI RABBIHIM-MIN KUL-LI EMR.

5. SELAMUN HIJE HAT-TA MATLE'IL-FEXHR.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në natën e Kadrit.

2. E ç'të bëri ty të dijshe se ç'është nata e Kadrit?

3. Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj!

4. Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje.

5. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.

Suretu El-Alak

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. IKRE BISMI RABBIKEL-LEDHI HALAK.
2. HALEKAL-INSANE MIN 'ALEK.
3. IKRE UE RABBUKEL-EKREM.
4. EL-LEDHI 'AL-LEMEL BIL-KALEM.
5. 'AL-LEMEL-INSANE MA LEM JA'LEM.
6. KEL-LA INNEL-INSANE LEJATGA.
7. ERR-RRA EHU-S TAGNA.
8. INNE ILA RABBIKERR-RRUXH'A.
9. E RAEJTEL-LEDHI JENHA.
10. 'ABDEN IDHA SAL-LA
11. E RAEJTE IN KANE 'ALEL-HUDA.
12. EU EMERE BIT-TAK'UA.
13. E RAEJTE IN KEDH-DHEBE UE TEUEL-LA.
14. E LEM JA'LEM BI ENNELL-LLAHE JERA.
15. KEL-LA LEIL-LEM JENTEHI LENESFE'AM
BIN-NASIJE.
16. NASIJETIN KADHIBETIN HATIEN.
17. FEL-JED'U NADIJEH.
18. SE NED'UZ-ZEBANIJEH.
19. KEL-LA, LA TUTI'AHU UESXHUD UEKTERIB.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).
2. Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës).

3. Lexo! Se Zoti yt është më bujari!
4. Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë.
5. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.
6. Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë,
7. Për shkak se e ndien veten të pavarur.
8. Po kthimi është vetëm te Zoti yt.
9. A më tregon atë që pengon,
10. një rob kur ai falet?
11. Ç'mendon kur ai (robi) është në rrugë të drejtë?
12. Ose ai (rob) urdhëroi për sinqeritet.
13. A më tregon nëse ai përgënjeshton dhe zbrapset (nga besimi)?
14. A nuk e di ai se All-llahu e sheh?
15. Jo, Jo! Nëse nuk tërhiqet, vërtet do ta kapim për flokësh mbi ballin.
16. Floku rrenacak, mëkatarë.
17. E ai le t'i thërret ata të vetët.
18. Ne do t'i thërrasim zebanitë.
19. Jo, Jo! Ti mos iu bind atij, vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit me të.

Suretu Et-Tinë**Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim**

1. UET-TINI UEZ-ZEJTUN.
2. UE TURI SININ.
3. UE HADHEL BELEDIL-EMIN.
4. LEKAD HALEKNEL-INSANE FI AHSENI TEK'UIM.
5. THUMME REDEDNAHU ESFELE SAFILIN.
6. IL-LEL LEDHINE AMENU UE 'AMILUS-SALIHATI FE LEHUM EXHRUN GAJRU MEMNUN.
7. FE MA JUKEDH-DHIBUKE BA'DUBID-DIN.

8. ELEJSELL-LLAHU BI AHKAMI HAKIMIN.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Pasha fikun dhe ullirin!
2. Dhe (kodrën) Turi Sina-en!
3. Dhe këtë qytet të sigurisë!
4. Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur.
5. Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve.
6. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë.
7. E pas gjithë kësaj, ç'të shtyri të përgënjeshtrosh ditën e shpërblimit (përgjegjesisë)?
8. A nuk është All-llahu më i urti gjykuesve?

Suretu El-Shirah

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. **ELEM NESHRAH LEKE SADREK.**
2. **UE UEDA'NA 'ANKE UIZREK.**
3. **EL-LEDHI ENKADA DHAHREK.**
4. **UE RAFA'NA LEKE DHIKREK.**
5. **FE INNE ME'AL-USRI JUSRA.**
6. **INNE ME'AL-'USRI JUSRA.**
7. **FE IDHA FERAGTE FENSAB.**
8. **UE ILA RABBIKE FERGAB.**

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd?
2. Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde,
3. E cila shtypte shpinën tënde.
4. Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde?
5. E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi.
6. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi.

7. E kur ta kryejsh (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim (All-llahut).

8. Dhe, vetëm te Zoti yt përqëndro synimin!

Suretu Ed-Duha

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

1. EUD-DUHA.

2. UEL-LEJLI IDHA SEXHA.

3. MA UED-DEAKE RABBUKE UE MA KALA.

4. UE LEL-AHIRETU HAJRUL LEKE MINEL-ULA.

5. UE LESEUFE JU'TIIKE RABBUKE FE TERDA.

6. ELEM JEXHIDKE JETIMEN FE AUA.

7. UE UEXHEDEKE DAL-LEN FE HEDA.

8. UE UEXHEDEKE 'A-ILEN FE AGNA.

9. UE EMMEL-JETIME FE LA TAKHER.

10. UE EMMAS-SA ILE FE LA TENHER.

11. UE EMMA BINT'AMETI RABBIKE FE HADITH.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

1. Pasha paraditën!

2. Pasha natën kur shtrinë errësirën!

3. Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur.

4. Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para.

5. E Zoti yt do të jepë ty, e ti do të kënaqesh.

6. A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrahje).

7. Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzojë.

8. Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi.

9. Pra, mos e përul jetimin!

10. As lypësin mos e përzë!

11. E me të mirat që të dha Zoti yt, trego (udhëzo njerëz)!

Ajjeti Kursij

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

ALLAHU LA ILAHE IL-LA HUUEL HAJ-JUL KAJ-JUM. LA TE'HUDHUHU SINETUN UE LA NEUM. LEHU MA FIS-SEMAUATI UE MA FIL ERD. MEN DHEL-LEDHIJ JESHFEU INDEHU IL-LABI IDHNIH. JA'LEMU MA BEJNE EJDIHIM ME MA HALFEHUM UE LA JUHITUNE BI SHEJIN MIN ILMIHI ILA BIMA SHA-AE. UESIA KURSIJUHUS-SEMAUATI UEL-ERD. UE LA JEUDUHU HIFDHUMUMA UE HUUEL ALI-JUL ADHIM.

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

All-llahu - s'ka zot pos Tij. I Gjalli, Vigjiluesi. Nuk e ze të koturit, e as gjumi. E Tija është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, pos me lejën e Tij? Ai e di se ç'po u ndodhë dhe ç'do t'u ndodhë. Dhe asgjë nga dija e Tij nuk mund të përvetësojnë, pos sa të dojë Ai. Ndërsa Kursija e Tij përfshin qiejt dhe tokën. E nuk lodhet duke i ruajtur (mirëmbajtur), ngase Ai është i Larti, Madhështori. (Ky ajet quhet edhe "Ajetul-Kursij")



FIK'HU (JURISPRUDENCA)

Pastërtia dhe falja

Llojet e ujit

Uji ndahet në dy lloje: I pastër dhe i papastër.

1- I pastër. I tillë konsiderohet ai ujë që është i pastër në vetvete dhe pastrues i sendeve të tjera, siç është uji i burimeve, i puseve, i lumejve, uji i shiut, etj.

2- I papastër: Konsiderohet ai ujë që ndryshon si pasojë e rënies së ndonjë papastërtie në të. Ky ujë i ndotur nga rënia e papastërtive klasifikohet në dy lloje. Lloji i parë është uji i pakët, në të cilin bie papastërtia, ndërsa lloji i dytë është uji në sasi të madhe, në të cilin papastërtia që bie nuk ka efekt, veçse atëherë kur ia ndryshon ngjyrën, shijen apo aromën. Në këto kushte uji quhet i papastër. Ndërsa në ato raste kur ngjyra, shija apo aroma ndryshon si rezultat i diçkaje të pastër (deri në atë masë që të vazhdojë të konsiderohet ujë) atëherë ky ujë është i pastër dhe pastrues njëkohësisht. Ndërsa nëse sasia e gjërave të pastra që mund të bien në të është shumë e madhe, atëherë ky ujë konsiderohet i pastër në vetvete por jo pastrues siç janë p.sh. pijet e ndryshme etj.

Uji që vlen për abdes dhe për larjen e trupit është uji i pastër në vetvete dhe pastrues për të tjerët.

Edukata e kryerjes së nevojës

Ndoshta për ndokënd që i di mirë rregullat e mëposhtme mund t'i duket e panevojshme përmendja e tyre këtu, por të mos harrojmë që ka dhe shumë të tjerë që

mund të mos i dinë, ndaj është detyrë informimi i tyre. Domoshdoshmërinë e kësaj teme e tregon edhe fakti se muslimani duhet të jetë gjithmonë në kërkim dhe në zbatim të asaj që është më e mirë për fenë dhe moralin e tij si njeri.

1- Mos merr me vete diçka ku është shkruar emri i Allahut, vetëm në rast se frikësohesh se të humbet ose nëse e ke të mbështjellë me diçka izoluese.

2- Largohu nga njerëzit (kur kryen nevojën) dhe fshihju atyre, që mos të të shikojnë, sidomos kur kryen nevojën e madhe.

3- Futu me këmbën e majtë dhe dil me të djathtë. Thuaj “Bismil-lah”, dhe “Eudhu bil-lahiminesh shejtani rraxhim”, para se të hysh në nevojtoare. Është sunet të thuash: *“Bismil-lahi, Allahumme inni e udbu bika minel-kebubthi uel khabaithi”* (Me emrin e Allahut, O Zot, unë të lutem Ty të më ruash nga i ndyri (djalli) dhe ndyrësitat (xhindët). Është vërtetuar se Muhamedi, alejhi selam, e thoshte këtë kur hynte në nevojtoare, ndërsa kur dilte prej saj thoshte: *“Gufraneke”* (O Zot më fal). (Hadith Sahih.)

4- Mos fol kur kryen nevojën, qoftë dhikër (përmendje e Zotit) ose fjalë të tjera. Bile as përshëndetjen (me selam) mos e kthe si dhe mos i përsërit as fjalët e muezinit (atij që bën thirrjen e ezanit për namaz). Të lejohet të flasësh për ndonjë çështje të domoshdoshme e në qoftëse testin kur po kryen nevojën, falënderoje Allahun por në vetëvete dhe pa lëvizur gjuhën.

5- Respekto drejtimin e kiblës (Qaben) dhe mos u kthehe në drejtim të saj, as nga përpara dhe as nga mbrapa (por ktheji krahun e djathtë ose të majtin).

6- Nëse je në ndonjë vend të hapur gjej një vend të butë dhe të ulët në mënyrë që të ruhesh nga stërpikja e urinës.

7- Mos e kryej nevojën sipër vrimës (që kanë hapur in-sektet) sepse aty mund të ketë ndonjë gjë që e dëmton.

8- Mos e kryej nevojën në vende me hije ku qëndrojnë njerëzit, as në rrugën që kalojnë dhe as në vendet ku ata mbledhen.

9- Mos urino në vendin ku lan trupin dhe as në ujin ndejtës apo rrjedhës.

10- Mos urino në këmbë, sepse kjo gjë i ul autoritetin dhe zakonet e mira njeriut si dhe mund të bëhesh pis. Në rastet kur je i sigurtë nga stërpikja, të lejohet të urinosh në këmbë.

11- Pastroji dy vendet e jashtëqitjes me dorën e majtë sepse e djathta nuk duhet të prekë ndyrësira.

12- Pas pastrimit (të vendeve të jashtëqitjes), duhet ta lashë dorën me ujë e sapun e në pamundësi fërkoje atë me dhë etj.

Istinxhaë dhe Istixhmar

Istinxha është pastrimi me ujë i venddaljes së urinës dhe jashtëqitjes.

Istixhmar është fshirja e urinës dhe mbeturinës së jashtëqitjes më gur, letër e me çdo gjë tjetër të pastër e të lejuar për këtë veprim. Kjo gjë zëvendëson pastrimin me ujë.

Për istixhmarin nuk lejohet përdorimi i kockës, bajgës.

Abdesi

Kushtet e abdesit:

1. Të jesh musliman.
2. Mosha e pjekurisë
3. Të jesh mendërisht i aftë.
4. Nijeti (qëllimi).
5. Uji që përdoret për abdes të jetë i pastër.

6. Heqja e çdo gjëje që pengon arrijtjen e ujit në trup si: manikyri, boja e vajit etj.

Veprimet e domosdoshme të abdesit:

1. Larja e fytyrës, duke përfshirë larjen e gojës dhe të hundës.

2. Larja e duarve deri në bërryla.

3. Fërkimi me duar të lagura i gjithë kokës dhe i veshëve.

4. Larja e këmbëve deri te nyjet.

5. Vazhdimësia e abdesit, duke mos e ndërprerë për ta rifilluar më pas.

Gjërat që e prishin abdesin:

1. Çdo gjë që del nga dy rrugët e jashtëqitjes.

2. Ikja e mendjes në rast gjumi, të fikti, dehjeje ose në raste të tjera kur humbet vetëdija.

3. Prekja me dorë dhe pa mbulesë e organit.

Si merret abdes

Në fillim bëhet nijeti e pas tij kryhen këto veprime:



**Lahen duart deri te
kyçet (tri herë)**



**Lahet goja me dorën e
djathtë (tri herë)**



Pastrohet hunda me dorën e djathtë (tri herë)



Lahet fytyra me të dyja duart (tri herë)




Lahet dora e djathtë bashkë me bërrylin (tri herë)



Lahet dora e majtë bashkë me bërrylin (tri herë)



Bëhet mes'h (fshihet) koka me të dyja duart e lagura (një herë)



Pastrohen veshët (një herë)



**Lahet këmba e djathhtë
deri te nyjet (tri herë)**



**Lahet këmba e majtë
deri te nyjet (tri herë)**

Në fund thuhet:

“Eshhedu en la ilahe ila Allah uahdehu la sherike leh, ue eshhedu ene Muhameden abduhu ue resuluhu. Allahume xhealni mine teuabin ue xhealni minel mutetahirin.”

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të vetëm e pa shok, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. O Allah më bëj mua prej të penduarve dhe prej të pastruarve!

Fshirja (mes’hu) e mesteve:

Feja Islame dallohet në ofrimin e lehtësive. Nga këto lehtësira përmendim edhe mes’hun (fshirjen) me dorë të lagur të mesteve. Mestet janë një lloj veshjeje për këmbët, të punuara prej lëkure të hollë apo prej ndonjë materiali tjetër të ngjashëm. Nëse kjo lloj veshjeje është prej pambuku atëherë mund t’i quajmë dhe çorape, të cilat i zëvendësojnë mestet. Por, në përdorimin e mes’hut duhen marrë parasysh kushtet e poshtëshënuara.

1. Kushti i mes’hut:

Muslimani i pastruar me abdes apo gusul (gusul-larje e gjithë trupit) nëse i prishet abdesi, nuk ka nevojë të

heqë mestet apo çorapët nga këmbët për të marrë abdes, por mjafton të kalojë sipër tyre dorën e lagur. Pra, kushti themelor i mes'hut (fshirjes) është që t'i veshë mestet apo çorapet pasi të ketë marrë abdes (para se ta prishë abdesin) ose gusul.

2. Kohëzgjatja e mes'hut:

Kohëzgjatja e mes'hut për joudhëtarët është një ditë e një natë, për udhëtarin është tri ditë e tri netë, duke filluar që nga fshirja e parë.

3. Si duhet të jenë mestet apo çorapet:

a) Duhet të jenë të punuara nga një material i pastër dhe i lejuar. Mestet nuk bëhen me material të ndyrë si p.sh. lëkurë qeni apo derri.

b) Të jenë pronë legjitime, jo të vjedhura apo të rrëmbyera.

Tejemumi (pastrimi me dhë):

Nga format e shfaqjes së lehtësive në fenë Islame është edhe tejemumi në rastet e mungesës së ujit, frika nga të ftohtët apo nga përkeqësimi i gjendjes shëndetësore që mund të shkaktojë përdorimi i ujit.

Allahu i Madhëruar thotë:

“ ... dhe nëse nuk gjeni ujë atëherë merrni tejemum me dhë të pastër duke fërkuar fytyrat dhe duart tuaja...”
(El-Maide: 6)

Mënyra e marrjes së tejemumit:

Tejemumi merret duke goditur një herë sipërfaqen e dheut të pastër me të dyja duart dhe me shuplakat fshihet fytyra dhe duart (një herë).

Kushtet e tejemumit:

1. Pamundësia e përdorimit të ujit për shkak të mungesës, frikës së sëmundjes nga përdorimi i tij, të ftohtët e madh, duke mos pasur mundësi për ta ngrohur etj.

2. Hyrja e kohës së faljes. Tejemumi, ndryshe nga abdesi nuk merret para hyrjes së kohës së faljes.

3. Nijeti (qëllimi) me zemër. Tejemumi nuk vlen pa nijet.

Faktorët që e prishin tejemumin:

Tejemumi priset me çdo faktor, që prish edhe abdesin. Plus këtyre ai priset sapo të gjendet uji, qoftë edhe gjatë kohës së faljes, por jo pas saj. Por kjo nuk vlen për ata të cilët marrin tejemum për shkak të frikës së sëmundjes nga përdorimi i ujit apo nga të ftohtët e madh.

Larja e përgjithshme e trupit pas xhenabetit

Larja e trupit bëhet e detyrueshme për disa shkaqe, ato janë:

1. Dalja e spermës, qoftë si pasojë e bashkimit seksual, prejkes së gruas (me epsh) apo ëndërrimit.

2. Me aktin seksual (kur organet takohen me njëri-tjetrin) edhe nëse nuk del sperma.

3. Pas daljes së gjakut të menstruacioneve apo të lehonisë. Larja duhet të bëhet pas mbarimit të daljes së gjakut, sapo të dallohet sekrecioni i bardhë.

Mënyra e larjes së trupit nga xhenabeti

1. Lahen duart (tri herë).
2. Lahet organi gjenital dhe vendi i papastër.
3. Lahet brendia e gojës dhe e hundës.
4. Lahet fytyra (tri herë).
5. Lahen duart bashkë me bërrylat, duke filluar me të djathtën e pastaj me të majtën.
6. Fërkohet koka dhe veshët.
7. Lahet koka (tri herë)

8. Lahet i gjithë trupi me ujë, duke filluar me pjesën e djathtë dhe nga sipër poshtë.
10. Lahen këmbët deri te nyjet.
11. Uji të prekë të gjitha pjesët e trupit.



Eja të shkojmë në xhami...

“Eja të shkojmë në xhami”, - i thashë, ndërsa dëgjova ezanin, mikut tim që e kisha takuar rastësisht pas shumë vitesh. Ai më pa me habi. “Mos e ke harruar gjë se sot është e premte?” - i thashë me dëshirën e brendshme që vështrimi i tij i habitur të zbutej disi.

“Po ti, mos e ke harruar se unë as falem e as shkoj në xhami?” - E kapërceu ai situatën duke qeshur me zor. Megjithëse nuk më habiti aspak përgjigja e tij, e thënë në kontekstin e një aktualiteti ku “Zoti” dhe “feja” nuk janë terma fort të popullarizuar, nuk e di as vetë për ç’arsye këmbëngula me pyetjen e mëtejshme: “E pse?”

Me një mimikë që shprehte vështirësi për të gjetur përgjigje, por edhe sforcim për të mos shkelur rregullat e mirësjelljes, m’u përgjigj: “Nuk e di... Nuk bëhem mbarë... Pastaj kam edhe shqetësimin e pantallonave që humbasin hekurosien ndërsa përkulem për t’u falur...”

Në të vërtetë, ai ishte shumë i kujdesshëm për veshjen e tij. Mbante kryesisht rroba të gjelbra, të kombinuara bukur, të pastra e gjithmonë të hekurosura. Kështu më kujtohej që nga kohërat e shkollës.

“Po mirë, asnjëherë nuk do të falesh e nuk do të vish në xhami?” - e pyeta pa e ditur as vetë pse. “...Nuk besoj” - m’u përgjigj ai pas një ngurrimi plot mirësjellje për të mos m’u përgjigjur me një “jo” të prerë...

Nuk kishin kaluar veçse pak ditë nga kjo bisedë kur më njoftuan se ai ishte në xhami. Nxitova për atje. E pikasa menjëherë tek qëndronte në oborrin e xhamisë, në krye të safëve, në rreshtin e parë të njerëzve. U afrova ngadalë

dhe i pëshpërta me zë të ulët e të mekur: “Ti sikur nuk kishe ndërmend të vije ndonjëherë në xhami!”

Kësaj radhe ai nuk u mundua të kërkonte ndonjë përgjigje, por u mjaftua duke qëndruar i heshtur nën pël-hurën që mbulonte trupin e tij të pajetë të vendosur në tabutin (barrelë) e vdekjes.

Namazi është mbrojtës nga të këqijat, të emërtuara si vepra të shëmtuara dhe të padrejta, dhe të ndihmon në arritjen e mirësisë së dëshiruar, siç është përkujtimi i Allahut. Arritja e kësaj mirësie është më e rëndësishme sesa të ruash veten nga të këqijat, sepse përmendja e Allahut dhe adhurimi i Tij me singëritet të vërtetë, është vetëmbrojtja më e mirë nga të këqijat dhe është një qëllim në vetvete për t’u dhënë fund atyre. Adhurimi që zemra i bën Allahut, është qëllim në vetvete, ndërsa largimi i ndonjë të keqeje prej saj, është një qëllim që lidhet me pasojat e shkatërrimit që sjellin gjunahet në zemër. Zemra e shëndoshë kërkon të vërtetën dhe të mirën, e sa herë që ajo përballet me të këqijat, mundohet t’i shmangë ato, sepse të këqijat e shkatërrojnë zemrën siç i shkatërron të mbjellat bari i keq.

Ibn Tejmije



NAMAZI (FALJA)

Rëndësia e namazit dhe domosdoshmëria e kryerjes së tij

Namazi është shtylla e dytë nga pesë shtyllat e Islamit. Ai është lidhja ndërmjet robit dhe Zotit të Tij. Ai që e lë namazin, e ka shkëputur lidhjen me Zotin e Tij të Madhërueshëm, i Cili na urdhëron që të kryejmë namazet e detyrueshme në kohët e caktuara.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Vazhdoni rregullisht namazet (faljet) e sidomos atë të mesmin, dhe ndaj Allahut të jeni respektues (në namaze).”
(El-Behare: 238)

Abdullah bin Mes'udi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, ka thënë: “E pyeta të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të*, se cila është vepra më e mirë. I Dërguari i Allahut tha: “Është namazi në kohën e tij.” Atëherë e pyeta përsëri: “Po pas namazit kush vjen?” Ai tha: “Bindja ndaj prindërve.” Po pastaj? - vazhdova unë. “Është lufta në rrugën e Allahut - m'u përgjigj ai.” (Ky hadith është transmetuar nga Buhari dhe Mulimi)

Historiku i namazit

Historia e namazit ka nisur qysh me krijimin e gjithësisë. Allahu i Madhëruar na tregon se nuk janë vetëm njerëzit ata që e adhurojnë Allahun por se çdo krijesë e di formën e vet të faljes dhe të madhërimit, Allahu thotë:

“Që të gjithë e dinë formën e vet të faljes dhe të madhërimit (ndaj Allahut).”

Muhamedi, alejhi selam, ka thënë: *“Jam urdhëruar unë dhe të gjithë të Dërguarit e tjerë që t’i vendosim duart të djathtën mbi të majtën në namaz.”* Buhari

Nga ky hadith kuptojmë se të gjithë të Dërguarit e Allahut e kanë pasur si detyrë faljen e namazit, duke filluar qysh nga babai i njerëzimit, Ademi, alejhi selam, e deri tek i Dërguari i fundit Muhamedi, alejhi selam. Një veprim i përbashkët për faljen e gjithë të dërguarve është dhe rënia në sexhde, me ballë dhe hundë në tokë, si simbol nështrimi ndaj Zotit dhe jo adhurimi i tokës, siç thonë të paditurit.

Kur’ani Famëllartë, Fjala e Zotit, mrekullia e dhuruar popullit të Muhamedit, alejhi selam, na tregon se të Dërguarit e Zotit janë falur e lutur. Do të veçoja prej tyre Sulejmanin, alejhi selam, për të cilin Zoti në Kur’an thotë:

“Ne Daudit i falëm Sulejmanin, rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti. Kur në një parambrëmje iu shfaqën atij kuaj që, kur ishin të ndalur, rrinin gatitu në tri këmbë, e ishin edhe shumë të shpejtë. E ai tha: “Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Zotit tim, derisa (dielli) u fsheh dhe perëndoi. M’i ktheni ata mua!” Atëherë filloi t’u mëshojë këmbëve e qafave.” (Sad 30-33)

Komentuesit e mëdhenj të Kur’anit shprehen: *“Sulejmani, alejhi selam, u mahnit pas kuajve dhe u hutua pas tyre, derisa i kaloi namazi nga koha e vet dhe dielli u fsheh në horizont. Mirëpo që t’i ndodhte kejo një të Dërguari, megjithëse i arsyetuar nga harresa, ai e konsideronte gjynah të madh dhe urdhëroi që t’ia kthenin dhe një herë dhe **“i fërkoi në qafa me shpatë”** pra i theri.*

Po kështu Zoti i Gjithësisë na njofton në Librin e Tij, Kur’anin, për një tjetër të Dërguar ku ka thënë: **“Ai e urdhëronte familjen e tij të falnin namaz, e të jepnin Zekat...”** e tek Allahu kishte gradën **“I kënaqur tek Zoti.”**

Në Kur'an përmendet dhe historia e Shuajbit ku populli i tij ndër të tjera i tha: **“O Shuajb! A mos vallë namazi yt (falja) të urdhëron ty të lemë atë që kanë adhuruar prindërit tanë më parë, apo që të bëjmë me pasurinë tonë atë që duam?”** Ata e dinin shumë mirë se namazi është siç thotë i Gjithëmëshirshmi në Kur'an: **“Falja ndalon nga të shëmtuarat dhe të këqijat.”**

Musait, alejhi selam i vjen urdhëri Hyjnor: **“Merrni për drejtim shtëpitë tuaja dhe faluni.”**

Ibrahimi, alejhi selam, babai i të Dërguarve, shprehet në kur'an për shkakun e lënies së gruas së tij Haxheres dhe djalit të tij Ismailit në shkretëtirën pranë Shtëpisë se Shenjtë, Kabes, ku thotë: **“Zoti ynë! Që të falin namazin...”**

Po ashtu kur'ani tregon se ai i ishte lutur Zotit ta bëjë të përkushtuar në kryerjen e faljes duke thënë: **“O Zoti im! Më bëj mua prej atyre që falen vazhdimisht, po kështu edhe prej pasardhësve të mi.”**

Isai, alejhi selam, në mrekullinë e tij të famshme kur foli në djep dhe tha: **“Foshnja (Isai) tha: Unë jam rob i Allahut, më ka dhënë Librin dhe më ka bërë Profet, e më ka porositur të fal namazin e të jap Zekatin sa të jem gjallë.”**

Kjo është tradita e Zotit e pandryshueshme: **“Ne u shpallëm atyre: Të jenë bamirës dhe të falin namaz.”**

Namazi është mënyra më e mirë e falënderimit në rast përgëzimi: **“Ndërkohë melaiket thanë: O Merjem, lutu, bëj sexhde, ruku me ata që falen (bien në ruku).”**

Të njëjtën traditë të të Dërguarve të mëparshëm ka ndjekur dhe i Dërguari i fundit, Muhamedi, alejhi selam. Ai dhe përpara se t'i zbriste shpallja e adhuronte Zotin në shpellën Hira, sepse kjo është origjina e pastër e njeriut, adhurimi i Zotit Një dhe të Vetëm. Muhamedi, alejhi selam, vazhdoi në këtë adhurim të thjeshtë derisa i Plotfuqishmi e urdhëroi në Kur'an me fjalët: **“O ti i mbuluar! Çohu dhe**

adhuroje Zotin tënd duke u falur natën. Gjysmën e natës ose shto diç më shumë dhe Kur'anin lexoje rrjedhshëm (tertila), bukur. Padyshim falja dhe adhurimi që bëhet natën, është më ndikues dhe më i qartë në shprehje.”

Siç e përmendin dijetarët e mëdhenj, kjo ishte faza e parë e namazit për besimtarët. Ata duhet të faleshin natën, më vonë me zbritjen e dispozitës së shtjelluar të faljes ditore, besimtarët u liruan nga ky obligim, mirëpo ai i mbeti detyrë dhe obligim të Dërguarit, alejhi selam, për gjithë jetën. Më vonë kur besimi u rrit, çështjet u qartësuan, besimtarët po i përballonin me sukses të gjitha sprovat, Allahu vendosi disa orare takimi mes robit dhe Zotit. Ishte viti i 10-të pas fillimit të shpalljes kur ndodh mrekullia me të Dërguarin, alejhi selam, Israja dhe Miraxhi. Është për t'u vënë dukje dhe fakti se në këtë udhëtim Muhamedi, alejhi selam, fali dy rekate namaz duke qenë imam për të gjithë të dërguarit e tjerë, gjë që tregon se namazi nuk është një praktikë që zuri fill me të Dërguarin Muhamed, por ishte një vazhdim i asaj praktike që ka pasë ekzistuar dhe te popujt e mëparshëm. Namazi i popullit të fundit ka ngjashmëri në disa pika me atë të të Dërguarve të mëparshëm, siç është rasti i të rënit me fytyrë në tokë, formë të cilën e përmbajnë dhe Librat e mëparshëm qiellorë.

Në këtë udhëtim Muhamedit dhe të gjithë njerëzimit iu bënë detyrë pesë namaze në ditë, por me shpërblimin sa për pesëdhjetë namaze. Fatkeqësisht ka prej muslimanëve që namazet iu duken të rënda, mirëpo Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: ***“Padyshim janë të rënda për këdo, me përjashtim të të ndrojturve prej Allahut, atyre që mendojnë se një ditë do ta takojnë Atë dhe se tek Ai do të kthehen.”*** Më vonë çështja e namazit u avancua në namaze sunete, të rregullta e të vazhdueshme: 2 rekate sunet para farzit të sabahut, 4 para farzit të drekës dhe 2 pas tij, 2 pas akshamit, 2 sunete dhe 3 vitër pas jaciesë.

U shtuan dhe disa obligime si namazi i xhenazes, i Bajramit, i eklipsit, namazi për kërkimin e shiut, e kështu me rradhë. E lusim Allahun të na e bëjë namazin siç thotë Muhamedi, alejhi selam: **“Qetësia, prehja, lumturia ime është në namaz.”**

Namazi shtylla e fesë

Pesë kohët e namazit u janë urdhëruar muslimanëve Natën e Miraxhit. I Dërguari i Allahut përveç të tjerash deklaroi, se namazi i çdo besimtari është ngritja e tij personale, ku ai gjendet në prani të Allahut. Të shohim se çfarë bën muslimani gjatë kohës së namazit.

Më parë ai qëndron drejt, i ngre duart dhe thotë: **“Allahu është më i Madhi.”** Kështu ai mohon çdokënd që adhurohet përveç Allahut dhe i përulet vetëm një Zoti. Pasi i radhit lëvdatat drejtuar Allahut, ai ndihet aq modest para Madhërisë së Tij, saqë përulet, e ul kokën në shenjë përkushtimi duke thënë: **“Larg të metave është Zoti im i Madhëruar”**. Pastaj drejtohet dhe e falënderon Allahun me bindje dhe siguri të plotë se Ai e sheh. E duke menduar dhe i entuziazmuar me Madhërinë e Allahut, në atë masë saqë e ndien të nevojshme të lëshohet dhe ta vendosë ballin në tokë, duke shmagur nga shpirti i tij çdo mendjemadhësi, duke e ndierë veten një krijesë e dobët që patjetër ka nevojë për Krijuesin e tij, thotë: **“Larg të metave është Zoti im i Lartësuar”**

Ai i përsërit këto veprime, sikur don ta ushtrojë (t’ia bëjë shprehi) trupin e vet për ta lartësuar, që dalëngadalë të bëhet i denjë e të kalojë prej botës materiale, në sfera të larta ku ta ndjejë se vazhdimisht është nën shikimin e Allahut.

Ky është aspekti shpirtëror i namazit. Dobitë e namazit janë të shumta, bile edhe nga aspekti material. Namazi pesë herë në ditë i tubon banorët e një lagjeje,

u mundëson të shkarkohen për disa minuta nga detyrat monotone të çështjeve të përditshme, i tubon anëtarët e një bashkësie në barazi të plotë, ku si udhëheqësi ashtu dhe i udhëhequri kryejnë faljen bashkarisht.

Kështu që kemi gjasa të bashkojmë jo vetëm anëtarët e bashkësisë, por edhe funksionarët përgjegjës të vendit, krahinës ose shtetit me namaz.

Namazi në Islam është i mirëpërcaktuar, i menduar në mënyrë të tillë që besimtarët rreth vetes ta ndiejnë Sundimin e Allahut. Aty ekziston disiplinë e shkëlqyer. Me thirrjen e ezanit, njerëzit shpejtojnë në xhami, rreshtohen pas imamit, bëjnë lëvizje të përbashkëta me të tjerët në një harmoni interesante.

Përveç kësaj, besimtarët nga të gjitha anët e rruzullit Tokësor i drejtohen një pike qendrore, Kabes, Tempullit të shenjtë në Mekë. Kjo nënkupton bashkimin e bashkësisë botërore, pa dallime klasore, racore ose rajonale.

Namazi më i mirë, në të cilin janë plotësuar të gjitha kushtet formale, është namazi me xhemat (në grup). Në rast të pamundësisë për t'u kryer në këtë mënyrë, çdo mashkull ose femër e kryen atë individualisht.

Sidoqoftë për pesë namazet e ditës, bëhet fjalë për një detyrë minimale, duhen rezervuar 24 minuta përafërsisht, që të kalohen duke qëndruar përpara Allahut.

Mirëpo të themi të vërtetën, besimtari patjetër duhet që në çdo moment të mendojë për Allahun, si në gëzim edhe në fatkeqësi, si në punë edhe kur pushon, kur kryen punë të tjera, etj. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ata që e përkujtojnë Allahun (në falje dhe vazhdimisht) në këmbë, të ulur e të mbështetur (në krah) dhe që mendojnë thellë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): Zoti ynë! Ti nuk e ke krijuar gjithë këtë kot (pa qëllim). Lavdi të qoftë ty! (i lartë je Ti nga gjithëka që të vënë Ty për shokë!) Na ruaj prej ndëshkimit të Zjarrit!”** Ali Imran: 191.

Allahu ia nënshtroi njeriut gjithësinë në dobi të tij. Mirëpo këtë shfrytëzim doemos duhet ta përcjellim me falënderim dhe dëgjueshmëri, e kurrsesi me kryelartësi ndaj Krijuesit apo me padrejtësi ndaj qenieve të tjera.

Rëndësia e Namazit

* Është kushti i dytë i Islamit.

* Është gjëja e parë për të cilën njeriu do të japë llogari. Po qe se namazi është i rregullt, atëherë do t'i shkojnë në rregull të gjitha punët, dhe e kundërta.

* Është shenja që përcakton besimtarët e devotshëm. Allahu thotë duke përshkruar besimtarët e devotshëm: **“Dhe ata që e kryejnë namazin.”**

* Ai që i kushton rëndësi namazit ka ruajtur fenë e tij, ndërsa kush nuk i kushton rëndësi namazit nuk i është përkushtuar fesë së tij.

* Feja zë vend në zemrën e një personi aq sa vend zë namazi.

* Namazi tregon dashurinë dhe mirënjohjen e njeriut ndaj Allahut.

* Namazi është një adhurim për të cilin Allahu ka urdhëruar të kryhet kur je udhëtar dhe vendali, kur je shëndoshë e i sëmure etj.

* Është porosia e fundit e të Dërguarit Muhamed, alejhi selam.

* Është bërë obligim në qiell.

* Është dritë dhe shpëtim në varr dhe në Ditën e Gjy-kimit.

* Largon nga të shëmtuarat dhe veprat e këqija.

Të mirat e namazit

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, ka thënë: “E dëgjova të Dërguarin e Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të*, duke thënë: “Mendoni sikur një lumë të kalojë para portës së ndonjërit prej jush dhe ai lahet në të pesë herë në ditë. A mbetet gjë nga papastërtitë e tij?” - Jo, nuk mbetet”- thanë të tjerët. Dhe ai vazhdoi: “Po kështu janë të pesë namazet, me to Allahu i fshin mëkatet.” Buhariu dhe Muslimi

Pasojat e lënies së namazit

Muslimani ka për detyrë të kujdeset për të pesë namazet e përditshme. Lënia e tyre është shumë e rëndë. Xhabir bin Abdull-llah, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, ka thënë: “ Muhamedi, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të*, thoshte se: “Dallimi midis njeriut besimtar dhe atij jobesimtar është lënia e namazit. “ Ahmedi dhe Muslimi.

Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, tregon se i dërguari i Allahut Muhamedi bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të ka thënë: “Namazi është gjëja e parë për të cilën robi jep llogari ditët e Kijametit. Nëse namazi i tij është në rregull, të gjitha punët e tij, në dashtë Allahu, do të dalin në rregull. Dhe në qoftë se namazi i tij nuk është në rregull, atëherë janë pa vlerë të gjitha punët e tjera të tij. “(Shkruar nga Tabarani ne librin “Elausat”

Ndërsa Abdullah bin Omer, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, thotë se Muhamedi, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të*, e përmendi një ditë namazin duke thënë: “Kush e ka kryer rregullisht namazin, ky bëhet për të dritë si argument dhe shpëtim në ditën e Kijametit. Ndërsa ai që s’është kujdesur

për namazet, ai nuk do të ketë as dritë, as argument e as shpëtim. Ditën e Kijametit ai mbetet bashkë me Karunin, Faraonin, Hamanin dhe Ubej ibn Khalefin. “ Ahmedi dhe Ibn Hibbani

Ezani

Ezani shërben për lajmërimin e muslimanëve sapo hyn koha e namazit. Në këtë mënyrë thirret xhemati (kolektivi) për t'u falur e për të kryer ritet islame.

Historiku i Ezanit

Për ndërtimin e xhamisë ndihmuan të gjithë, bashkë me ta edhe i Dërguari, alejhi selam, që ishte mbi 50 vjeç. Kur xhamia përfundoi, ishte problemi se si do të thirreshin njerëzit për namaz.

Disa sugjeronin të ndiznin një zjarr që, kur njerëzit ta shikonin, ta kuptonin se ishte koha e namazit. Disa të tjerë thanë që t'i bienin borisë. Ndërsa disa të tjerë thanë t'i bienin kambanave si në kishat kristiane në Palestinë. Por i Dërguari, alejhi selam, nuk ishte i kënaqur me këto mendime, ndërsa Umer bin Hatabi dha mendimin që të dilte një person dhe të thërriste “Namazi me xhemat”. Muhamedi, alejhi selam, e pranoi këtë mendim dhe e zbatoi atë.

Më vonë Allahu i Madhëruar i frymëzoi një ëndërr njërit prej shokëve të të Dërguarit, alejhi selam, Abdullah ibn Zejdit. Ai pa një burrë, i cili i recitoi disa vargje shumë të bukura. Kur shkoi tek i Dërguari, alejhi selam, dhe ia tregoi këtë, ai i tha se ëndrra ishte e vërtetë dhe se ishte nga Allahu. I Dërguari, alejhi selam, më pas i tha që t'ia

mësonte ato vargje Bilalit, sepse ai kishte zë të bukur dhe kumbues. Kur erdhi koha e namazit tjetër, Bilali u ngjit në një nga muret e xhamisë dhe thirri me zë të lartë dhe të qartë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber...”

Të gjithë erdhën duke nxituar nga lagjet e Medines për të parë se çfarë po ndodhte. Umer bin Hatabi e dëgjoi ezanin dhe erdhi menjëherë dhe i tha Muhamedit, alejhi selam, se edhe ai kështu e kishte dëgjuar në ëndërr. Në këtë mënyrë u përforcua ëndrra dhe që atëherë Ezani, ose thirrja për namaz, ka qenë mënyra me të cilën muslimanët e thirrnin njëri-tjetrin për të falur namazin. Pra nuk janë përdorur mjete artificiale, si briri, kambana apo daullja, por zëri melodioz e i pastër i njeriut.

Mënyra e thirrjes së ezanit është:

Allahu Ekber, Allahu Ekber,
 Allahu Ekber, Allahu Ekber,
 Eshhedu en la ilahe il Allah!
 Eshhedu en la ilahe il Allah!
 Eshhedu enne Muhamede Rresulullah!
 Eshhedu enne Muhamede Rresulullah!
 Hajje ales Salah, Hajje ales Salah!
 Hajje al el Felah, Hajje al el Felah!
 (pas kësaj gjatë ezanit të agimit shtohet fjalja)
 Es salatu hajrun minen neum! - 2 herë
 Allahu Ekber, Allahu Ekber!
 La ilahe il Allah.

Muslimani kur e dëgjon ezanin përsërit fjalët e muezinit. Me përjashtim të “Hajje ales Salah...Hajje al el Felah...” ku dëgjuesi thotë: “La haule ue la kuuete il-la bil-lah”.

Çfarë mund të thotë dëgjuesi pasi mbaron ezani?

I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Kush thotë kur dëgjon ezanin: “Allahumme rabbe hadhihi daueti-tammeti ues salatil kaimeh, ati Muhameden el uesilete uel fadilete ue beathhu mekamen mahmuden el-ledhi ueadtehu” ai do ta meritojë ndërmjetësimin tim në ditën e Gjykimit.” Buhariu.

“O Allahu ynë! O Zot i kësaj thirrjeje të plotë, që na lajmëron për namazin, që do të falim! Nderojë Muhamedin, alejhi selam, e jepi mundësi që të jetë ndërmjetës për ne (Ditën e Gjykimit) dhe ringjalle atë në vendin e nderuar, që ia ke premtuar. Pa dyshim, Ti e mban premtimin e dhënë.”

Ikameti (përgatitja për faljen):

Allahu Ekber, Allahu Ekber,

Allahu Ekber, Allahu Ekber (ose dhe nga dy herë)

Eshhedu en la ilahe il Allah!

Eshhedu en la ilahe il Allah Eshhedu en la ilahe il Allah (ose dhe nga një herë)

Eshhedu enne Muhamede Rresulullah! Eshhedu enne Muhamede Rresulullah (ose dhe nga një herë)

Hajje ales Salah, Hajje ales Salah (ose dhe nga një herë)

Hajje alel Felah, Hajje alel Felah (ose dhe nga një herë)

Kad kameti salah, Kad kameti salah!

Allahu Ekber, Allahu Ekber!

La ilahe il Allah!

Kohët e namazit

Namazi ka kohë të caktuar. Ai mund të kryhet vetëm brenda kohës së caktuar dhe jo para hyrjes së kësaj kohe. Allahu i Madhëruar ka thënë:

“... Sepse namazi është obligim për besimtarët në kohë të caktuar.” (Suretu En- Nisaë: 103)

Kohët e namazit janë:

1. **Agimi** (Sabahu) - falet në agim, që kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit, dhe vazhdon deri pak para lindjes së diellit.
2. **Dreka** (Yleja) - falet pasi dielli të lëvizë prej zenitit deri atëherë kur hija e objektit fiton gjatësinë e tij.
3. **Zamra** (Ikindia) - falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri pak para perëndimit të diellit.
4. **Perëndimi** (Akshami) - fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit me largimin e shiritit të kuq.
5. **Darka** (Jacia) - falet pasi horizonti të errësohet plotësisht, deri deri në 1\3 e natës.

Kushtet para namazit, pa të cilat nuk mund të futesh në namaz

1. Të jesh musliman.
 2. Të jesh i vetëdijsëm.
 3. Mbushja e moshës së pjekurisë.
 4. Pastërtia, me abdes, me gusul, ose me tejemum.
 5. Pastrimi i trupit, i rrobave dhe i vendit ku falemi.
 6. Mbulimi i vendeve të turpshme të trupit.
 7. Futja e kohës së namazit.
 8. Drejtimi nga Kibla, Kabja.
 9. Nijeti, vendosja me zemër e qëllimit për t'u falur.
- Më poshtë po japim një shpjegim të shkurtër rreth tyre.

1. Të jesh musliman:

Namazi si dhe të gjitha detyrimet e tjera nuk pranohen veçse nga muslimani, që e beson Allahun si të vetmin Zot të gjithësisë dhe Muhamedin, alejhi selam si të dërguar të Tij dhe që e ka pranuar Islamin si fe. Veprat e mohuesit janë të refuzuara dhe nuk pranohet prej tij asgjë. Tregues për këtë është thënia e Allahut të Madhëruar:

“E Ne i kthehem çdo vepre që e bënë ata dhe e bëjmë hi e pluhur.” Suretu El Furkan: 23

2. Të jesh i vetëdijshëm:

Ajo është mjeti i të kuptuarit të detyrimeve ligjore islame. Për të pavetëdijshmin nuk ka detyrime. Të sëmurit mendtor nuk i kërkohet as falja, as agjërimi e as ndonjë detyrim tjetër derisa të shërohet. Tregues për këtë është thënia e të dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të, se: “Lapsi nuk shkruan për tri kategori njerëzish; nga i fjeturi derisa të zgjohet, nga i sëmuri mendtor derisa të shërohet dhe nga i vogli derisa të rritet. “

3. Mbushja e moshës së pjekurisë:

Kur i vogli fillon të dallojë të mirën nga e keqja, të bukurën nga e shëmtuara, ka arritur moshën e dallimit. Kjo ndodhë kur ai arrin shtatë vjet. Në këtë kohë ai këshillohet për të falur namazin. Ndërsa kur arrin moshën e pjekurisë urdhërohet për t'u falur.

4. Pastërtia, me abdes, me gusul, ose me tejemum.

Ky pastrim realizohet me marrjen abdes ose të guslit, me larje të plotë të trupit ose me tejemum siç e kemi shpjeguar më sipër.

5. Pastrimi i trupit, i rrobave dhe i vendit ku falemi.

Ndytësitat duhen menjanuar (pastruar) nga tri vende:

a) nga trupi, b) nga teshat e falësit, c) nga vendi në të cilin ai falet.

6. Mbulimi i vendeve të turpshme të trupit:

Për burrat gjatë namazit vendi i turpshëm është nga kërthiza deri të gjunjët. Kurse për gruan i gjithë trupi është i turpshëm me përjashtim të fytyrës, e cila mund të mbahet e zbuluar.

7. Futja e kohës së namazit.

Për çdo falje (namaz) ka një kohë të caktuar. Allahu i Madhërueshëm thotë në Kur'an: “... Sepse namazi është obligim (në kohë), i caktuar për besimtarët.” (Suretu En- Nisaë: 103)

Kjo do të thotë se falja e detyruar duhet të kryhet në kohë të caktuara. Këto kohë janë saktësuar më lart.

8. Drejtimi nga Kibla, Kabja.

Falësi duhet të gjejë drejtimin e Kiblës d.m.th. drejtimin e Qabes nga pozicioni ku ndodhet ai. Ky drejtim mund të gjendet në këto mënyra: me lindjen apo perëndimin e diellit gjatë ditës, me anë të yllit polar gjatë natës, me anë të busullës, ose duke pyetur banorët e vendit ku ndodhet. Nëse nuk gjenë mënyra orientimi si më lartë, atëherë le të falet në drejtimin që ai mendon së është drejt Kibles.

9. Nijeti, vendosja me zemër e qëllimit për t'u falur.

Ky është vendimi që merret me zemër për të bërë diçka. Ai që falet duhet të vendosë me mendje e zemër për namazin që do ta falë. Tregues për këtë është thënia e Muhamedit, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të*: “Punët vlerësohen sipas nijetit (qëllimit). Për çdo njeri ka rëndësi qëllimi që i cakton vetes.”

Shtyllat e namazit

1. Qëndrimi në këmbë, nëse ka mundësi në namazet farze (duke vendosur dorën e djathtë mbi të majtën).
2. Tekbiri fillestar duke thënë: Allahu Ekber.
3. Leximi i sures El Fatiha si nga imami ashtu dhe nga xhematit (sipas njërit mendim).
4. Rukuja.
5. Ngritja nga rukuja dhe qëndrimi drejt.
6. Sexhdja.
7. Ngritja nga sexhdja
8. Qëndrimi ndërmjet dy sexhdeve.
9. Përqëndrimi në namaz.
10. Kryerja e veprimeve sipas radhës.
11. Ulja në etehijatit e fundit.
12. Leximi i etehijatit të fundit.

13. Thënia e salauateve mbi Muhamedin, alejhi selam, pas etehijatit të fundit.

14. Dhënia e selamit.

* Nëse harron të bësh një shtyllë, këtë e plotëson duke u kthyer menjëherë në atë që ke harruar e duke bërë më pas sexhden e harresës pas selamit. Nëse e lë me qëllim njërën nga ato, namazi nuk pranohet.

Veprime të detyrueshme në Namaz

1. Të gjitha tekbiret e tjera me përjashtim të tekbirit fillestar.

2. Thënia “Semi Allahu limen hamideh” kur je imam dhe kur falesh vetëm.

3. Ndërsa thënie “Rabena ue lekel hamd” e ka detyrë ta thotë imami, xhemati dhe personi që falet vetëm.

4. Të thotë një herë në ruku “Subhane rabijel adhijm” dhe një herë “Subhane rabijel e`ala” në sexhde (nuk duhet të harrojmë se tri herë është shumë më mirë).

5. Të thotë “Rabi gfirlij” ndërmjet dy sexhdeve.

6. Ulja në etehijatin e parë.

7. Thënia e etehijatit të parë.

*** Nëse lë ndonjë prej tyre nga barresa, e plotëson me sexhden e harresës** (me përjashtim të rastit kur je në namazin me xhemat), **e nëse e lë ndonjë të tjerën me qëllim, namazi nuk pranohet.**

* Nëse shton diçka në namaz, dy sexhdet e harresës i bën pas selamit.

* Nëse pakëson diçka nga detyrat e namazit, dy sexhdet e harresës i bën para dhënies së selamit.

* Nëse dyshon për numrin e rekateve, merr për bazë numrin më të vogël dhe pastaj plotësoje duke i bërë sexhdet e harresës para selamit.

Sunetet e namazit

a)- Sunetet në fjalë

1. Duaja e hapjes.
2. Thëniet “Eudhu bilahi mineshejtani rrahijm” dhe “Bismilahi Rrahmani Rrahim”. Nuk është e nevojshme që imami t’i shqiptojë me zë.
3. Thënia ‘Amin’ (O Zot përgjigjiu lutjes sonë). (shtesë nga redaktori fetar)
4. Thënia e një sureje ose i një pjese të saj pas thënies së El Fatihasë. Leximi me zë në namazin e akshamit, jacisë, sabahut, dy Bajrameve, xhumasë dhe eklipsit.
5. Thënia pas thënies “Rabena ue lekel hamd”, “Hamden kethijren tajiben mubareken fijhi, kema juhlibu rabuna ue jerda” apo dhe thënie të tjera.
6. Thënia më tepër se një herë “Subhane rabijel adhijm” në ruku, e “Subhane rabijel e`ala’ ” në sexhde dhe çdo gjë tjetër pas thënies “Rabi gfirlij” midis dy sexhdeve.
7. Thënia e salauateve pas etehijatit të parë.
8. Thënia e salauateve para dhënies së selamit.

b)- Sunetet në vepra

1. Ngritja e duarve në tekbinin e rënies dhe ngritje nga rukuja.
2. Përqendrimi i shikimit në vendin e sexhdes, përveç se në namazin e frikës dhe në etehijat.
3. Kapja e kupës së gjurit me pesë gishtat.
4. Shtrirja e këmbës së majtë dhe ulja sipër saj, duke qëndruar mbi majën e gishtave të këmbës së djathtë.
5. Largimi i gjymtyrëve nga njëra-tjetra.

Gjërat që e prishin namazin

1. Prishja e abdesit apo e tejemumit.
2. Zbulimi i pjesës që nuk lejohet të zbulohen.
3. Mosdrejtimi nga Kibla.
4. Shtesa ose pakësimi në rekate me vetëdije.
5. Ngrënia, pirja, fjalët dhe qeshja në namaz.
6. Lëvizja pa nevojë aq shumë, saqë ai që e shikon, mendon se ai nuk po falet.

Të papëlqyerat në namaz

1. Lënia e suneteve.
2. Ngritja e syve nga qielli apo shikimi majtas-djathtas.
3. Lëvizja e tepërt në namaz dhe luajtja me rrobat.
4. Lëvizja e panevojshme gjatë namazit, shikimi tek ora, loja me gishtërinj.
5. Vendosja e duarve në bel apo në faqe.
6. Lëshimi i duarve në namaz.
7. Mbulimi i fytyrës nga gratë në namaz.
8. Ngjitja e krahëve për trupi në ruku dhe në sexhde, si dhe ngjitja e barkut me kofshët në sexhde.
9. Falja e namazit kur të vjen gjumë, kur ke etje, uri apo ke nevojë për të shkuar në banjo.
10. Caktimi i një vendi të veçantë në xhami ku të falesh vetëm ti, përveç rastit të imamit.

Shmangu nga:

- * Ngrënia e ushqimit me erë të rëndë (hudhra, qepë) para vajtjes në xhami.
- * Vajta në xhami duke ecur shpejt ose duke vrapuar nga frika se do të ikë namazi me xhemat.

* Thënia e Tekbirit fillestar në ruku, kur duhet thënë në kijam, kur e arrin namazin me vonesë (rrjedhimisht kemi dy tekbiere, ose vetëm një, por me qëllimin e tekbirit fillestar).

* Mosthënia e duasë hyrëse të namazit.

* Mosfalja drejt sutrës.

* Mosdashja për të qëndruar në rreshtin e parë në namazin me xhemat.

* Lënia e boshllëqeve në rreshta në namazin me xhemat.

* Leximi i sures El-Fatiha shpejt, pa u ndalur në fund të çdo ajeti.

* Lëvizja njëkohësisht me imamin ose para tij.

* Ulja e tepërt e kokës, apo ngritja e tepërt e saj dhe harkimi i shpinës gjatë rukusë.

* Vendosja vetëm e majës së kokës në tokë gjatë sexhdes pa e prekur hundën.

* Kryerja e nxituar e namazit, që nuk lejon prehjen dhe qetësinë e duhur në ruku dhe në sexhde.

* Bërja e tesbihëve me dorën e majtë.

* Largimi në fund të namazit, pa bërë dhikrin.

* Kalimi para personit që falet.

* Mosfalja e namazit kur je i sëmurë.

* Falja në ato vende në xhami ku është rrugë për të kaluar njerëzit.

Dispozitat e Fik'hut

1. **Uaxhib (farz)**- detyrë – Allahu shpërblehen vepruesin dhe dënon lënësin.

2. **Haram** - e ndaluar - Dënon vepruesin dhe shpërblehen lënësin.

3. **Sunet** - e pëlqyer - Shpërblen vepruesin dhe nuk dënon lënësin.

4. **Mekruh** - e papëlqyer - Shpërblen lënësin dhe nuk dënon vepruesin.

5. **Mubah** - e lejuar – Vepruesi dhe lënësi nuk i nënshtrahet gjykimit.

Etika e të shkuarit për në vendin e namazit

1. Falësit i lejohet që të dalë për të shkuar për në namaz duke qenë i pastruar d.m.th. me abdes.

2. Atij i takon që të ecë në rrugë me thjeshtësi, pa u nxi-tuar. Profeti ynë, qoftë i lavdëruar, ka thënë: “Mos shkoni për t’u falur me vrap, por me qetësi dhe madhështi.”

Mënyra e faljes së Namazit

Namazi ndahet në njësi që quhen rekat. Një rekat është i përbërë nga një qëndrim në këmbë, një ruku dhe dy sexhde (me një qëndrim ulur në mes). Namazet kanë numër të ndryshëm rekatesh. Namazi farz i Agimit ka 2 rekate, namazi farz i Drekës ka 4 rekate, namazi farz i Zamrës ka 4 rekate, namazi farz i Perëndimit të Diellit ka 3 rekate dhe namazi farz i Darkës ka 4 rekate. Më poshtë po tregojmë me ilustrime se si falet namazi.




Fig 1

Bëjmë nijetin për t’u falur.

I drejtohem Kibles, ngremë duart dhe themi: “Allahu Ekber” (Allahu është më i Madhi).




Fig. 2

I ulim duart, duke vendosur të djathtën mbi të majtën. Sytë i drejtojmë në vendin ku bie balli gjatë sexhdes. Them i (me zë fare të ulët) lutjen e hapjes së namazit, “Subhàneke Allàhumme ue bihamdike ue tebàrekes-muke ue teàlà xhedduke ue là ilahe ga-

jruke (Lavdia të përket vetëm Ty o Allah! Falënderimet të përkasin vetëm Ty! Emrat e tu janë të bekuar. Madhëria jote është e paarritshme! Askush dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Teje), ose ndonjë lutje tjetër.

Pastaj themi (me zë fare të ulët) “E’udhu bi lahi minesh shejtani rraxhim Bismi làhi Rrahmàni Rrahim” dhe këndojmë suren El-Fatiha e pas saj çfarë të kemi mundësi nga Kur’ani.

Suret lexohen me zë në namazin e agimit (sabahut), perëndimit (akshamit) dhe darkës (jacisë), ndërsa në atë të drekës (ylesë) dhe të zamrës (ikindisë) lexohen me zë të ulët.




Fig. 3

Kur mbarojmë këndimin e sures, themi “Allahu Ekber” dhe biem në ruku, duke vendosur duart mbi gjunjë e duke e përku-lur dhe drejtuar shpinën horizontalisht. Në këtë pozicion themi “Subhàne Rabbijel -‘adhim” (Larg të

metave është Zoti im i Madhëruar).



Fig. 4

Drejtohemi, duke thënë *Semi'Allahu limen hami-deh* (Pa dyshim Allahu e dëgjon njeriun që e falënderon Atë). Ai që falet me xhemat, domethënë, që udhëhiqet nga imami, nuk i thotë fjalët "*Semi'Allahu limen hamideh*", por

thotë fjalët që vijnë më pas: "*Rabbenà ue lekel-hamd* (O Zot Ty të përket falënderimi i pakufishëm).




Fig. 5

Themi "Allahu Ekber" dhe biem në sexhde, duke vendosur në tokë ballin, hundën, pëllëmbët e duarve, dy gjunjët dhe gishtat e këmbëve. Bërrylat i mbajmë larg nga brinjët, kurse pëllëmbët e duarve i vendosim

pranë supeve. Në këtë pozicion themi tri herë "*Subhàne Rabbijel a'là* (Larg të metave është Zoti im, i Lartësuar).





Fig. 6

Ngremë kokën dhe qëndrojmë në gjunjë, duke e shtruar kurrizin e këmbës së majtë horizontalisht dhe duke e lëshuar peshën e trupit mbi të. Këmbën e djathtë e mbështetim mbi gishta, me maja drejtuar nga

Kiblja dhe themi: *Rabbi g'firi, Rabbi g'firi* (O Zot më fal! O Zot më fal!).



E ulim përsëri kokën në sexhde, duke thënë të njëjtat fjalë, si në sexhden e parë. (Me kryerjen e kësaj sexhdeje ka përfunduar rekati i parë.)



Ngrihemi më këmbë, për të vazhduar rekatin e dytë. Ky rekati kryhet si rekati i parë.



Kur plotësojmë rekatin e dytë, rrimë ulur në gjunjë, me kurrizin e këmbës së majtë të shtruar mbi tokë dhe me duar mbi kofshë. Këtu themi me zë fare të ulët *teshehudin* (dëshminë): “*Et-tehijjatu lil-làhi ues-salauatu uet-tajjibàtu, es*

selàmu ale nebij ue rahmetull-llàhi ue berekàtubu, es-selàmu ‘alejna ue ‘ala ‘ibadil-làhi salihin. Eshbedu en la ilabe il Allah, ue eshbedu enne Muhameden ‘abduhu ue resuluhu. (Lavdërimet më të mira janë vetëm për Allahun. Urimet më të mira, mëshira dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin e Tij! Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithërobërit e mirë e të çiltër! Dëshmoj se


askush dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut. Dëshmoj gjithashtu se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij).

Kur falja kërkon më shumë se dy rekatë, pas teshehudit, çohemi dhe falim rekatin tjetër a rekatët e tjerë. Në fund, rrimë ulur në gjunjë dhe përsërisim teshehudin (me zë fare të ulët). Them edhe salavatet për të Dërguarin e Allahut “ *Allàbumme sal-li ‘ala Muhamedin ue ‘ala àli Muhamed, kema salejte ‘ala Ibrahim ue ‘alà ali Ibràhim inneke Hamidun Mexhid. Allàbume bàrik ‘alà Muhamedin ue ‘alà àli Muhamed, kema barekte ‘alà Ibrahim ue ‘alà àli Ibrahim inneke Hamidun Mexhid.*

(O Allah! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij! Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar. O Allah! Bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e bekove Ibrahimin dhe familjen. Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar) dhe bëjmë ndonjë lutje. Është e këshillueshme që para dhënies së Selamit të kërkojmë mbrojtje nga Allahu për katër gjëra: *Allabume inni e’udbu bike min min ‘adhabil-kabr ue min ‘adbabi Xhehenem, ue min fitnetil-mahja uel-memat, ue min fitnetil-mesibid-dexhal.* (O Allah! Kërkoj mbrojtje te Ti nga dënimi i varrit, nga dënimi (vuajtjet e) i Xhehenemit, nga të këqijat që vijnë gjatë jetës (së përditshme) e vdekjes dhe nga sprovimet e Dexhalit).

Më pas kërkojmë nga Allahu të mirat e dunjasë dhe ahiretit, dhe lutemi për prindërit dhe për të gjithë muslimanët.

Mund të shtojmë edhe lutje të tjera, si për shembull: *Rabbena atina fi dunja haseneten ue fil ahireti haseneten ue kina adhabe nar. Rabbena gfirmij ue li ualidejje ue lil mu’minine jeume jekumul hisab.* (Zoti ynë, na jep në dunja dhe në botën tjetër të mira dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit. Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën e Llogarisë).



Kthejmë kokën nga ana e djathtë duke thënë ***“Es-selamu alejkum ue rahmetullah”*** pastaj e kthejmë kokën nga ana e majtë duke thënë të njëjtën gjë. Me këtë veprim përfundon namazi (ky namaz që është përshkruar është me dy rakete). Nëse namazi është me tri re-

kate (akshami), pas rekatit të dytë në uljen e parë lexojmë vetëm Et-tehijatin dhe salavatet, pastaj ngrihemi në këmbë dhe vazhdojmë rekatën e tretë sipas fig. 2-10, por në të në qëndrimin në këmbë lexojmë vetëm suren El-Fatiha.

Kurse në namazet katër rekatëshe (yleja, ikindia dhe jacia) falen edhe dy rekate pas uljes së parë. Në rekatën e tretë dhe katërt në qëndrimin në këmbë lexohet vetëm suren El-Fatiha. Pra, në rekatën e tretë përsëriten edhe një herë veprimet sipas fig. 2-7, kurse në rekatën e fundit ndiqen veprimet sipas fig. 2-10.

Vëlla mysliman! Motër myslimane! Ky është namazi që na është bërë detyrim. Mos e humb atë!

Namazi është shtylla e dytë e Islamit. Ai është lidhja ndërmjet robit dhe Zotit të Tij. Muhamedi (paqja e Allahut dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Namazi është dritë.”*** (E përçjell Muslimi) Namazi është dritë për robin: dritë në këtë botë dhe dritë në Botën Tjetër.

Pasi është kryer namazi, themi fjalët dhe lutjet e mëposhtme (dhikër). Së pari thuhet tri herë: ***Estagfirullah*** (Të kërkoj falje vetëm Ty, o Allah!), ***Allahume entes-selam ue minkes-selam tebarekte ja dhel xhelali uel-ikram.*** (O Allah! Ti je burimi i shpëtimit, vetëm prej Teje e pres shpëtimin. Ty të lavdërojmë dhe të falënderojmë; lavdërimet të përkasin vetëm Ty, o Krijues i madh dhe Bujar.)

Pastaj thuhet: **Subhanallah** (33 herë) (I patëmeta është Allahu), **El hamdulil-lah** (33 herë) (I lavdëruar qoftë Allahu), **Allahu ekber** (33 herë) (Allahu është më i madhi)

Më pas thuhet ajetul kursij: **Allahu la ilàhe ile buel hajjul kajjum. La te'budhubu sinetun ue la neum. Lehu ma fi semauati ue ma fil ard. Men dhel ledhi jeshfeu indehu ila bi idbnih. Ja'lemu ma bejne ejdihim ue ma halfebum. Ue la jubitune bi shej'in min ilmibi ila bi ma sha'. Uesia kursijjuhu semauati uel ard ue la jeuduhu bifdhubuma ue buel alijjul adhim.**

(Allahu është Një, nuk ka të adhuruar përpos Tij. I Gjalli, Mbikëqyrësi i përhershëm. Atë nuk e kap as kotja, e as gjumi. E Tij është ç'ka në qiej e në Tokë. E kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, veçse me lejen e Tij. E di të tashmen dhe të ardhmen, e nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm aq sa Ai do. Kursija e Tij është sa qiejt dhe Toka, kurse kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk është e vështirë për Të. Ai është i Larti, i Madhi).

Dhe në fund: **La il-labe il Allah uabdehu la sherike leh, lebul mulku ue lebul hamdu ue bue ala kul-li shejin kadir.** (Askush dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet, përveç Allahut, të Vetëm e të Pashoq. Ai është Zotëruesi i gjithçkaje (në qiej e në Tokë), vetëm Atij i përket falënderimi për gjithçka, Ai është i Plotfuqishëm).



Pse falem?

Miku im i dashur! Es selamu alejkum (paqja e Allahut qoftë mbi ty). Kam dëgjuar disa fjalë të cilat dëshiroj të t'i shkruaj në këtë letër, me shpresë se do të kenë efektin që kanë pasur dhe tek unë.

Shumica e njerëzve sot e lënë pas dore namazin, e për disa është barrë e rëndë. Nëse u përmend namazin, ata të nxjerrin lloj-lloj arsyes. Disa justifikohen se janë të zënë me punë shumë të rëndësishme, tjetri pranon se është i dobët në këtë drejtim dhe përsërit fjalën: Allahu na udhëzoftë! Disa dhe krenohen me mëkate, dhuntitë e Allahut i pranojnë me përbuzje, nënçmojnë namazin e edhe ata që falen. Vallë, ç'kanë këta njerëz që kur përmendet Allahu u ngushtohet zemra?!

Eja vëllai im, të analizojmë qëndrimet e tyre dhe të shohim shkaqet për të cilat ata e lënë namazin. Vallë namazi është gjobë që duhet paguar? Ose vallë namazi është humbje kohe? A është namazi princip i detyrueshëm, ashtu siç janë edhe principet e ndonjë shteti diktatorial? Vallë namazi është një gjë e lejuar, e kush do e fal e nuk shpërblehet dhe kush nuk do, s'e fal e nuk dënohet? Vallë, Allahu ka nevojë për namazin tonë? etj.

Le t'i analizojmë së bashku:

Një: Shoku im. Namazi nuk është gjobë që duhet paguar, e as taksë në para e cila duhet dhënë, por është amanet, pronari i së cilës pesë herë në ditë shikon se si do të sillësh ndaj këtij amaneti, a do ta ruash apo do ta marrësh nëpër këmbë, a do të jesh i sinqertë dhe besnik apo do ta neglizhosh.

Sigurisht, nuk është gjobë apo taksë, por është konfirmim i urdhrat të Zotit dhe falënderim për dhuntitë e Tij, argument për pastërtinë e shpirtit, shprehje e dashurisë dhe nderimit që ke ndaj Allahut të Madhëruar. A nuk e sheh se të gjithë njerëzit madhërojnë ndokënd në shpirtin e tyre, i madhërojnë ata që mendojnë se janë më me vlerë dhe më të dobishëm, u luten atyre në vështirësi. Kërkojnë bereqetin e tyre në raste të ndryshme dhe marrin simbole, të cilat i përkujtojnë sa herë që i harrojnë.

A nuk je dhe ti në një mendim me mua se, nëse dikush të bën ndonjë nder, dëshiron t'ia kthesh këtë mirësi? Vallë, a ka dhurues mirësish dhe bamirës më të madh sesa Allahu, i cili më ka dhuruar mendjen dhe shqisat, më ka dhënë furnizim të mirë, më ka dhënë shëndet dhe fuqi, më ka udhëzuar në fe të vërtetë, më ka dhënë familje etj?!

Falënderimi nuk mund të jetë i njëjtë si për atë që të ka dhuruar mirësitë e përmendura, me të atij që të dhuron diçka tjetër me vlerë më të vogël.

Forma e falënderimit, të cilën Allahu e do prej meje, është të vendos ballin në tokë, në shenjë pranimit të të qenit Zoti im, në shenjë madhërimi dhe në shenjë pranimit të mirësive të Tij.

Njerëzit përkulen para idhujve të ndryshëm, edhe pse ata në realitet nuk u kanë bërë asnjë të mirë, bile i largojnë nga e vërteta. Të tjerë e ulin kokën para kryetarëve dhe mbretërve, atëherë pse të mos e ulin kokën para Mbretit të mbretërve, Krijuesit të gjithësisë, Zotit të qiejve dhe Tokës, i Cili sjell mirësi me mëshirën e Tij dhe gjëra që nuk na pëlqejnë për shkak të punëve tona të këqija, jep dhe ndalon, ngjall dhe vdes, dhe do të na kërkojë llogari për gjërat e mëdha dhe të vogla?!

Dy: Miku im i dashur. Namazi nuk është humbje kohe. Sepse njeriu kur shmanget për disa çaste nga rutina e përditshme e mbushur me zhurma makinash, zëra të

ndryshëm, problemet e punës, realizimin e kërkesave të klientëve, dhe ndalet në vendfaljen e tij, larg gjithë këtyre gjërave, i qetësohet shpirti, i rehatohet zemra, i pushon trupi, i largohet mërzitja dhe ndalet disa minuta duke iu drejtuar Atij që e do.

Kërkon prej Tij ndihmë dhe përkrahje, falje nëse gabon ndaj ndokujt prej krijesave duke e pare me shikim të zymtë, fjalë të vrazhda apo sjellje të egër. Pra, këto minuta, janë mbushje me energji dhe freski të reja e jo humbje kohe.

Duke u nisur nga kjo mirësi e madhe, Muhamedi, alejhi selam (paqja qoftë mbi të), kur mërzitej dhe dëshpërohej për ndonjë gjë, nxitonte në namaz dhe nëse ishte i lodhur, i thoshte Bilalit, radij Allahu anhu: **“Na qetëso me namaz”**. Për të namazi ishte qetësues nga lodhjet dhe problemet e ditës.

Njeriu është krijesë e dobët dhe ka nevojë për pushim trupor dhe shpirtëror, e ku ka qetësi shpirtërore më të madhe për njeriun sesa në namaz. Njerëzit flasin për namazin si humbje kohe, ngaqë janë të zënë me punën e përditshme “për të mbajtur familjen me bukë”, siç shprehen, thuajse ata që falen “nuk e mbajnë familjen me bukë”. A nuk mendojnë pak se sa kohë janë të gatshëm të shpenzojnë për të parë një film, një ndeshje futbollit, duke bërë biseda të padobishme, duke kaluar kohën kot etj?

A e dini se sa kohë i duhet njeriut për të falur namaz? Nëse zgjat, nuk zgjat më shumë se një çerek ore. Atëherë, o ti njeri i mençur, tregohesh koprac për këtë pjesë të vogël të kohës, përballë këtyre dhuntive që i fiton nga namazi, kurse orë të tëra i kalon pa të bërë fare përshtypje! Por i gjithë problemi qëndron se këta njerëz nuk e kanë provuar ndonjëherë namazin, ndaj dhe u duket shumë i vështirë dhe i pamundur për t'u kryer, kjo të paktën është përshtypja e shumë prej atyre që tashmë e kanë thyer akullin duke filluar të falen.

Tre: Shoku im i dashur. Namazi nuk është princip politik i ndonjë kryetari diktatorial, i cili e detyron popullin e tij me ose pa vullnet t'i zbatojnë mendimet e tij. Namazi është zbatimi i një feje, të cilën e pranon njeriu nga bindja dhe dëshira, nuk ka detyrim e as dhunë, sepse **“S’ka dhunë në fe”**. Nuk është princip politik që ndryshon kohë pas kohe, ose varet nga mendimet e kryetarëve. Nuk është kanun njerëzor, i cili shkruhet sot, diskutohet nesër dhe ndryshohet pasnesër që të çrrënjohet krejtësisht ditën tjetër. Namazi është një shtyllë e Islamit dhe është baza më kryesore e tij pas dëshmisë së monoteizmit.

Habitem kur një njeri i frikësohet policit (që është normale për të ruajtur qetësinë publike) e nuk i frikësohet Zotit, Krijuesit të qiejve dhe të Tokës! Vallë, si ka mundësi që njeriu nuk kalon kur semafori është i kuq (që përsëri është e pranueshme), dhe kanë guxim të thyejnë ligjet e Allahut dhe t'i shkelin kufijtë e Tij, ta sfidojnë me mëkate dhe harame?! A nuk është ky një fakt që tregon nivelin logjik të tyre?! Gjyko vetë, por ji i drejtë!

Katër: Shoku im i dashur. Namazi nuk është thjesht gjë e lejuar, sikurse gjërat e thjeshta të jetës, nëse e vepron nuk shpërblehesh dhe nëse nuk e vepron nuk dënohesh. Përkundrazi, është gjë e prerë dhe rigoroze. Ka kohë të caktuar, formë të veçantë, nuk ke të drejtë ta shtosh apo ta pakësosh, ta shpejtosh apo ta vonosh. Nëse ti mund ta urdhërosh rrahjen e zemrës tënde, ose punën e mushkërive të tua, ndërhy dhe në ndryshimin e namazit, por dije se ai që ia ka caktuar atë punë zemrës, të cilën ajo e kryen, ta ka urdhëruar dhe ty faljen e namazit.

Shembulli i atij që nuk e fal namazin, i ngjan një njeriu që shoqëria e ka vendosur për të kryer një detyrë, për të cilën do të shpërblehet nëse e kryen në rregull. Por nëse ky njeri nuk e kryen detyrën e besuar, edhe pse është i aftë nga ana mendore dhe fizike, pra e lë pa arsye, atëherë

ky njeri ndëshkohet ose duke e larguar nga puna, ose me një dënim më të butë nëse nuk e ka nënçmuar hapur para të tjerëve.

Pesë: Namazi është nevojë e domosdoshme, të cilën jeta e njeriut e kërkon, ashtu siç kërkon ushqimin dhe pijen. Ashtu siç janë të domosdoshme për trupin ushqimi dhe pija është edhe namazi për shpirtin.

Namazi është vija ndarëse mes besimit dhe mosbesimit. Muhamedi, alejhi selam, ka thënë: **“Mes mosbesimit dhe besimit është lënia e namazit”**. A ka mundësi të ngrihet një godinë me njëqind shtylla, nëse në mes nuk ka asnjë shtyllë? Pikërisht kjo shtyllë e mesme dhe kryesore është namazi!

Shoku im! Namazi është peshore me të cilën njeriu peshon veprat që ka bërë mes dy namazeve, ashtu siç e mat mjeku temperaturën herë pas here. Nëse veprat e tij janë të mira, namazi i jep forcë për të duruar dhe për të vazhduar në këtë rrugë, e nëse veprat e tij janë të këqija, namazi bëhet shkak, me lejen e Allahut, që ky person të largohet prej tyre. Ky person kur ta dëgjojë muezinin duke thënë: “Allahu Ekber”, i kujtohet dhe kupton se Allahu është më i Madh sesa puna në të cilën është, andaj largohet prej dunjasë dhe i përgjigjet ftesës së Allahut.

Të jesh i bindur se njeriu që falet, është njeriu nga i cili shpresohet mirësi për mbarë shoqërinë, edhe pse mund të bëjë ndonjë gjynah, mirëpo do të vijë dita kur ky namaz do të bëhet shkak për ta larguar nga punët e këqija. E si jo kur ky njeri në namaz lexon Kur’an, ai edhe pse shumë herë e lexon pa vëmendje, do të vijë çasti dhe momenti kur do të jetë i vëmendshëm, e do të lexojë ajete që do t’ia dridhin zemrën dhe do t’i zgjohen ndjenjat për t’iu shmangur haramëve dhe për të bërë vepra të mira.

Gjashtë. Vëllai im i dashur! Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për namazin tënd, por ne kemi nevojë që t’i

falemi, Ai s'ka nevojë për krijesat, por mbarë krijesat janë të varura prej Tij.

“O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun, ndërsa Ai nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari. Po të dojë Ai, juve ju zhduk e sjell krijesa të reja. E për Allahun kjo nuk është e vështirë”. Fatir: 15-17

Allahu i Madhëruar i ka krijuar njerëzit (kur lindin) të zhveshur, të zbathur, me trup të dobët dhe me mendje të ngurtë, nuk dinë të bëjnë dallim mes objekteve, nuk mund t'i bëjnë vetvetes as dëm e as dobi, i ushqen e i forcon, i përkrah me shëndet, mendje e pasuri, çdo gjë që ka mbi tokë e qiej ia nënshton njeriut, i fal dhunti të brendshme dhe të jashtme, e pas këtyre dhuntive që i jep njeriut, Ai është Mbreti i mbretërve. Në Dorën e Tij janë depot e qiejve dhe të Tokës. Atëherë, a ka Ai nevojë për namazin tonë?

Jo, aspak s'ka nevojë, por namazi ynë është deklaratë e qartë për dashurinë tonë ndaj Tij dhe mirënjohje për dhuntitë që na ka dhënë. Ata e kanë harruar ditën kur kanë lindur, atë ditë kur nuk posedonin asgjë. E kanë harruar dhe ditën kur do të vdesin, kur të gjithë pasurinë që kanë grumbulluar do t'ia lënë pasardhësve të tyre, të cilët do të kënaqen me atë pasuri, ndërsa ata vetë do të japin llogari. Këta njerëz janë treguar kryelartë ndaj adhurimit të Allahut dhe i kanë kaluar kufijtë e Tij, andaj fundi i tyre është në Xhehenem.

“...e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem”. Gafir: 60

Husejn ibn Ubejdi erdhi te Muhamedi, alejhi selam, për ta qortuar për shkak të sfidimit që u bëri mushrikëve kurejshitë, duke shpalosur të vërtetën mbi pavlefshmërinë e adhurimit të tyre ndaj idhujve. Muhamedi, alejhi selam, i tha: **O Husejn, në sa zota beson?** Tha: Shtatë në tokë dhe një në qiell! I Dërguari, alejhi selam, i tha: **Kur të**

vijnë vështirësitë, kujt i lutesh? Tha: Atij që është në qiell. Muhamedi, alejhi selam, i tha: **Kur të shkatërrohet pasuria, kujt i lutesh?** Tha: Atij që është në qiell. Pejgamberi, alejhi selam, tha: **O Husejn, vetëm Ai që është në qiell të përgjigjet, kurse ti Atij i bën ortak! O Husejn bëhu musliman që të shpëtosh.**"

O ti që nuk falesh, a e ke harruar se Allahu të sheh e vdekja të pret? Falu nëse dëshiron të ruhesh nga dënimi i Allahut. Është turp për ty, që t'i lutesh Allahut kur je në vështirësi e ta harrosh në begati.

Filozofi francez, jomusliman, i quajtur Renan, ka thënë për namazin: "Nuk ka asnjë xhami në të cilën kam hyrë, e të mos më zgjohet një dashuri e zjarrtë, apo të mos ndjej një keqardhje të madhe, përse unë nuk jam musliman."

Tomas Arnold thotë për namazin: "Nuk ka njeri që për herë të parë të takohet me muslimanët, e të mos jetë habitur e joshur me dukurinë e besimit të tyre. Kudo që të jesh, në ndonjë rrugë të skajshme, në ndonjë stacion hekurudhor a në ndonjë arë, ajo që të do syri më së shumti për të parë, është momenti kur sheh duke u falur njeriun, tek i cili nuk shihet asnjë grimë veprimi sa për sy e faqe dhe asnjë grimë dëshire për t'u dukur. Kudo që të jetë, lë punën e tij, me të cilën merret, dhe përgatitet qetë dhe me modesti për ta kryer faljen në kohën e vet të caktuar."



Hadithi Nebeui (fjalë profetike)

Hadithi i parë

Ëmbëlsia e imanit (besimit)

Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur prej tij*, ka transmetuar se Profeti, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*, tha: **“Janë tri gjëra, kushdo që i ka ato, ka gjetur ëmbëlsinë e imanit (besimit): Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të dashur për të se çdo gjë tjetër, kur dikënd e do vetëm për hir të Allahut dhe kur urren kthimin në kufër (mohimin), pasi Allahu e shpëtoi prej tij, ashtu siç urren hedhjen në zjarr.”** Buhariu dhe Muslimi

Muslimani, zemrën e të cilit e ka pushtuar imani (besimi), duke shijuar ëmbëlsinë e imanit, ndien qetësinë e zemrës e të shpirtit.

Muslimani, që e do Allahun e Madhërueshëm dhe të Dërguarin e Tij, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*, i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Nga sa shpjeguam më lart, konkludojmë:

1. Domosdoshmërinë e dashurisë ndaj Allahut të Madhërueshëm dhe të dërguarit të Tij, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*, mbi mbarë krijesat.

2. Të mos u bindet njerëzve për kundërshtimin e urdhërave të Allahut të Madhërueshëm dhe të dërguarit të Tij, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*.

3. Dashuria e muslimanit ndaj vëllait të vet për hir të Allahut të Madhërueshëm është tregues i besimit (imanit) të plotë.

4. Muslimani duhet të urrejë kufrin (mohimin), ashtu siç urren hedhjen e tij në zjarr.

5. Ai që i gëzon këto cilësi, gjen qetësi në zemër e në shpirt.

Hadithi i dytë

Respekti ndaj prindërve

Ebu Hurejra tregon se një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*, dhe i tha: “O Resulullah (o Dërguari i Allahut), kush nga njerëzit ka më shumë të drejtë për të gëzuar respektin tim të mirë?” I Dërguari i Allahut, Muhamedi, alejhis selam, iu përgjigj: “Nëna jote.” Atëherë tjetri e pyeti përsëri: “Kush tjetër pas asaj?” Profeti përsëri iu përgjigj: “Nëna jote.” Po pas saj?- e pyeti përsëri i ardhuri. “Nëna jote.” - i tha profeti. “Po pas asaj?”-Babai yt”-iu përgjigj Muhamedi, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*. Buhariu dhe Muslimi.

Nga ky hadith arrijmë në këto konkluzione:

1. Domosdoshmëria e bindjes dhe e mirëtrajtimit të prindërve, duke mos vepruar kundër dëshirës së tyre.
2. Veprimi kundër dëshirës së tyre, keqtrajtimi i tyre me fjalë apo me vepra të çojnë në zjarr.
3. Bindja ndaj prindërve të çon në xhennet.
4. Te mirëtrajtimi i prindërve hyn edhe lutja për ta, kur janë gjallë dhe mbas vdekjes.
5. Kur hyhet në vendin ku rrinë prindërit, djali duhet të fillojë me përshëndetjen e tyre me selam.
6. Miqtë e prindërve duhen respektuar dhe duhen vlerësuar qoftë dhe pas vdekjes së tyre.
7. Madhështia e së drejtës së nënës, të cilën profeti e përsëriti tri herë.

Hadithi i tretë

Përqaftimi i së vërtetës dhe largimi nga gënjeshtria.

Nga Ibn Mes’udi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, është transmetuar se i Dërguari i Allahut, *paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin për të*, ka thënë: “Mos iu ndani së vërtetës, se e vërteta të çon në të mirën, dhe e mira të çon në Xhennet.

Njeriu duhet të vazhdojë të thotë të vërtetën e të hetojë në vërtetësinë e fjalës së vet, derisa të shkruhet tek Allahu si njeri besnik. Qëndroni larg gënjeshtërs, se ajo të çon në degjenerim, dhe degjenerimi të çon në Zjarr, dhe e bën njeriun të vazhdojë me gënjeshtërs, derisa shkruhet tek Zoti si gënjeshtar.” Buhariu dhe Muslimi

Nga ky hadith mësojmë se:

1. Thënia e së vërtetës është nga cilësitë e mira morale për të cilat fton Islami.
2. Islami është i plotë, kur fjala e njeriut përputhet me atë që ka në zemër.
3. Thënia e së vërtetës është mjeti më i mirë për shpëtim në këtë botë e në Botën Tjetër.
4. Besimtari që dallohet për të vërtetën është i dashur tek Allahu i Madh, dhe te njerëzit.
5. Duhet udhëzuar shokët, se e vërteta është rruga e shpëtimit në këtë botë e në botën tjetër.
6. Gënjeshtria është ves i keq, që Islami e ka ndaluar. Ajo të çon në zjarr.
7. Duhet këshilluar ai që gënjen.



Lutje

1. “Rabbena atina fiddunja haseneten ue fil ahireti haseneten ue kina adhabennar.” (El Bekare: 102)

“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë e në botën tjetër, e na ruaj nga mundimet e zjarrit.”

2. “Rabbena la tuzig kulubena bade idh hadejtena ue heb lena min ledunke rahmeten inneke entel uehhab.” (Ali Imran: 8)

“Zoti ynë mos na i trondit zemrat pasi na i orientove në rrugën e drejtë, na jep mëshirë nga mëshira Jote, Ti je i Adhuruari i përhershëm.”

3. “Allahume inni es-elukel xhennete ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amel, ue eudhu bike mine nari ue ma karrabe ilejha min kaulin ue amel.”

“O Zoti im, kërkoj prej Teje Xhennetin dhe çdo fjalë e vepër që të afron tek ai dhe më ruaj nga Zjarri dhe nga çdo fjalë a punë që më afron tek Zjarri.”



Përmbajtja

Akidja Islame

Parathënie.....	5
Bazat e Islamit.....	6
Bazat i Imanit.....	6
Domethënia e Islamit dhe Imanit	8
Detyrat e robërve ndaj Allahut.....	13
Llojet dhe dobia e teuhidit	15
Domethënia e shprehjes ‘la ilahe il Allah’ dhe kushtet e saj.....	18
Rëndësia e akides dhe teuhidit.....	21
Kushtet e pranimit të pendimit	23
Kushtet e pranimit të një vepre.....	23
A është e drejtë shprehja ‘feja është në zemër’?.....	26
Së pari akidja apo pushteti?.....	27
Miqësia dhe armiqësia në Islam.....	28
Miqte e Rrahmanit (Mëshiruesit) dhe miqtë e shejtanit	30
Shirku i madh dhe llojet e tij	31
Llojet e shirkut të madh.....	34
Llojet e shirkut.....	40
Dëmet e shirkut të madh.....	42
Shirku i vogël dhe llojet e tij.....	43
Të afuarit tek Allahu dhe të kërkuarit ndërmjetësim ...	45
Të vepruarit me Kur’an dhe Sunet	48
Të besuarit në kaderin (përcaktimin) e Allahut, qoftë për të mirë apo për të keq.....	53
Suneti dhe bidati	56
Grupi i shpëtuar dhe pala e ndihmuar	59
Vizita e varreve	61

Thirrja e njerëzve për tek Allahu	65
Detyra jonë ndaj Allahut	67
Dallimi mes shiitëve dhe sunive	69
Shtojcë.....	71

Rruga e Muslimanit

Parathënie	83
Parimet e përgjithshme të fesë Islame.....	85
Ibadeti (adhurimi)	90
FIK'HU (JURISPRUDENCA).....	118
Pastërtia dhe falja	118
Eja të shkojmë në xhami.....	127
NAMAZI (FALJA).....	129
Pse falem?.....	154
Hadithi Nebeui (fjalë profetike).....	161
Lutje.....	164

هذا الكتاب منشور في

